REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

# STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZVOGËLIMIN E RISKUT NGA FATKEQËSITË

# *(SKZRF 2023-2030)*

Tiranë, Tetor 2022

Ky dokument u përgatit në kuadër të projektit Forcimi i Aftësive Ripërtëritëse në Shqipëri – Projekti RESEAL, UNDP në Shqipëri.

Sweden Sverige
CAMÕES INSTITUTO DA COOPERAÇÃO E DA LÍNGUA PORTUGAL
MINISTÉRIO DOS NEGÓCIOS ESTRANGEIROS
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
UNDP

**Konsulenca:** ABKONS shpk, Rruga Themistokli Gërmenji 6, Tirana

| | |
|---|---|
| **Klienti:** | UNDP në Shqipëria rruga "Skenderbej", Kati i 2-të, Tiranë, Shqipëri |
| **Titulli Dokumentit:** | Strategjia Kombëtare Për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2023-2030 |
| **Versioni** | Drafti Përfundimtar |
| **Datë:** | 15 Tetor 2022 |
| **Dërguar:** | UNDP në Shqipëri dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile |
| **Projekti:** | Forcimi i Aftësive Ripërtëritëse në Shqipëri – Projekti RESEAL, UNDP në Shqipëri. |
| **Ekipi ABKONS i Projektit** | |
| Drejtues i Ekipit të Konsulentëve: | Krunoslav Katic |
| Konsulent Strategjie | Josif Gjani |
| Konsulent kombëtar | Maksimiljan Dhima |
| Konsulente ndërkombëtare | Natasa Holcinger |
| Konsulent ndërkombëtar | Vlatko Jovanovski |
| Menaxhere Projektit | Blerina Kurti |

# Pasqyra e Lëndës:
# Tabela e Përmbajtjes


1. Parathënie 8
1.1. Falënderime 9
2. Hyrje 10
2.1. Konteksti: rëndësia dhe argumentimi 10
2.2. Qëllimi dhe struktura e dokumentit 11
2.3. Kuadri ligjor dhe vendi i saj brenda politikës kombëtare 12
2.4. Procesi i zhvillimit 13
2.5. Arritjet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i reformës pas tërmetit të 2019 14
2.6. Koncepti i Strategjisë së ZRF 18
3. Gjendja aktuale dhe tendencat: sfidat 18
3.1. Tërmetet 18
3.2. Përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave 21
3.3. Rrëshqitjet e tokës, reshjet e dëborës dhe ortekët 23
3.4. Zjarret në pyje 26
3.5. Rreziqet nga aksidentet teknologjike 28
3.6. Sëmundjet Infektive 29
4. Vizioni, Treguesit dhe Objektivat Strategjikë 30
4.1. Vizioni 30
4.2. Misioni 31
4.3. Treguesit e ndikimit 31
4.4. Objektiva Strategjike 31
5. Strategjia e zbatimit dhe Korniza Financiare 32
5.1. Fushat e ndërhyrjes 32
5.1.1. Fusha 1: Të menaxhojë risqet ekzistuese dhe parandalojë risqet e reja. 32
5.1.2. Fusha 2: Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes 32
5.2. Komunikimi 33
5.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe partneriteti global 34
5.4. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi 37
5.4.1. Monitorimi dhe raportimi i progresit 38
5.4.2. Vlerësimi 38
5.4.3. Përditësimi dhe përshtatja 39
6. Elementet ndërsektoriale të Strategjisë së ZRF-së 39
6.1. Lidhja me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 39
6.2. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe ZRF 40

6.3. Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe ZRF, ndryshueshmëria dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike 41

6.4. Grupet e cënueshme dhe ZRF 44

Shtojca 1: Analiza SWOT 47

Shtojca 2: Lista e dokumenteve kombëtare në përputhje me Strategjinë 48

Shtojca 3: Plani i Veprimit për Zvogëlimin e Riskut të fatkeqësive për Shqipërinë 2023-2027. 53

**1. Menaxhimi i riskut të fatkeqësive me shumë risqe 53**

**2. Tërmetet 78**

**3. Përmbytjet , vërshimet e ujit dhe çarjet e digave 86**

**4. Rrëshqitjet e tokës, reshjet e dëborës dhe ortekët 94**

**5. Zjarret në Pyje 98**

**6. Aksidentet Teknologjike 105**

**7. Sëmundjet infektive 108**

**8. Përmbledhje e Planit të Veprimit 112**

Shtojca 4. Partneriteti me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare dhe marrëveshjet përkatëse 129

Shtojca 5. Grupi teknik ndërinstitucional i punës. Rolet, përgjegjësitë dhe baza ligjore të ministrive kryesore dhe agjencive të përfshira në çështjet e menaxhimit të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile në vend 132

## Figurat

**Figura 1: Cikli i Menaxhimit të Emergjencave** 11

***Figura 2: Procesi i monitorimit të zbatimit të strategjisë*** 37

## Tabelat

Tabela 1. Koordinatorët e Strategjisë së ZRF ........ 14

Tabela 2. Treguesit e ndikimit ........ 31

Tabela 3. Përmbledhje e ndryshimeve klimatike dhe efektet/risqet në 2100 (Burimi: Albania Revised NDC) ........ 42

Tabela 4. Lista e dokumenteve kombëtare ........ 48

Tabela 5. Projektet e menaxhimit të riskut të fatkeqësive me shumë risqe ........ 53

Tabela 6. Projektet e lidhura me tërmetet ........ 78

Tabela 7. Projektet e lidhura me përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave ........ 86

Tabela 8. Projektet e lidhura me rrëshqitjet e tokës, rënien e dëborës dhe ortekët ........ 94

Tabela 9. Projektet e lidhura me zjarret në pyje ........ 98

Tabela 10. Projektet e lidhura me aksidentet teknologjike ........ 105

Tabela 11. Projektet e lidhura me sëmundjet infektive ........ 108

Tabela 12. Përmbledhje e Planit të Veprimit ........ 112

# SHKURTESAT

| | |
|---|---|
| AKMC | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| AICS | Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim |
| AMBU | Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore |
| AKU | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit |
| AKP | Agjencia Kombëtare e Pyjeve |
| ASIG | Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor |
| BB | Banka Botërore |
| BE | Bashkimi Evropian |
| CBC | Bashkëpunimi Ndërkufitar |
| CECIS | Sistemi i Përbashkët i Komunikimit dhe Informacionit të Emergjencave |
| Desinventar | Sistema de Inventario de Desastres (Sistemi i Inventarit të Fatkeqësive) |
| DG ECHO | Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen Civile Evropiane dhe Operacionet e Ndihmës Humanitare |
| DPEC | Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (Paraardhësja e AKMC) |
| DPPI SEE | Iniciativa e Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Jug - Lindore |
| EERC | Kapaciteti Evropian i Përgjigjes Emergjente (European Emergency Response Capacity) |
| EM-DAT | Baza e të dhënave të ngjarjeve emergjente |
| ERCC | Qendra e Koordinimit të Përgjigjes Emergjente |
| EWS | Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm (EWS) |
| FC | Mbrojtja nga Përmbytjet. (Modul i Kapacitetit Evropian të Përgjigjes Emergjente) |
| FRB | Shpëtimi nga Përmbytjet duke përdorur Barkat (Modul i Kapacitetit Evropian të Përgjigjes Emergjente) |
| FRMP | Plani i Menaxhimit të Riskut të Përmbytjeve |
| GFFF | Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje (Modul i Kapacitetit Evropian të Përgjigjes Emergjente) |
| GPMSZRF | Grupi i Punës për Monitorimin e Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut të fatkeqësive |
| GIS | Sistemi i Informacionit Gjeografik |
| GIZ | Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar |
| HUSAR | Kërkim Shpëtimi i Rëndë Urban (Modul i Kapacitetit Evropian të Përgjigjes Emergjente) |
| IFBZ | Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar |
| IGJEO | Instituti i Gjeoshkencave |
| IKTK | Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore |
| IN | Instituti i Ndërtimit |

| | |
|---|---|
| INSTAT | Instituti i Statistikave të Shqipërisë |
| IPA | Instrumenti i Ndihmës së Para Aderimit |
| ISHP | Instituti i Shëndetit Publik |
| JICA | Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar |
| KKSH | Kryqi i Kuq Shqiptar |
| KSZRF | Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive |
| MAS | Ministria e Arsimit dhe Sportit |
| MB | Ministria e Brendshme |
| MC | Mbrojtja Civile |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MBZHR | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| MEPJ | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MIE | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| MK | Ministria e Kulturës |
| MM | Ministria e Mbrojtjes |
| MMC BE | Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së |
| MRF | Menaxhimi i riskut të fatkeqësive |
| MSHMC | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| MTM | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit |
| MZSH | Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi |
| NDC | Kontributi i përcaktuar kombëtar (Nationally Determined Contribution) |
| OBM | Organizata Botërore e Meteorologjisë |
| OBSH | Organizata Botërore e Shëndetësisë |
| OZHQ | Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm |
| PDNA | Vlerësimi i Nevojave Pas Fatkeqësisë |
| PEC | Planifikimi/plani i Emergjencave Civile |
| PHEOC | Qendra Operacionale Emergjente e Shëndetit Publik |
| PKEC | Plani Kombëtar për Emergjencat Civile |
| PNK | Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike |
| RBMP | Plani i Menaxhimit të Basenit Lumor |
| RESEAL | Forcimi i Aftësisë Ripërtëritëse në Shqipëri (Projekti i UNDP) |
| SECO | Sekretariati Teknik i çështjeve Ekonomike |
| SKZRF | Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë |

| | |
|---|---|
| SLR | Rritja e nivelit të detit (Sea-level rise) |
| SHGJSH | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar |
| SKMI | Sistemi Kombëtar i Menaxhimit të Incidentit |
| SKZHI | Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim |
| SWOT | Pikat e forta, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet |
| TESTA | Shërbimet Trans Evropiane për Telematikë midis Administratave |
| UNDP | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara |
| UNDRR | Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive |
| UNOPS | Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime Projektesh |
| UPT | Universiteti Politeknik i Tiranës |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| VKR | Vlerësimi Kombëtar i Riskut |
| VRF | Vlerësimi i Riskut të Fatkeqësive |
| ZRF | Zvogëlimi i Riskut të Fatkeqësive |

# 1. Parathënie

Fatkeqësitë shkaktojnë humbje që kanë një efekt negativ në më shumë se një element social në zonën ku ato ndodhin.

Pothuajse të gjithë sektorët mbajnë përgjegjësi për të siguruar kapacitetet e menaxhimit të fatkeqësive duke garantuar kështu aftësinë ripërtëritëse dhe parandaluese të përgjithshme të vendit.

Duke e ditur këtë, në zhvillimin e kësaj Strategjie u zgjodh një qasje shumë-sektoriale, me shumë rreziqe për të siguruar përfshirjen e palëve të interesit.

Secili prej rreziqeve u përfaqësua në Grupin Teknik Ndërinstitucional të Punës të ngritur për Zhvillimin e Strategjisë Kombëtare Shqiptare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për të siguruar të gjithë ekspertizën dhe njohuritë përkatëse në zhvillimin e këtij dokumenti strategjik me rëndësi të jashtëzakonshme kombëtare.

Bashkësitë vendore dhe Shqipëria si vend, çdo vit përballen me humbje të konsiderueshme, ndonjëherë shkatërruese, nga fatkeqësitë. Përmbytjet, tërmetet, zjarret në bimësi dhe në pyje, rrëshqitjet e tokës dhe rreziqet e tjera dhe pasojat e tyre kanë një ndikim të konsiderueshëm në komunitet, ekonomi, infrastrukturë dhe mjedis.

Ndikimet e fatkeqësive vlerësohen në rritje për shkak të (i) ekspozimit të shtuar të njerëzve dhe aseteve ekonomike ndaj zonave të cenueshme; (ii) financimit të pamjaftueshëm për zvogëlimin e riskut në vite; dhe (iii) efekteve të ndryshimeve klimatike. Kjo është veçanërisht shqetësuese duke qenë se të varfrit dhe kategoritë e popullsisë të riskuara nga varfëria preken në mënyrë jo proporcionale nga fatkeqësitë.

Në tre vitet e fundit Shqipëria i është nënshtruar një reforme të thellë në sistemin e saj të menaxhimit të fatkeqësive, duke e zhvendosur fokusin nga një menaxhim pasiv i situatave, në një menaxhim proaktiv, te orientuar drejt parandalimit dhe gatishmërisë. Me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të sapokrijuar nxitet energji e re në kuadër të qeverisjes së riskut të fatkeqësive për të adresuar të gjitha sfidat me të cilat po përballet Shqipëria në mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të popullsisë, mjedisit, aseteve të rëndësishme materiale dhe kulturore, para, gjatë dhe pas fatkeqësive.

Si asnjëherë më parë në historinë moderne të Shqipërisë, po ndërmerren përpjekje të koordinuara nga qeveria për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të fatkeqësive në vend, i cili do të jetë i gatshëm për të përballuar të gjitha sfidat, si ato aktuale edhe ato të ardhshme. Nëpërmjet një procesi të hartuar me kujdes dhe gjithëpërfshirës, këtë vit do të finalizohen Vlerësimi Kombëtar i Riskut, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Plani Kombëtar për Emergjencat Civile. Paralelisht me proceset e planifikimit strategjik, ne po rrisim gjithashtu kapacitetet tona të përgjigjes duke modernizuar dhe pajisur Shërbimin tonë të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Zhvillimi i strategjive kombëtare dhe vendore për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive është një nga shtatë objektivat e Kuadrit Sendai për Zvogëlimin  e Riskut të Fatkeqësive 2015–2030. Strategjitë për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive janë guri themelit i të gjitha veprimeve të formalizuara për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe vendosin drejtimin strategjik për zhvillimet e mëtejshme të sistemit kombëtar. Si e tillë, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë e Shqipërisë përcakton qëllimet dhe objektivat në periudha të ndryshme kohore, si dhe me objektiva, tregues dhe afate kohore konkrete. Për më tepër, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive promovon vendosjen e

rregullimeve funksionale për koordinimin midis të gjithë aktorëve në Shqipëri dhe përcakton fushat kritike ku kapacitetet duhet të forcohen.

Në samitin e fundit të Platformës Globale për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive në Indonezi në maj 2022[1], shtetet anëtare ranë dakord për Axhendën e Balit për Aftësitë Ripërtëritëse. Kjo axhendë kërkon transformimin e mekanizmave të qeverisjes së riskut për të siguruar që menaxhimi i riskut është një përgjegjësi e përbashkët ndërmjet sektorëve, sistemeve, shkallëve dhe kufijve. Unë besoj fuqimisht se përmes këtij dokumenti strategjik po reflektojmë pikërisht përmbushjen e këtij angazhimi me qëllim që zvogëlimi i riskut të fatkeqësive të jetë prioriteti i të gjithëve.

Haki Cako

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

## 1.1. Falënderime

Dokumenti i Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë është përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile me mbështetjen e drejtpërdrejtë të ministrit të Mbrojtjes z. Niko Peleshi, në kuadër të angazhimit të qeverisë shqiptare për zvogëlimin dhe parandalimin e risqeve të fatkeqësive.

Strategjia u zhvillua në kuadër të projektit të UNDP, "Forcimi i aftësisë ripërtëritëse në Shqipëri - Reseal".

Grupi Teknik Ndër-Institucional i Punës për Përgatitjen e Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive u drejtua nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC, Z. Haki Çako. Të dhënat u mblodhën me kontributin e ministrive dhe institucioneve, të cilat ishin pjesë integrale e procesit të përgatitjes së dokumentit të strategjisë.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile falënderon të gjithë institucionet, organizatat dhe individët e përfshirë në bashkë-hartimin e Strategjisë së parë kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për kohën, përpjekjen dhe ekspertizën e tyre. Ky dokument nuk do të ishte bërë i mundur pa këto kontribute.

[1] https://globalplatform.undrr.org/publication/co-chairs-summary-bali-agenda-resilience

# 2. Hyrje

## 2.1. Konteksti: rëndësia dhe argumentimi

Qeveria e Shqipërisë, duke iu përgjigjur angazhimeve të pranuara globalisht si pjesë e Kuadrit Sendai[2], si vend anëtar me të drejta të plota i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së (MMC BE), duke aspiruar të bëhet një shtet i ardhshëm anëtar i BE-së por sidomos duke synuar që Shqipëria të bëhet një vend me aftësi ripërtëritëse ndaj fatkeqësive, mbështet zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive (SKZRF). Edhe pse parakushtet për sa i përket kuadrit ekzistues të nivelit kombëtar dhe ekspertizës ekzistonin, duhet theksuar se pika e kthesës që nxiti ndryshimet në mënyrën se si perceptohej sistemi i Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive (ZRF) në Shqipëri, ishte tërmeti i 26 nëntorit 2019. Pikërisht atëherë, Qeveria Shqiptare e konsideroi këtë fatkeqësi të madhe si një mundësi për të forcuar sistemin e përgjithshëm të ZRF, si në aspektin e kapaciteteve ashtu edhe të planifikimit strategjik. I gjithë ky proces i forcimit të ZRF-së është diçka që Qeveria Shqiptare mund të jetë dhe është e gatshme ta paraqesë ndërkombëtarisht si një shembull të praktikës më të mirë.

Shqipëria cënohet nga një sërë fatkeqësish natyrore. Rreziqet kryesore që prekin Shqipërinë janë tërmetet, përmbytjet, zjarret pyjore dhe rrëshqitjet e tokës. Rreziqet e tjera përfshijnë stuhi dëbore, thatësirë, ekstreme të temperaturës, epidemi, ortekët, rreziqe teknologjike (p.sh., shpërthime të digave) dhe stuhi të erës. Baza e të dhënave ndërkombëtare të Fatkeqësisë (EM-DAT) tregon se, gjatë viteve 1979-2019, përmbytjet përbënin pjesën kryesore të ngjarjeve të fatkeqësive (38%), të ndjekura nga tërmetet (15%). Cenueshmëria e popullsisë shqiptare ndaj fatkeqësive të shkallëve të mëdha dhe të vogla shoqërohet nga varfëria, infrastruktura dhe komunikimet me cilësi të dobët, rritja e ndërtimeve dhe një sërë faktorësh mjedisorë të ndikuar nga njeriu, nga shpyllëzimi i shpejtë dhe menaxhimi i dobët i baseneve ujore deri te ndotja e mjedisit. Për më tepër, edukimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës mbi këto risqe mbetet i ulët.

Të dhënat më të fundit tregojnë se Shqipëria është në mënyrë eksponenciale më e cenueshme ndaj fatkeqësive pasi në dekadën e fundit të gjitha rreziqet e lartpërmendura në një moment janë kthyer në një emergjencë në shkallë të gjerë ose në një fatkeqësi. Raporte dhe dokumente të shumta evidentojnë nivelin e lartë të risqeve që kërcënojnë vendin, ekspozimin dhe cenueshmërinë e lartë, por edhe kapacitetin e pamjaftueshëm për t'u përballur dhe përshtatur me to. Si rezultat i ekspozimit të lartë dhe kapaciteteve të pamjaftueshme përballuese, fatkeqësitë po prekin rrugën e zhvillimit të Shqipërisë, kështu që mesatarisht dëmet nga tërmetet dhe përmbytjet vlerësohen në 147 milionë dollarë në vit, me një ngjarje katastrofike, si një tërmet 1 në 100 vjet për shembull që shkakton dëme mbi 2 miliardë dollarë.

Në këtë kuptim u konstatua se mungonte qasja strategjike e Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive, për shembull, mungesa e SKZRF-së është evidente në gjetjet e Raporteve të njëpasnjëshëm të Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, duke përfshirë Raportin e fundit të Progresit për vitin 2021, ndërsa nevoja për përgatitjen e një dokumenti strategjik për gatishmërinë ndaj emergjencave evidentohet në SKZHI 2015-2020.

Sipas terminologjisë së Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive (UNDRR), Menaxhimi i Riskut të Fatkeqësive (MRF) është aplikimi i politikave dhe strategjive për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive për të parandaluar riskun e ri të fatkeqësive, për të zvogëluar riskun ekzistues të fatkeqësive dhe për të menaxhuar riskun e

[2] Objektivi F - Rritja e konsiderueshme e numrit të vendeve me strategji kombëtare dhe lokale për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive deri në vitin 2020

mbetur, duke kontribuar në forcimin e aftësive ripërtëritëse dhe zvogëlimin e humbjeve nga fatkeqësitë.[3]

Ristrukturimi i fundit i sistemit kombëtar të menaxhimit të fatkeqësive ishte një hap në drejtim të një sistemi të qëndrueshëm dhe efikas të menaxhimit të fatkeqësive, megjithatë ka shumë për të bërë në aspektin e ndërgjegjësimit dhe njohurive për riskun, zhvillimin e kapaciteteve, zhvillimin dhe përforcimin e infrastrukturës, komunikimin dhe bashkëpunimin ndërsektorial, si dhe gatishmërinë për përgjigje dhe rimëkëmbje.

Investimi në zvogëlimin e riskut të fatkeqësitë mund të rezultojë jo vetëm në zvogëlimin e humbjeve dhe dëmeve, por në qëndrueshmëri ekonomike dhe mundësi të reja. Periudha e zhvillimit dhe ristrukturimit të shpejtë të vendit është koha e përsosur për të integruar zvogëlimin e riskut të fatkeqësive në zhvillimin e politikave të qeverisë në të gjitha nivelet, për të paraqitur investime të ndërgjegjshme ndaj riskut dhe për të siguruar që zhvillimet e reja të jenë të zgjuara dhe të qëndrueshme. Një përqasje gjithëpërfshirëse dhe shumë-sektoriale, që merr mësimet e nxjerra nga politikat, strategjitë dhe kërkimet ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale të menaxhimit të riskut të fatkeqësive në botë, mund të trajtojë faktorët e riskut dhe jo thjesht pasojat dhe duke e bërë kështu Shqipërinë një vend më të sigurt, më ripërtëritës – një shembull dhe spirancë për vendet e saj fqinje dhe një anëtar dinjitoz të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së.

## 2.2. Qëllimi dhe struktura e dokumentit

Qëllimi kryesor i Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë në Shqipëri (Strategjia) është të drejtojë aktivitetet dhe investimet e ardhshme të Shqipërisë për menaxhimin e riskut të fatkeqësive në një mënyrë tërësore dhe gjithëpërfshirëse. Shqipëria ka identifikuar rreziqet më të rëndësishme kombëtare natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu që mund të shkaktojnë një fatkeqësi dhe ka analizuar dhe vlerësuar riskun nga fatkeqësitë në Vlerësimin Kombëtar të Riskut 2022. Hapi tjetër i natyrshëm sipas ciklit të menaxhimit të fatkeqësive dhe objekt i kësaj Strategjie është të përmbledhë të gjitha aktivitetet dhe investimet e menaxhimit të fatkeqësive në mënyrë që të planifikohet zvogëlimi i riskut të risqeve të analizuara, të parandalohet zhvillimi i risqeve të reja dhe të menaxhohet risku i mbetur.




**Figura 1: Cikli i Menaxhimit të Emergjencave**

[3] https://www.undrr.org/terminology/disaster-risk-management

Sistemi i ri i mbrojtjes civile në Shqipëri do të jetë një sistem modern që ndjek të gjitha fazat sipas ciklit të menaxhimit të riskut të fatkeqësive dhe duke përfshirë të gjithë sektorët përkatës dhe nivelet e qeverisjes.  Kjo Strategji është hapi i radhës në zhvillimin e mëtejshëm të këtij sistemi funksional në periudhën e parashikuar 8-vjeçare.

Prandaj, Strategjia përshkruan lidhjen me dokumentet përkatëse ndërkombëtare dhe kombëtare të lidhura me zvogëlimin e riskut të fatkeqësive, rrethanat aktuale të sistemit të menaxhimit të riskut të fatkeqësive në Shqipëri dhe statusin, potencialin dhe boshllëqet në lidhje me secilin prej risqeve që duhet të zvogëlohen nën udhëheqjen e kësaj Strategjie. Strategjia identifikon kornizën financiare të aktiviteteve të planifikuara, misionin, vizionin dhe qëllimet dhe përshkruan sistemin e monitorimit të zbatimit të Strategjisë.

Për të siguruar zbatimin e suksesshëm dhe realist të Strategjisë, Plani i parë 5-vjeçar i Veprimit për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive mund të gjendet bashkëlidhur Strategjisë.

## 2.3. Kuadri ligjor dhe vendi i saj brenda politikës kombëtare

Kjo Strategji është dokumenti themelor për të gjitha veprimtaritë dhe investimet e ardhshme të menaxhimit të riskut të fatkeqësive, si dhe dokumentet e tjera relevante të mbrojtjes civile, përgjigjes, rimëkëmbjes dhe planifikimit të zhvillimit. Strategjia është hartuar nga Qeveria Shqiptare nën koordinimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe do të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Baza ligjore për Strategjinë është e specifikuar për herë të parë në ligjin Nr. 103/2014, datë 31.07.2014 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë” ku “miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive dhe Mbrojtjen Civile” u caktua si një nga objektivat e domosdoshmërisë strategjike nr.5 – “Konsolidimi i Sektorit të Mbrojtjes dhe Sigurisë”.

Në vijim, VKM nr. 348, datë 11.5.2016 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 edhe pse nuk përmban një kapitull plotësisht të dedikuar për ZRF dhe MC, për herë të parë ky dokument përfshin kapitullin e përbërë nr.8.5:  “Forcimi i rendit publik dhe përgatitja për emergjencat civile”.

Paragrafi “sfidat” përfshin një përmbledhje të tetë sfidave kryesore të menaxhimit të MRF dhe të MC ndër të cilat veçojmë sfidën nr.4: Nevojën për të përgatitur një dokument strategjik për përgatitjen për emergjencat.

Në këtë kapitull, forcimi i menaxhimit të MRF dhe MC, përcaktohet që do të realizohet nëpërmjet:

- Përgatitjes dhe miratimit të Planit Kombëtar Operacional për Menaxhimin e Integruar të Emergjencave Civile;
- Përditësimit dhe forcimit të legjislacionit dhe rregullave të lidhura me të, në përputhje me standardet e BE-së;
- Forcimit të kapaciteteve të entiteteve të përgatitjes për emergjenca dhe përgjigjes ndaj fatkeqësive në gjithë Shqipërinë;
- Mbledhjes dhe organizimit të informacionit për risqet dhe forcimit të sistemit të paralajmërimit të hershëm; dhe
- Rishikimit të tregut të sigurimeve të lidhur me katastrofat.

Aktualisht, bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr.157, datë 30.12.2021 "Për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030" është në proces hartimi i SKZHI 2021-2030.

Përpara tërmetit të vitit 2019, Qeveria e Shqipërisë miratoi një ligj të ri nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", i cili zëvendësoi ligjin nr. 8756/2001 "Për Emergjencat Civile", të ndryshuar, dhe e vendosi AKMC-në në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes (MM). Ligji i ri ofron një kuadër solid për promovimin e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe kërkon zhvillimin dhe miratimin e një strategjie kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

Në nenin 10, pika 1, të ligjit nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" përcaktohet se Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë do të jetë dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë që përcakton politikat e aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë, dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.

Në nenin 18, pika "a", të ligjit nr.45/2019 për Mbrojtjen Civile përcaktohet se Këshilli i Ministrave miraton Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë në Republikën e Shqipërisë.

Sipas nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 45/2019, AKMC që është një person publik qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për Mbrojtjen Civile, do të koordinojë dhe bashkërendojë përpjekjet për zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, e cila do të miratohet nga Qeveria Shqiptare

Kjo do të jetë Strategjia e parë Kombëtare Shqiptare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Deri në miratimin e këtij dokumenti, Plani Kombëtar për Emergjencat Civile të Shqipërisë dhe ligji nr. 45/2019 ishin dy dokumentet kryesore në fushën e Mbrojtjes Civile, por asnjë dokument nuk përfshinte të gjitha aktivitetet e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive në të gjithë sektorët në vend.

## 2.4. Procesi i zhvillimit

Fatkeqësitë shkaktojnë shumë humbje dhe dëme dhe ndikojnë negativisht në më shumë se një element social në zonën e goditur, duke shkaktuar kështu një degradim të standardit të jetesës dhe pamundësojnë progresin dhe prosperitetin e shoqërive.

Prandaj është e qartë se më shumë se një sektor vuan nga humbjet gjatë një fatkeqësie dhe është i detyruar të marrë përgjegjësinë dhe të sigurojë aftësinë ripërtëritëse të sektorit, vazhdimësinë e biznesit dhe qasjen e shoqërive në shërbimet bazë, si dhe të kontribuojë në aftësinë ripërtëritëse të përgjithshme të vendit. Aftësia ripërtëritëse e një vendi varet nga niveli i aftësisë ripërtëritëse të secilit prej sektorëve, në secilin nga nivelet e qeverisjes dhe nga aftësia ripërtëritëse e çdo personi. Qëllimi i kësaj Strategjie është të përcaktojë hapat me rëndësinë më të madhe në rrugën drejt një Shqipërie më të sigurt.

Një aftësi e tillë ripërtëritëse nuk mund të arrihet me përfshirjen aktive të vetëm një sektori, atij përgjegjës për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive në nivel kombëtar. Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive është punë e të gjithëve dhe duhet të trajtohet në bashkëpunim me të gjithë aktorët përkatës.

Duke e njohur këtë, Shqipëria zgjodhi një qasje shumë-sektoriale dhe me shumë rreziqe në zhvillimin e kësaj Strategjie për të siguruar përfshirjen e palëve të interesit më vonë në fazën

e zbatimit, si dhe për të siguruar që të identifikohen boshllëqet më të rëndësishme dhe objektiviteti dhe rëndësia e aktiviteteve të zgjedhura.

Strategjia trajton rreziqet më të rëndësishme për Shqipërinë, në përputhje me Vlerësimin Kombëtar të Riskut (VKR). Për secilin nga rreziqet u krijua një grup ndërinstitucional pune dhe secili prej grupeve të punës u përfaqësua nga koordinatori i tij në Grupin Teknik Ndërinstitucional të Punës për Zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

Tabela 1. Koordinatorët e Strategjisë së ZRF

| **Koordinatori kryesor i zhvillimit të Strategjisë Kombëtare të ZRF** | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
|---|---|
| **Rreziku** | **Organi koordinues i nëngrupit të punës të riskut për zhvillimin e SKZRF** |
| Tërmetet | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| Përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| Rrëshqitjet e tokës, reshjet e dëborës dhe ortekët | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| Zjarret në pyje | Ministria e Brendshme |
| Aksidentet teknologjike | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| Sëmundjet infektive | Ministria e Shëndetësisë |

Në këtë mënyrë u sigurua përfshirja e të gjithë aktorëve përkatës, si dhe përdorimi i të gjitha të dhënave ekzistuese dhe ekspertizës në dispozicion duke ndikuar edhe në pronësinë e rezultateve të procesit të përgjithshëm.

Strategjia u zhvillua në kuadër të Projektit "Forcimi i aftësisë ripërtëritëse në Shqipëri - RESEAL dhe procesi u lehtësua nga një grup ekspertësh vendas dhe ndërkombëtarë.

Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës për Zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë u ngarkua nga Qeveria e Shqipërisë për të zhvilluar Strategjinë. Koordinimi dhe bashkëpunimi i ngushtë siguroi rrjedhjen e informacionit tek të gjithë të përfshirët në zhvillim, si dhe rrjetëzimin midis grupit kryesor të ardhshëm të zbatimit.

Pas hartimit të draftit, u kryen të gjitha proceset përkatëse kombëtare të konsultimit me qëllim që të sigurohej transparenca e procesit dhe të informoheshin të gjitha palët e interesit si dhe publiku i gjerë për përmbajtjen dhe qëllimin e dokumentit strategjik.

## 2.5. Arritjet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i reformës pas tërmetit të 2019

Ligji nr. 8756, datë 26.3.2001 "Për Emergjencat Civile", i ndryshuar, vendosi bazën kryesisht në fushën e planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile, por nuk përfshinte politikat e

zvogëlimit të riskut të fatkeqësive, sikurse kishte boshllëqe thelbësore në shumë fusha të tjera si paralajmërimi i hershëm, edukimi, ndërgjegjësimi publik, trajnimi, ndihma ndërkombëtare dhe inspektimi.

Në vitin 2005, me organizimin e ri strukturor, për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore në Ministrisë së Brendshme, u krijua Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (DPEC) e cila vazhdoi veprimtarinë e saj në kuadër të Ministrisë së Brendshme deri në fund të vitit 2017. Me VKM nr. 9, datë 12.1.2018, fusha e "planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile" i kaloi Ministrisë së Mbrojtjes dhe me urdhër të Kryeministrit nr. 47, datë 9.03.2018, DPEC u transferua në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Edhe pse ishte një detyrim ligjor, i sanksionuar në nenin 9, pika 1, të ligjit 8756, datë 26.03.2001 "Për emergjencat civile", i ndryshuar dhe në Planin Kombëtar për Emergjencat Civile, Departamenti i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, nuk u krijua asnjëherë në ministrinë përkatëse gjatë periudhës kohore 2001-2018.

Për periudhën 2011-2021, sipas Raportit të përvitshëm Botëror të Riskut [4] (Bündnis Entwicklung Hilft and Ruhr University Bochum–Instituti për të Drejtën Ndërkombëtare të Paqes dhe Konflikteve të Armatosura), i cili llogarit indeksin e riskut të fatkeqësive natyrore për shkak të tërmeteve, cikloneve, përmbytjeve, thatësirave dhe rritjes së nivelit të detit, bazuar në ekspozimin dhe cenueshmërinë (ndjeshmërinë dhe kapacitetet përballuese dhe përshtatëse), Shqipëria renditej vazhdimisht në vendin e parë në Evropë. Ndërsa sipas të njëjtit raport vjetor 2022, Shqipëria ka një përmirësim prej 21 vendesh krahasuar me vitin 2021 duke u renditur ndër vendet e para në Evropë dhe në vendin e 82-të në botë.

Raporti i parë në të cilin analizohej gjendja e shërbimit të emergjencave civile në vend, me gjetje dhe rekomandime të rëndësishme për transformimin e tij, ishte Raporti i Komandës së SHBA-së në Evropë, korrik 2014. Raporti konstaton mungesën e planifikimit të koordinuar dhe ekzekutimit të aktiviteteve të menaxhimit të emergjencave. DPEC identifikohet si një organizatë me burime të pamjaftueshme dhe autoritet të kufizuar, të cilat pengojnë aftësinë e saj për të drejtuar përpjekjet e gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj fatkeqësive dhe për këtë arsye rekomandohet transformimi i saj në një agjenci nën Kryeministrin ose Këshillin e Ministrave.

Gjithashtu, sipas raportit "Vlerësimi i nevojave pas përmbytjes" të hartuar pas përmbytjeve të mëdha të shkurtit 2015 në jug të vendit, evidentohen kufizime në mandatet, kapacitetet dhe financimet e organizatave përkatëse të sistemit të menaxhimit të fatkeqësive, sikurse pamundësia e autoriteteve të Mbrojtjes Civile në të tre nivelet e qeverisjes për të qenë në gjendje që pa marrë leje ose buxhet të ndërmarrin veprime gjatë një situate krize.

Duke filluar nga Raporti i Progresit 2014 të Komisionit Evropian, çështja e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe Mbrojtjes Civile në Shqipëri u adresua në të vit pas viti, gjë që rriti më tej fokusin e qeverisë shqiptare në këtë fushë.

Strategjia u sanksionua për herë të parë si një detyrim ligjor, në pikën 5 të ligjit Nr. 103/2014, datë 31.07.2014 "Për Miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe në vijim në seksionin 8.5 "Forcimi i rendit publik dhe përgatitjes për rastet e emergjencave civile" të SKZHI 2015-2020, çka përbënte një hap madhor përpara në këtë drejtim.

Në vitin 2019, pas një periudhe të gjatë pune dhe draftesh të njëpasnjëshme të hartuara në vite, u miratua ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", i cili shfuqizoi pas 18 vitesh ligjin paraardhës 8756, datë 26.03.2001 "Për Emergjencat Civile", të ndryshuar.

[4] https://weltrisikobericht.de/english/

Ligji 45/2019 rregullon funksionimin e sistemit të Mbrojtjes Civile, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e institucioneve dhe strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin. Ai siguron përshtatjen e sistemit të Mbrojtjes Civile me standardet evropiane, në përputhje me prioritetet e Kuadrit Sendai sikurse merr në konsideratë detyrimet ndërsektoriale që rrjedhin nga axhenda për zhvillimin e qëndrueshëm 2030, Marrëveshja e Parisit për ndryshimet klimatike dhe Axhenda e Re Urbane.

Një nga objektivat kryesore të ligjit 45/2019 është forcimi i sistemit të mbrojtjes civile, përmes krijimit të AKMC-së që është një person juridik publik qendror në varësi të Ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile dhe është përgjegjës për ZRF dhe MC, në të gjithë territorin e vendit.

Disa nga risitë e tjera të ligjit janë:

- Ka përcaktuar strategjinë kombëtare të ZRF-së si dokumentin bazë strategjik në menaxhimin e riskut të fatkeqësive;
- Është paraparë zhvillimi i strategjisë së ZRF edhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) sikurse edhe vlerësimi i riskut të fatkeqësive (VRF) dhe Planet e Emergjencave Civile (PEC) në të tri nivelet;
- Përmban një kapitull të kushtuar për mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe trashëgimisë kulturore;
- VRF, si dhe PEC, janë gjithashtu të detyrueshme për infrastrukturën kritike;
- Përmban sanksione të qarta për të gjitha institucionet publike, subjektet private dhe vendos mekanizmin e inspektimit;
- Përmban përcaktim të qartë për përqindjen e buxhetit të ZRF dhe Mbrojtjes Civile në 2-4% në ministritë e linjës dhe të paktën 4% të buxhetit të bashkisë.

Tërmeti shkatërrimtar i datës 26.11.2019 që tronditi sistemin e Mbrojtjes Civile duke përfshirë DPEC me personelin e saj krejtësisht të pamjaftueshëm, vuri në dukje domosdoshmërinë e zbatimit sa më të shpejtë të ligjit 45/2019 për të ndërtuar dhe forcuar sistemin e Mbrojtjes Civile dhe ndërtimin e një shoqërie ripërtëritëse.

Pas kësaj, dhe në kushtet kur vendi ishte në fazën e rimëkëmbjes nga pasojat e tërmetit të 26.11.2019, ai u godit sërish nga pandemia e shkaktuar nga virusi Covid-19. Kjo mbivendosje e fatkeqësive ndikoi në ritmin e përgatitjes dhe miratimit të akteve nënligjore dhe të reformës në sistemin e MC në tërësi.

AKMC-ja, ka në prioritetet e saj hartimin e tre dokumenteve kryesore qendrore strategjike, të cilët parashikohen të miratohen deri në fund të vitit 2022. Sa i përket kapaciteteve administrative të sistemit të MC, rekrutimi i stafit është në proces në AKMC, sikurse po vazhdon plotësimi i vendeve të punës dhe sektorëve në ministri si edhe plotësimi i strukturave të planifikimit dhe MC në Institucionet e Prefektit dhe në bashki.

Përfundime:

1. Krijimi i AKMC siguroi më në fund kapacitetet e mjaftueshme administrative në nivelin qendror krahas përgjegjësive dhe kompetencave të zgjeruara, duke e shndërruar kështu agjencinë në një organizatë udhëheqëse, prestigjioze dhe të krahasueshme me të gjitha organizatat homologe evropiane;
2. Rritja e kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të të gjithë sistemit të Mbrojtjes Civile është një nga sfidat kryesore me të cilat do të përballet AKMC në rrugëtimin e saj në zbatimin e reformës që filloi me miratimin e Ligjit 45/2019. Rritja e kapaciteteve financiare, bazuar në parashikimet e këtij ligji, por jo vetëm, do të përbëjë në fakt sfidën më të madhe dhe kritike që do të përcaktojë shkallën e suksesit të reformës në tërësinë e saj;

3. Aktivizimi i Komitetit të Mbrojtjes Civile krahas Komisionit Teknik Këshillimor po sigurojnë një ndërthurje midis bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional të nivelit të lartë vendimmarrës me atë teknik.

4. Parimi i subsidiaritetit dhe obligimet e qarta për bashkitë kanë rritur ndërgjegjësimin e tyre për rolin vendimtar që ato luajnë në ZRF dhe MC. Kapacitetet financiare të bashkive janë rritur si rezultat i detyrimit për të planifikuar të paktën 4% të totalit të buxhetit vjetor të tyre për ZRF dhe MC. Megjithatë, ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim pasi kërkohet ndryshimi i mendësisë organizative, sipas së cilës në emergjenca, pritej gjithçka nga ndërhyrja e nivelit qendror;
5. Janë rritur fondet vjetore të kompensimit financiar të familjeve me banesa të dëmtuara nga fatkeqësitë sikurse është përmirësuar përpunimi tekniko-shkencor i dokumentacionit dhe regjistrimi i dosjeve në sistem (kompjuterik). Fondet e menaxhuara nga AKMC-ja për projektet strukturore të parandalimit dhe rehabilitimit të fatkeqësive janë shumëfishuar, sikurse edhe roli i AKMC-së në prokurim, zbatim, mbikëqyrje dhe dorëzim duke rritur përfundimisht rolin e saj në fazën e parandalimit dhe të zbutjes;
6. Duhet të vazhdojnë angazhimet intensive në marrëveshjet ndërkombëtare në projekte dhe programe të ndryshme në fushën e ZRF dhe MC të cilat do përkthehen në përfitime pasi, ndër të tjera, do mundësojnë financime për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të sistemit të MC në vend;
7. Ngritja e sektorit të inspektimit do të rrisë aftësitë kontrolluese por edhe ndëshkuese të AKMC-së. Gjithsesi, nevojitet sigurimi i një kontrolli të vazhdueshëm, të shoqëruar me vendosjen e penaliteteve ndaj subjekteve kundërvajtës, sipas rastit;
8. Realizimi i anëtarësimit në MMC BE që përbënte një nga prioritetet madhore të AKMC-së do të duhet të shoqërohet edhe me vendosjen e lidhjes TESTA për ndërlidhjen me CECIS. Kjo duhet të shoqërohet edhe me krijimin dhe plotësimin e disa moduleve të BE-së për t'iu bashkuar Kapacitetit Evropian të Përgjigjes Emergjente (EERC);
9. Me ngritjen në AKMC, të Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, janë rritur ndjeshëm kapacitetet operacionale të AKMC-së, si dhe kapacitetet e paralajmërimit të hershëm të saj. Gjithsesi, bazuar mbi përvojën e deritanishme te menaxhimit te fatkeqësive, shihet si domosdoshmëri rritja e mëtejshme e kapaciteteve operacionale të AKMC-së që përfshin fuqizimin e Qendrave te mbrojtjes Civile ne Qarqe me TIK dhe kapacitete të tjera operacionale.
10. Edhe pse aktivitetet e lidhura me edukimin për ZRF, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e publikut janë rritur dhe përmirësuar nevojitet qe këto evente të jenë te planifikuara bazuar mbi programet përkatës të ndërgjegjësimit dhe atyre të trajnimit;
11. Nevojitet forcimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm, integrimi i të dhënave GIS sikurse përpunimi i informacionit të riskut të fatkeqësive dhe të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë nëpërmjet DesInventar;
12. Nevojitet hartimi i bazës së nevojshme ligjore dhe ndërmarrja e të gjitha hapave të tjerë të domosdoshëm për implementimin e plotë të numrit të unifikuar të emergjencave civile 112 në të gjithë vendin;
13. Përcaktimi dhe përfshirja në Ligjin 45/2019 e Shërbimit Vullnetar të Mbrojtjes Civile në Forcat Operacionale dhe miratimi i VKM nr. 667, datë 10.11.2021 "Për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitetet e Mbrojtjes Civile apo në operacionet e parandalimit dhe përballimit të fatkeqësive" kanë vendosur bazat për zgjerimin e vullnetarizmit në fushën e Mbrojtjes Civile në vend. Nevojitet të sigurohet zbatimi i masave të tjera të nevojshme për forcimin e vullnetarizmit në të gjitha fazat e MRF;
14. Nëpërmjet nenit 66 të ligjit 45/2019 për krijimin e një fondi solidariteti për përballimin e situatave emergjente, krijohet një instrument financiar shtesë krahas fondeve të ZRF dhe MC të ministrive dhe atyre të bashkive. Gjithsesi, vendit i nevojitet një qasje

gjithëpërfshirëse shumë sektoriale e forcimit të gatishmërisë financiare përmes miratimit dhe më pas implementimit të një Programi Financimit të Riskut të Fatkeqësive çka do të duhet të udhëhiqet nga MFE dhe mbështetet fuqimisht nga AKMC;
15. AKMC duhet të përshpejtojë punën për përfundimin e bazës nënligjore të ligjit 45/2019 sikurse dokumenteve të tjerë si SOP/SOG[5], udhëzime, manuale, rregullore, plane të vazhdimësisë së operacioneve (COOP) dhe vazhdimësisë së Qeverisë (COG) në ministri dhe institucione të tjera të sigurisë dhe mbrojtjes etj.
16. Përfshirja në ligjin 45/2019 e kapitullit V "Mbrojtja e infrastrukturës kritike dhe e trashëgimisë kulturore" është një hap i parë dhe i rëndësishëm për forcimin e aftësisë ripërtëritëse të infrastrukturës kritike. Gjithsesi, është i nevojshëm hartimi sa më shpejt i një Ligji për Infrastrukturën Kritike, i cili do të transpozojë legjislacionin e BE-së për infrastrukturën kritike siç është Direktiva e Këshillit të BE-së 2008/114 e datës 8 dhjetor 2008. Krahas kësaj, nevojitet që AKMC të koordinojë punën për kryerjen e vlerësimit të aftësisë ripërtëritëse të infrastrukturës kritike dhe asaj publike, bazuar rezultateve të të cilit do të prioritizohen objektet më në nevojë, do të hartohet projekti i tyre dhe do të kryhen punimet e rehabilitimit të tyre

### 2.6. Koncepti i Strategjisë së ZRF

Koncepti i Strategjisë ishte të siguronte se ishin përshkruar konceptet dhe kornizat kombëtare dhe ndërkombëtare të zvogëlimit të riskut të fatkeqësive. Secili prej rreziqeve u përshkrua, dhe për secilin u renditën boshllëqet dhe mundësitë, si dhe nevojat për të zvogëluar në mënyrë të qëndrueshme riskun nga fatkeqësitë. Përmbajtja e Strategjisë është si më poshtë:

1. Hyrje
2. Gjendja aktuale dhe tendencat
3. Vizioni, Treguesit dhe Qëllimet e Politikave
4. Strategjia e zbatimit dhe Korniza Financiare

## 3. Gjendja aktuale dhe tendencat: sfidat

Ky seksion i Strategjisë shtjellon statusin e menaxhimit të riskut, nevojat dhe potencialet duke përshkruar statusin e secilit risk, faktorët e riskut, kapacitetet dhe boshllëqet e sektorëve të përfshirë në menaxhimin e riskut të fatkeqësive sipas riskut specifik dhe në fund përshkruan nevojat e zhvillimit strategjik.

### 3.1. Tërmetet

Tërmeti përkufizohet si lëkundje intensive e sipërfaqes së Tokës e shkaktuar nga lëvizjet në shtresat më të jashtme të Tokës[6]. Si i tillë ai klasifikohet si rrezik gjeologjik ose gjeofizik që do të thotë se është rezultat i proceseve të brendshme të Tokës[7]. Tërmetet mund të shkaktojnë lëngëzim, rrëshqitje të tokës, zjarre dhe cunami, të cilat më pas çojnë në nivele shumë më të larta dëmtimesh dhe humbjesh[8].

[5] Udhëzime Operacionale Standarde (Standard Operational Guidelines)
[6] https://spaceplace.nasa.gov/earthquakes/en/
[7] https://www.undrr.org/terminology/hazard
[8] https://www.preventionweb.net/files/52828_01earthquakehazardandriskassessment.pdf

Shqipëria karakterizohet nga veprimtaria e mikrotërmeteve intensive ($1.0 < M \leq 3.0$), e tërmeteve me madhësi të vogël ($3.0 < M \leq 5.0$) dhe mesatare ($5.0 < M \leq 7.0$) dhe vetëm rrallë nga ngjarje me tërmete të mëdha ($M > 7.0$). Shqipëria është një vend që ka përjetuar ngjarje të rëndësishme dhe të rënda sizmike, me 10 tërmete me magnitudë ≥ 6.0 Ms për periudhën 1919 deri më sot, brenda territorit të vendit.

Në Shqipëri ka tri zona sizmo-gjenike gjatësore (Joniane-Adriatike, Shkodër-Mat-Bilisht dhe Drini [Peshkopi-Korçë]) dhe tri tërthore (Shkodër-Pejë, Lushnjë-Elbasan-Dibër dhe Vlorë-Tepelenë).

Në përgjithësi, faktorët kryesorë të riskut për rrezikun sizmik në Shqipëri përfshijnë infrastrukturën e dobët dhe ndërtimet e paligjshme dhe/ose të papërgjegjshme të ndërtesave, të cilat shpesh përfshijnë mosrespektimin e kritereve të sigurisë së vetë ndërtimit dhe vendosjen e ndërtesave në zona me risk të lartë sizmik siç është ish-këneta e Durrësit, ku një tërmet shkakton shembjen e ndërtesave. Përveç kësaj, ekziston një nivel i ulët i sigurimit të pasurive të paluajtshme dhe aftësisë së popullsisë së varfër ekonomikisht (veçanërisht rurale) për t'u rimëkëmbur nga pasojat e tërmeteve.

Për më tepër, në Shqipëri ka 362 diga më të larta se 15 m me zona të populluara poshtë tyre. Ato janë relativisht të vjetra, veçanërisht ato në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural apo pushtetit vendor, të cilat përbëjnë rreth 90% të digave dhe për rrjedhojë më të cenueshme ndaj aktivitetit sizmik. Gjithashtu, kërkohet edhe ndërtimi i digave të reja, disa prej të cilave në zonat e ekspozuara ndaj rrezikut sizmik nga pikëpamja gjeologjike.

Një histori e gjatë tërmetesh në Shqipëri jo vetëm që ka nisur zhvendosjen e popullsisë nga zonat e goditura nga një tërmet, por ka ndikuar ndjeshëm edhe në trashëgiminë kulturore të Shqipërisë. Aktualisht mbi 2220 pasuri kulturore dhe mbi 210 qendra historike, zona të mbrojtura dhe zona arkeologjike të listuara në regjistrin kombëtar të trashëgimisë kulturore konsiderohen të prekshme nga tërmetet për shkak të një sërë faktorësh si vjetërsia e ndërtesave, kushtet e dobëta teknike të ndërtimit dhe projektimit dhe mungesa e mirëmbajtjes. Duke qenë se dëmtimi i aseteve kulturore rezulton jo vetëm në humbje të koleksioneve muzeale, fondeve arkeologjike dhe dokumenteve të rëndësishme arkivore, por edhe në humbje të kujtesës kolektive të komunitetit, humbja e trashëgimisë u vendos një nga shtyllat kryesore në Ligjin 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile".

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) është institucioni këshillimor teknik dhe shkencor i shtetit që ushtron aktivitete në fushën e shkencave të tokës në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ka një bazë të dhënash të fuqishme në lidhje me veprimtarinë e rreziqeve të ndryshme natyrore, përfshirë hartat e rreziqeve gjeologjike. SHGJSH luan një rol kritik në parandalimin e fatkeqësive por edhe në aktivitete të ZRF.

Departamenti i Sizmologjisë së IGJEO (Universiteti Politeknik i Tiranës) është e vetmja njësi operacionale dhe shkencore në Shqipëri që mbulon monitorimin e vazhdueshëm të sizmicitetit në vend. Qendra Kombëtare e Monitorimit të aktivitetit sizmik ka detyrë parësore monitorimin e pandërprerë 24 orë në 24, të aktivitetit sizmologjik të ndodhur brenda territorit të Shqipërisë dhe rreth saj.

Në kuadër të emergjencave civile, kjo qendër mundëson informim thuajse në kohë reale të strukturave përkatëse operacionale mbi situata të emergjencave sizmike. Për përmbushjen e kësaj detyre parësore me një rëndësi të madhe për vendin, kjo qendër disponon dhe operon Rrjetin Sizmologjik Shqiptar, pjesë e të cilit janë:

- rrjeti i lëkundjeve të dobëta sizmike ose rrjeti sizmografik (AWMN);
- rrjeti i lëkundjeve të forta ose akselerografik (ASMN);

- rrjeti gjeodezik në ndihmë të studimit të karakteristikave sizmotektonike të Shqipërisë i përbërë nga disa stacione permanente regjistrimi (GPS). Stacionet e Përhershme (AlbGNSS).

Ka mangësi financiare, për studime të thelluara gjeologjike-inxhinierike të tërmeteve, të cilat reflektohen edhe në mungesën e pajisjeve të modernizuara (sizmografë) për matjen e energjisë së tërmeteve dhe përcaktimin e vendndodhjes së epiqendrave. Për më tepër, është perceptuar një mungesë e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërkombëtar për përparimin e sizmologjisë, si dhe përpjekje të fokusuara në parandalimin e humbjeve të jetëve.

Boshllëku kryesor në sistemin shqiptar të qeverisjes së ZRF-së do të ishte mungesa e strategjisë për zvogëlimin e riskut nga tërmetet, si dhe ristrukturimi organizativ dhe financat e lidhura ngushtë me të. Ka kapacitete të kufizuara si për financat ashtu edhe për personelin e administratës vendore në trajtimin e risqeve dhe pasojave të tërmeteve. Kur bëhet fjalë për parandalimin e fatkeqësive, ekziston ende mosndëshkimi për individët dhe personat juridikë që ndërtojnë pa leje në toka ku ndërtimi është i ndaluar me ligj, ose injorojnë masat e ndërtimit rezistente ndaj tërmeteve. Për më tepër, ndërtesat (përfshirë ato historike dhe veprat e artit) dhe infrastruktura e dëmtuar më parë nga tërmetet ende nuk janë përforcuar nga ana strukturore për t'i bërë ballë tërmeteve të ardhshme dhe ka mangësi kur bëhet fjalë për standardet e rindërtimit. Në rast tërmeti për mungesë fondesh do të ketë sfida lidhur me vlerësimin e ndërtesave dhe rikonstruksionin e godinave të vlerësuara nga autoriteti përkatës. Gjithashtu, ende nuk janë konsoliduar njësitë organizative të mbrojtjes civile në administratën qendrore dhe strukturat e planifikimit dhe MC në administratën lokale, gjë që me shumë mundësi do të çojë në vonesa në përgjigjen ndaj tërmeteve dhe dëmtime dhe humbje më të mëdha. Së fundmi, nivelet e ndërgjegjësimit dhe gatishmërisë të popullatës së përgjithshme ndaj tërmeteve janë të ulëta.

Në komunikim me qeverinë dhe institucionet përkatëse shtetërore, janë evidentuar masa të shumta të nevojshme për rritjen e aftësisë ripërtëritëse kombëtare ndaj tërmeteve, disa prej të cilave janë:

- Krijimi/përmirësimi i dokumenteve strategjike që adresojnë riskun e tërmeteve në çdo bashki;
- Rritja e numrit të ekspertëve të fushës në administratën vendore;
- Përditësimi dhe zbatimi i hartave dhe Kodeve të Rrezikut Sizmik për Projektimin e Ndërtesave Rezistente ndaj Tërmeteve në përputhje me Eurokodin;
- Kryerja e vlerësimeve sizmike të digave, shkollave, spitaleve dhe institucioneve të tjera që ushtrojnë funksione kolektive, godinave të Ministrive dhe institucioneve përbërës të Komisionit Teknik Këshillimor si dhe objekteve të tjera informale;
- Pushteti qendror dhe vendor duhet të sigurojnë që rezultatet e studimeve të SHGJSH të merren parasysh në planifikimin urban dhe menaxhimin e territorit të bashkive në mënyrë që të mos jepen leje ndërtimi në zona me ekspozim të lartë ndaj efekteve të tërmeteve;
- Rritja e shkallës së përgjegjësisë vendimmarrëse lidhur me menaxhimin e territorit dhe plotësimi i kuadrit ligjor të nevojshëm lidhur me punimet e ndërtimit dhe aspektet mjedisore që çojnë në ndryshimin e ekuilibrit natyror të territorit;
- Dënimi i personave dhe personave juridikë që ndërtojnë objekte pa leje ose nuk respektojnë masat e sigurisë në ndërtim;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të monitorimit sizmik;
- Bashkëpunimi për ZRF me vendet fqinje që përjetojnë aktivitet të ngjashëm sizmik si Shqipëria;
- Konsolidimi i stafit të Mbrojtjes Civile në administratën qendrore dhe lokale;

- Ngritja e kapaciteteve të reaguesve të parë dhe bashkëpunimi i tyre me AKMC-në dhe organet e tjera qeveritare dhe joqeveritare;
- Koordinimi i programeve/strategjive për trajtimin e pasojave të tërmeteve për të minimizuar risqet dhe kostot përkatëse të rimëkëmbjes;
- Përfshirja e informacionit bazë për tërmetet në kurrikulat shkollore.

Gjithashtu, theks i veçantë i është kushtuar mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Duhen marrë masa të shtuara për përforcimin strukturor sizmik të ndërtesave historike duke ruajtur në maksimum vlerat e trashëgimisë, nëpërmjet metodave tradicionale të përforcimit dhe restaurimit në masën maksimale të mundshme, duke siguruar nivele optimale të sigurisë. Duke qenë se ka vetëm pak mjeshtër të aftë në ndërtimet tradicionale, duhet të organizohet transferimi i njohurive dhe trajnimet e mjeshtrave të rinj të ndërtimit tradicional me manualet dhe udhëzuesit përkatës, si dhe trajnime për ekipet operacionale të emergjencave civile për përgjigjen emergjente ndaj trashëgimisë kulturore të dëmtuar. Për më tepër, është propozuar edhe zhvillimi i aplikacionit ueb/mobil për mbledhjen në kohë reale të të dhënave për dëmtimin e aseteve kulturore në rast fatkeqësie.

## 3.2. Përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave

Mesatarja vjetore e reshjeve në Shqipëri është 1,485 mm/vit. Ajo varion nga 1000 mm/vit për ultësirat deri në 3000 mm/vit në zonat malore. Rreth 70% e totalit të reshjeve vjetore bie në periudhën tetor-mars. Nëntori është muaji me nivelin më të lartë të reshjeve.

Në Shqipëri rreth 130 000 ha janë të mbuluara me infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytjet. Megjithatë, përmbytjet e dimrit dhe thatësirat e verës po bëhen gjithnjë e më të shpeshta, veçanërisht gjatë dy dekadave të fundit.

Infrastruktura mbrojtëse e lumenjve dhe përrenjve malorë në vend është ndërtuar kryesisht pas përmbytjeve katastrofike të dimrit 1962-63. Përmbytje të konsiderueshme kanë ndodhur edhe në jug të vendit, në vitet 2015, 2017, 2018 dhe 2021.

Një vlerësim i bërë për gjendjen teknike të 626 digave, rezultoi në përfundimin se 410 (ose 65% e numrit të përgjithshëm), shfaqin probleme të theksuara teknike dhe kërkojnë vëmendje urgjente.

Drenazhimi i ujërave është përkeqësuar gjithashtu për shkak të përmbytjeve të kanaleve kulluese dhe uljes së kapacitetit kullues të hidrovorëve. Situata pritet të përkeqësohet më tej për shkak të ndryshimeve klimatike, të cilat janë pasqyruar në fenomene ekstreme të motit.

Vlerësohet se ka një numër të konsiderueshëm ndërtimesh pa leje në infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet. Urbanizimi dhe ndërhyrja njerëzore nga njëra anë, degradimi natyror nga ana tjetër, kanë bërë që shumë prej infrastrukturave mbrojtëse të jenë jashtë funksionit ose gjysmë-funksionale, në një mjedis ku frekuenca, ashpërsia dhe shpërndarja gjeografike e përmbytjeve janë në rritje.

Për sa i përket sistemeve të paralajmërimit të hershëm (EWS) në lidhje me përmbytjet, duhet të theksohet se deri më tani janë kryer disa studime të paralajmërimit të përmbytjeve duke synuar pellgje të shumta lumore.

Instituti i GjeoShkencave është aktori kryesor që zbulon, monitoron, analizon, parashikon dhe shpërndan dhe komunikon në kohë informacionin paralajmërues për përmbytjet e mundshme.

Për të forcuar dhe rritur nivelin e menaxhimit të riskut nga përmbytjet, Shqipëria po harton dokumentin e Planit të Menaxhimit të Riskut të Përmbytjeve të përbërë nga 3 komponentë:

1. Vlerësimin Paraprak të Riskut nga përmbytjet që çon në identifikimin e zonave ku ekziston risku i mundshëm i përmbytjeve ose ka të ngjarë të ndodhin përmbytje;
2. Hartat e rrezikut dhe hartat e riskut nga përmbytjet;
3. Planet e menaxhimit të riskut nga përmbytjet.

Ngjarjet e kaluara që janë vlerësuar kanë shërbyer si informacion i përgjithshëm për identifikimin e zonave të mundshme me risk të lartë të përmbytjeve.

Pavarësisht ndërhyrjeve të bëra në infrastrukturën e mbrojtjes nga lumenjtë, përmbytjet masive dhe të zgjatura, të ndodhura në vitet 2010-2021 tregojnë një rritje të shpeshtësisë së përmbytjeve, e cila ka të bëjë si me faktorë natyrorë ashtu edhe me faktorë njerëzorë.

Disa nga këta faktorë janë: reshjet në sasi dhe intensitet të madh (të pa regjistruara më parë), prurjet e ujit dhe luhatjet e shpejta të nivelit të rrjedhës në shtretërit e lumenjve, ndryshimet në grykëderdhjet e lumenjve, shpyllëzimi, ndryshimi i mbulesës bimore në zonën e ujëmbledhësit, përdorimi pa kriter i agregateve në shtretërit e lumenjve, hedhja e agregateve dhe mbetjeve urbane duke zvogëluar seksionin shoqërues të shtratit të lumit, urbanizimi i zonave pranë brigjeve të lumenjve dhe modifikimi i terrenit dhe zhvillimi i rrugëve përgjatë luginave të lumenjve. Ndikimet e ndryshimeve klimatike përsa i përket ekstremeve të parashikuara të motit, si p.sh. ngjarjet e reshjeve të mëdha dhe rritja e reshjeve janë të lidhura me shfaqjen e përmbytjeve, veçanërisht gjatë dimrit, por edhe gjatë muajve të vjeshtës dhe pranverës. Në të njëjtën kohë, për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit të infrastrukturës vaditëse dhe uljes së reshjeve gjatë muajve të verës, pritet edhe rritje e thatësirës, të gjitha lidhur me çështjen e praktikave ende joadekuate të menaxhimit të ujit.

Kuadri legjislativ i menaxhimit të ujërave i përcaktuar me Ligjin Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” përcakton masat për zbutjen efektive si të përmbytjeve ashtu edhe të thatësirave. Megjithatë, pritet që thatësira të ndikojë në sektorin e bujqësisë më shumë sesa përmbytjet apo rrëshqitjet e tokës në të ardhmen e afërt si rezultat i ndryshimeve klimatike. Faktorë shtesë si temperaturat e larta, erërat e forta dhe lagështia e ulët relative kanë potencialin të kontribuojnë gjithashtu në ashpërsinë e një ngjarjeje dhe të gjithë lidhen me ndryshimin e klimës. Thatësirat kanë potencialin të kenë ndikime negative në shkallë të gjerë në sektorin e bujqësisë në Shqipëri. Mbi 3 milionë njerëz u prekën nga thatësira e viteve 1989-1991, e cila ishte një nga fatkeqësitë më të domethënëse që ndodhi në Shqipëri dhe i kushtoi ekonomisë 24 milionë dollarë[9].

Duhet theksuar gjithashtu se siguria e projektimit të argjinaturave në vitet '60, mbi bazën e plotë me një periudhë përsëritjeje nga 10 deri në 35 vjet, është më e ulët, me përllogaritje të plota bazuar në seritë aktuale, të cilat japin vlera të tjera. Përveç kësaj, kapacitetet teknike dhe operacionale të institucioneve shqiptare për parashikimin, monitorimin dhe paralajmërimin e të dhënave hidro-meteorologjike konsiderohen ende të pamjaftueshme dhe si rrjedhojë ka nevojë për investime të mëtejshme në Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH).

Përsa i përket mbrojtjes nga përmbytjet, nga 850 km argjinatura lumore dhe detare, rreth 300 km argjinatura kanë nevojë për riparim, rehabilitim, rindërtim, apo ridimensionim për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në dekadat e fundit.

Ekziston gjithashtu nevoja për modernizim dhe rehabilitim të rrjetit të stacioneve të motit, mirëmbajtje të rregullt të pajisjeve, lidhje të rregullta të besueshme në internet, staf të ri të kualifikuar, si hidrologë dhe meteorologë dhe dixhitalizim të të dhënave me qëllim përmirësimin e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm të Shqipërisë.

---

[9] FAO. (2018) Analizë gjithëpërfshirëse e reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe e sistemit të menaxhimit për bujqësinë në Shqipëri . https://www.fao.org/publications/card/en/c/I8866SQ/

Objektivat kryesore për mbrojtjen nga përmbytjet që duhen arritur brenda një periudhe 9-vjeçare janë:

1. Zvogëlimi i dëmeve nga përmbytjet dhe humbjeve në më pak se 50% të asaj që ka ndodhur vitet e fundit;
2. Rehabilitimi dhe modernizimi i infrastrukturës së dëmtuar dhe ku ka risk shembjeje;
3. Ndërtimi i infrastrukturës së re për zbutjen e përmbytjeve dhe thatësirës aty ku është e nevojshme;
4. Trajnimi i personelit të institucioneve përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në drejtim të monitorimit, projektimit, ndërtimit dhe riparimit të infrastrukturës mbrojtëse;
5. Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së forcave operacionale ndaj përmbytjeve.

Përveç mbrojtjes së zonave shumë të populluara, qëllimi është të identifikohen zonat dhe kufijtë për mbajtjen e ujit ose zonat e evakuimit dhe të kufizohet ndërtimi i mbrojtjes nga përmbytjet, si argjinaturat, përforcimet e argjinaturës, etj., të cilat në fakt mund të pengojnë lëvizjen natyrale të ujit.

Në të njëjtën kohë, duhet të merren masa jo-strukturore, të cilat janë parandaluese dhe kanë të bëjnë me menaxhimin e zonave me risk nga përmbytjet, si vlerësimi i riskut si për përmbytjet ashtu edhe për thatësirat, hartografimi, paralajmërimi i hershëm dhe sistemet e parashikimit. Duhet të bëhet një vlerësim i mbrojtjes shtesë nga përmbytjet e nevojshme në zonat me risk të mesëm dhe të lartë nga përmbytjet dhe duhet të organizohet ndërtimi i kapaciteteve të personelit në strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin. Masat e tjera kyçe përfshijnë: hartimin e kurrikulave shkollore për riskun nga përmbytjet, bashkëpunimin me vendet fqinje në lidhje me përmbytjet, rritjen e numrit të ekspertëve të fushës në administratën lokale, programet për trajtimin e pasojave të fatkeqësive nga përmbytjet për të minimizuar risqet dhe kostot përkatëse të rimëkëmbjes, shqyrtimi rast pas rasti i legjislacionit për çdo leje ndërtimi dhe një bazë të dhënash për të gjitha të dhënat e lidhura me riskun nga përmbytjet.

## 3.3. Rrëshqitjet e tokës, reshjet e dëborës dhe ortekët

*Rrëshqitjet e tokës* i përkasin grupit të rreziqeve gravitacionale. *Rrëshqitjet* e tokës përkufizohen si dukuri fiziko-gjeologjike që përfaqësojnë një zhvendosje të masave të tokës pa rrokullisje nën veprimin e forcës së gravitetit.

Territori i Republikës së Shqipërisë konsiderohet një vend i ekspozuar ndaj ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve natyrore, duke përfshirë, rreziqet me origjine hidrometeorologjike (përmbytjet), meteorologjike (thatësirat, zjarret në pyje) si dhe rrëshqitjet e tokës.

Këto dukuri apo fenomene mund të jenë natyrore të shkaktuara nga faktorë të ndryshëm gjeologjikë, por mund të shkaktohen edhe nga veprimtaria e njeriut (artificiale). Klima ka një ndikim të drejtpërdrejtë në erozionin e tokës.
Shumë nga pasuritë kulturore ndodhen në terrene të pjerrëta dhe/ose në rrëzë të kodrave dhe maleve. Monumentet kulturore por edhe keshtjellat dhe vendet arkeologjike, janë të cenueshme nga rrëshqitjet e tokës si dhe rrëzimet apo shembjet e masave shkëmbore.

Faktorë të rëndësishëm të riskut janë shpyllëzimi dhe dëmtimi i zonave pyjore e vegjetative, dëmtimi i zonave kodrinore nga ndërtimet e papërgjegjshme si dhe dëmtimi i zonave malore nga shfrytëzimi i materialeve ndërtimore (p.sh. guroret) pa kritere dhe pa studimet e duhura gjeologjike. Gjithashtu, dëmtimet dhe devijimet e shtretërve të lumenjve për qëllime ndërtimi ose shfrytëzimi (p.sh., shfrytëzimi pa kriter dhe i pakontrolluar i inerteve), si dhe dëmtimi i kanaleve kulluese ndikojnë në risk në masë të madhe. Për më tepër, korrelacioni i ulët midis efekteve të pritshme të ndryshimeve klimatike si dhe politikave dhe programeve për adresimin e pasojave, kontribuon në nivelin e riskut. Në këtë drejtim, tendencat e ndryshimeve klimatike

po ndikojnë në potencialin e rritjes së sipërfaqeve të pyllëzimit të vlerësuar në 300 ha në vit.

Aktualisht ka vlerësime të mjaftueshme të riskut nga rrëshqitjet e tokës që mund të përdoret si udhërrëfyes për zhvillimin dhe planifikimin hapësinor dhe planet lokale për të zvogëluar këtë risk. Institucioni i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, në lidhje me dukuritë negative gjeodinamike, zotëron një bazë të fuqishme të dhënash duke kryer një numër të madh studimesh me produktet përfundimtare (harta dhe tekste shpjeguese të tyre).

Gjithashtu është në proces rajonizimi gjeologo-inxhinierik për territoret e bashkive të vendit.
Pavarësisht sa më sipër, ka ende pune për të bërë në këtë drejtim, si në perfeksionimin e produkteve të zhvilluara deri tani, ashtu edhe në avancimin e mëtejshëm, për përcaktimin dhe evidentimin e dukurive gjeodinamike, regjistrimin e tyre dhe monitorimin e atyre me rrezikshmëri të madhe.
Në sektorin e bujqësisë, është konstatuar se problemet kryesore të njohura ndër vite janë: emergjenca e shtretërve të lumenjve që shkaktojnë përmbytje dhe gërryerje të tokave bujqësore, dëmtimi i tokës bujqësore nga ndërtimet pa leje, shfrytëzimi i lumenjve për marrjen e inerteve lumore për ndërtime. Problematike është dëmtimi i tokës bujqësore nga ndikimi i ujërave të larta dhe erozioni, të cilat shkaktojnë zhavorr dhe gërryerje të tokës bujqësore. Shfrytëzimi jo i përshtatshëm i tokës në zona të pjerrëta etj. Moszbatimi i praktikave të mira bujqësore lidhur me; Shfrytëzimin e pamjaftueshëm të kanaleve të ujërave të larta, përdorimi i sistemeve joadekuate të ujitjes, etj. Shpyllëzimi dhe mbi-kullotja redukton bimësinë dhe e ekspozon tokën ndaj faktorëve klimatikë. EWS janë jashtëzakonisht të rëndësishme kur bëhet fjalë për rritjen e kapacitetit për të zbutur risqet nga rreziqet natyrore, veçanërisht në lidhje me bujqësinë dhe ato mungojnë në Shqipëri. Gjithashtu, në nivel lokal, në risk kontribuon edhe mungesa e njohurive të ekspertëve të pushtetit vendor për fenomenin e erozionit dhe masat parandaluese për zvogëlimin e riskut.

Kontributi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, në kuadër të veprimtarisë për përballimin e emergjencave civile, përfshihet brenda kompetencave të saj. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ka një bazë të dhënash të vlefshme lidhur me veprimtarinë e dukurive të ndryshme natyrore të cilat rrezikojnë komunitetin në përgjithësi. IGJEO është një qendër kombëtare kërkimore dhe është identifikuar si agjencia kombëtare e monitorimit dhe paralajmërimit për rreziqet natyrore. Instituti është i miratuar nga Organizata Botërore e Meteorologjisë (OBM) si Shërbimi Kombëtar Meteorologjik dhe Hidrologjik (SHKMH) për Shqipërinë.

Përveç zonave të mbrojtura, fenomeni i rrëshqitjes prek edhe shumë zona të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku vëmendje më e madhe u duhet kushtuar zonave të populluara, veprave inxhinierike (kryesisht digat, urat, rrugët nacionale, hekurudhat etj.), zonave turistike dhe tokave bujqësore e pyjeve.

Për studime të thelluara gjeologo-inxhinierike të rrëshqitjeve dhe studimeve në përgjithësi ka mangësi financiare. Gjithashtu, për përpunimin dhe leximin e materialit gjeologjik është e nevojshme prania e një specialisti gjeolog në organikën e qeverisjes vendore. Ka mungesë të konsiderueshme të investimeve në infrastrukturë për monumentet kulturore dhe historike. Konstatohen politika dhe fonde të pamjaftueshme për të adresuar problemet e shpyllëzimit si dhe niveli i ulët i zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e pyjeve dhe mbrojtjen e territorit në përgjithësi. Mungesa e një harte të konsoliduar të zonave/akseve rrugore të rrezikuara historikisht nga rrëshqitjet e tokës. Aftësia e ulët për të rikuperuar dëmet në zonat rurale për shkak të nivelit të ulët ekonomik të popullsisë dhe kapacitetit të ulët financiar të bashkive përkatëse. Mungesa e studimeve të thelluara gjeologjike për parandalimin e rrëshqitjeve në të ardhmen lidhur me akset rrugore që ndër vite kanë shfaqur probleme. Mbështetje e ulët financiare për programet e pyllëzimit në zonat me risk të lartë erozioni. Niveli i ulët i njohurive për përdorimin e burimeve tokësore lidhur me erozionin dhe EWS joadekuate në lidhje me

kushtet e motit që ndikojnë në shfaqjen dhe aktivizimin e rrëshqitjeve të tokës.

Ortekët e borës, të ngjashme me rrëshqitjet e tokës, i përkasin rreziqeve gravitacionale. Një ortek karakterizohet nga lëvizja e shpejtë në rënie e një mase dëbore.

Shqipëria është një vend i karakterizuar nga pjerrësi e lartë e shpateve të kodrave (>30%), bimësi e varfër pyjore në shumë rajone dhe reshje intensive të borës dimërore. Të kombinuara këto kushte janë të favorshme për shfaqjen e ortekëve që për shkak të modeleve demografike të vendit shoqërohen shpesh me dëmtime materiale. Reshjet e larta të borës janë karakteristike për Alpet Shqiptare dhe për rajonet malore qendrore dhe jugore. Periudha me riskun më të lartë për reshje të dendura bore është nga nëntori deri në fund të marsit. Vetëm në vitin 1985 ortekët shkaktuan vdekjen e 68 personave dhe shkatërrimin e 1604 shtëpive.

Reshjet konsiderohen si shkaktari më i madh i erozionit për shkak të intensitetit dhe shpërndarjes së tyre të parregullt gjatë vitit. Ortekët e borës shkaktohen kryesisht nga reshjet e dendura dhe erërat e forta që çojnë në grumbullimin e shtresave të paqëndrueshme të borës.

Mund të supozohet se pjesa më e madhe e ndërtesave në Shqipëri i përkasin klasave të ndërtesave me rezistencë mesatare dhe të lartë ndaj ndikimit të rrëshqitjes së dheut ose ortekëve. Megjithatë, reshjet e mëdha të borës dhe orteqet e shpeshta kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në dimrat e viteve 1933/34, 1940/41, 1953/54, 1963/64 dhe 1972/73 dhe në vitin 1985. Gjithashtu, mungon harta e konsoliduar e rrugëve/zonave të rrezikuara historikisht nga reshjet e borës dhe EWS joadekuate në lidhje me kushtet e motit që ndikojnë në shfaqjen dhe aktivizimin e ortekëve.

Disa nga masat e nevojshme për përmirësimin e aftësisë ripërtëritëse nga lëvizjet sizmike, rrëzimet e shembjet e masave shkëmbore, lëvizjet e tjera masive, dhe rrëshqitjeve të tokës dhe ortekëve janë:

- Hartimi i instruksioneve/udhëzimeve teknike që mund të përdoren në të ardhmen nga të gjitha njësitë vendimmarrëse në fushën e ndërtimit, në nivel vendor dhe qendror;
- Hartimi i Modelit të Pasaportës së Ndërtesës, me qëllim mbledhjen e informacionit teknik për njësitë e ndërtesës, për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë dhe ekspozimit në një shkallë më të vogël, në kuadër të regjistrimit të ardhshëm;
- Hartimi i udhëzimeve teknike për vlerësimin e infrastrukturës kritike;
- Përgatitja e udhëzimeve teknike dhe propozimi i masave ligjore për fazën e tranzicionit gjatë përmirësimit të kodeve të projektimit;
- Ndërgjegjësimi dhe njohja e studimeve kërkimore midis zyrtarëve të pushtetit qendror dhe vendor për të marrë parasysh gjetjet gjatë hartimit të planeve urbane dhe menaxhimit të përdorimit të territorit në Bashki;
- Rritja e ndërgjegjësimit të popullsisë, monitorimi i territorit;
- Monitorimi rigoroz i shfrytëzimit të lumenjve, ndërtimi i argjinaturave në zonat e dëmtuara;
- Përgatitja e një harte të konsoliduar të zonave/akseve rrugore të rrezikuara historikisht nga rrëshqitjet (zonimi i rrëshqitjeve);
- Përgatitja e një plani emergjence në rast të përballjes me një fatkeqësi natyrore/rrëshqitje toke;
- Përgatitja e një harte të konsoliduar të zonave/akseve rrugore historikisht të rrezikuara nga ortekët.

## 3.4. Zjarret në pyje

Zjarr në pyll, shkurre ose bimësi, mund të përshkruhet si çdo djegie ose djegie e pakontrolluar dhe e papërshkruar e bimëve në një mjedis natyror si p.sh. një pyll, livadhe ose tokë me shkurre, e cila konsumon lëndët djegëse natyrore dhe përhapet në bazë të kushteve mjedisore (p.sh., era, topografia). Mund të nxitet nga veprimet njerëzore dhe më pas konsiderohet si një rrezik antropogjenik, ose një rrezik hidrometeorologjik nëse provokohet nga thatësira ekstreme dhe, në raste të rralla, nga rrufeja[10].

Sipas raporteve për vlerësimin e riskut në kuadër të projekteve që përfshijnë Raportin e Vlerësimit të Riskut të Fatkeqësive Natyrore 2003[11] dhe Struktura Globale për Zvogëlimin dhe Rimëkëmbjen nga Fatkeqësitë (SGZRF) mjeti ThinkHazard[12], rreziku nga zjarret në pyje në Shqipëri klasifikohet si i lartë. Kjo do të thotë se mundësia e kushteve të motit që mbështesin zjarre pyjore të mëdha që mund të rezultojnë në humbje të jetës dhe pronës në çdo vit të caktuar është më e madhe se 50%. Dëmtimi mund të ndodhë si rezultat i ekspozimit të drejtpërdrejtë të flakës dhe rrezatimit, si dhe nga stuhia e prushit dhe zjarri i nivelit të ulët në sipërfaqe. Zonat me pyje dhe bimësi janë kryesisht të rrezikuara nga zjarret e shkaktuara nga njeriu dhe/ose temperaturat e larta gjatë verës.

Risku i zjarreve në pyje me siguri do të rritet në të ardhmen për shkak të ndryshimeve klimatike. Projeksionet e modeluara të klimës së ardhshme identifikojnë një rritje të mundshme në shpeshtësinë dhe ashpërsinë e zjarreve në pyje në Shqipëri, duke përfshirë një rritje të temperaturës në përgjithësi dhe periudha të zgjatura thatësire. Sipas parashikimeve të ndryshimeve klimatike, temperatura mesatare vjetore do të rritet krahas shpeshtësisë së temperaturave jashtëzakonisht të larta, numrit të netëve tropikale dhe kohëzgjatjes së valëve të të nxehtit. Në të njëjtën kohë, parashikohet një ulje e reshjeve vjetore, veçanërisht për muajt e verës, gjë që çon në rritjen e rrezikut të zjarreve. Sezoni i zjarreve ka të ngjarë të rritet në kohëzgjatje dhe të përfshijë një numër më të madh ditësh me mot që mund të mbështesë përhapjen e zjarrit për shkak të periudhave më të gjata pa shi gjatë sezoneve të zjarrit.

Pavarësisht angazhimeve serioze të qeverisë, zvogëlimi i riskut nga zjarret në pyje mbetet një problem madhor në Shqipëri. Së pari, nuk ka ende një dokument të duhur që adreson risqet e zjarreve masive në pyje që të shërbejë si udhërrëfyes për planifikimin hapësinor lokal dhe kombëtar duke marrë parasysh këtë risk. Së dyti, aktet ligjore jo shumë të kuptueshme dhe institucionet me detyra të dyfishta rezultojnë në vendimmarrje shpesh me vonesë, gjë që reflekton në cilësinë e ndërhyrjes për zjarret masive në pyje. Së treti, nuk ka një sistem të mbikëqyrje-sinjalizimit të zjarrit (në pyje) mbarëkombëtar që siguron ndërhyrjen në kohën e duhur. Gjithashtu, janë konstatuar mangësi të theksuara në mjetet zjarrfikëse si dhe mungesë fondesh për trajnimin dhe përgatitjen e forcave të ndërhyrjes. Për më tepër, aktualisht janë rreth 626 rezervuarë për ujitje artificiale të listuara në Kadastrën e Ujit, e cila është dixhitalizuar dhe menaxhuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, por nuk ka informacion në lidhje me vendndodhjen dhe kapacitetin e tyre ujor, duke e ulur efikasitetin e tyre për tu përdorur në dispozicion të shuarjes së zjarreve. Ngjashëm me rreziqet e tjera, IGJEO është përgjegjëse për shpërndarjen e EW, duke përfshirë shpërndarjen e të dhënave të parashikimeve dhe monitorimit të zjarreve tek AKMC dhe partnerë të tjerë ZRF në nivele të ndryshme. Në baza ditore gjatë kohës së verës (sezoni i thatë) Qendra Kombëtare e Parashikimit dhe Monitorimit të Rreziqeve Natyrore nxjerr Buletinin e Paralajmërimit për Zjarret në Pyje, i cili i dërgohet me e-mail AKMC, ministrive, prefekturave dhe bashkive. Në punën e

[10] https://www.un-spider.org/category/disaster-type/forest-fire
[11] https://www.geo.edu.al/durres/risk.pdf
[12] https://thinkhazard.org/en/report/3-albania/WF

tyre, Qendra përdor modelin RISICO për të parashikuar dhe monitoruar rreziqet nga zjarret në pyje për të gjithë territorin e Shqipërisë.

Ministria e Kulturës raporton se objektet e trashëgimisë kulturore janë mjaft të cenueshme në lidhje me zjarrin për shkak të mirëmbajtjes së ulët, e cila reflekton në zbulimin e vonuar të tymit brenda ndërtesave, testimin e parregullt të sistemeve automatike të mbrojtjes nga zjarri dhe zjarrfikësve, praninë e linjave të vjetëruara dhe të paizoluara të energjisë që shpesh kalojnë përgjatë tavaneve dhe dyshemeve me çati prej druri me shkallë të lartë ndezjeje dhe shpërndarje si dhe pajisje që mund të reagojnë si burim zjarri dhe rrugë shumë të ngushta në monumente dhe vende të ndryshme që pengojnë aksesin e automjeteve zjarrfikës, ose ka mungesë të plotë aksesi në objektet në zonat e thella malore.

Së fundi, aktualisht ekziston një ndërgjegjësim i kufizuar i qytetarëve për riskun e zjarreve (në pyje) në përgjithësi.

Në komunikim me qeverinë dhe institucionet përkatëse shtetërore, janë evidentuar masa të shumta të nevojshme për rritjen e aftësisë ripërtëritëse kombëtare ndaj zjarreve në pyje, disa prej të cilave janë:

- Rishikimi i kuadrit ligjor dhe krijimi i një ligji kuadër (specifik) për zjarret në pyje;
- Hartimi i një dokumenti për riskun e zjarreve masive në pyje në Shqipëri që përfshin një hartë risku, si instrument për planifikimin hapësinor dhe zhvillimin e sektorit;
- Krijimi i bazës së të dhënave për të gjitha informacionet mbi risqet e zjarreve në pyje, projektet, kërkimet në lidhje me këtë risk, me referencat përkatëse;
- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe rregulloreve të përshtatshme në lidhje me aktivitetet e djegies në fusha dhe kullota në Shqipëri, të cilat do të përfshinin emërtimin e burimeve të kontrollit të ndezjes, identifikimin e sezoneve të djegies, procedurat dhe lejet për djegien, djegien e kontrolluar, sistemet e zbulimit dhe njoftimit të hershëm, etj;
- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe rregulloreve të përshtatshme në lidhje me menaxhimin e riskut nga zjarret në pyje në zonat e trashëgimisë kulturore në Shqipëri;
- Trajnimi i njësive të vetëqeverisjes vendore për sistemet e mbikëqyrje-sinjalizimit të ngritura për përmirësimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm;
- Përmirësimi i parandalimit dhe përgjigjes ndaj zjarreve në pyje duke modernizuar Qendrën Operacionale të Emergjencave Civile dhe duke siguruar burimet e nevojshme, pajisjet tokësore dhe ajrore dhe infrastrukturën e emergjencës për reaguesit e parë për të menaxhuar siç duhet zjarret në pyje, duke përfshirë edhe aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë në ofrimin e konsultimeve dhe fondet e nevojshme për zvogëlimin e riskut nga zjarret në pyje.
- Sigurimi i zjarrfikësve me informacione kritike për rezervuarët artificialë të ujit të listuar në Kadastrën Ujore me qëllim të furnizimit me ujë të automjeteve dhe shuarjen e zjarrit në pyje dhe në sipërfaqe të tokës bujqësore;
- Sigurimi i sistemeve të kontrollit të hidranteve dhe shtigjeve të pastra të evakuimit pranë aseteve kulturore;
- Trajnimi, këshillimi dhe monitorimi i fermerëve lidhur me aktivitetet e tyre djegëse për qëllime bujqësore nga Agjencia Rajonale për Ekstensionin Bujqësor e cila vepron në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Fushata ndërgjegjësuese që informojnë qytetarët për riskun e zjarrit në pyje dhe zvogëlimin e zjarreve të mundshme antropogjene në pyje të shkaktuara nga komuniteti (d.m.th. informacione dhe rregullore në lidhje me zjarret, asgjësimin dhe largimin e mbeturinave, mospirjen e duhanit etj.);
- Ofrimi i planeve të evakuimit të qytetarëve dhe organizimi i simulimeve të situatave të zjarrit për njohjen e komunitetit me procedurën e evakuimit.

## 3.5. Rreziqet nga aksidentet teknologjike

Sistemet teknologjike sipas përcaktimit shoqërohen me struktura komplekse që mbështeten në funksionalitetin e shumë nënsistemeve. Mosfunksionimi i tyre mund të jetë nga brenda kur një nga nënsistemet shembet ose mund të shkaktohet nga mjedisi i jashtëm si pasojë e goditjeve të jashtme. Sipas raportit Teknik të UNDRR mbi Përkufizimin dhe Klasifikimin e Rrezikut të vitit 2020, rreziqet teknologjike përfshijnë sistemet e transportit (tokë, det, ajër), një gamë të gjerë materialesh të rrezikshme (kimike, radiologjike, bërthamore, biologjike etj.) që mund të shkaktojnë aksidente në objektet industriale, rreziqet që lidhen me TIK-un duke pasur parasysh varësinë tonë të madhe nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit në sektorë jetikë për ekzistencën tonë (banka, energji, shëndetësi, transport etj.) duke e bërë sigurinë kibernetike prioritet në rritje.  Ndryshe nga rreziqet e tjera të prioritizuara me Strategjinë, rreziqet tekniko-teknologjike nuk kanë origjinë natyrore. Një aspekt tjetër i rreziqeve tekniko-teknologjike është lidhja e tyre me strukturat sociale dhe ndikimi i tyre në mjedis. Thënë kjo, pajisjet dhe sistemet tekniko-teknologjike mund të rrisin ose zvogëlojnë cenueshmëritë tona si shoqëri dhe u hapin derën efekteve kaskadë të fatkeqësive. Për shembull shkatërrimi i digës që shkakton një përmbytje ose nevoja në rritje për lëndë djegëse fosile që çon në degradim të tokës, erozion, rrëshqitje toke dhe përmbytje të menjëhershme. Prandaj rreziqet tekniko-teknologjike nuk mund të analizohen veçmas nga rreziqet e tjera të prioritizuara me këtë Strategji.

Sipas dokumentit të raportit të riskut teknologjik 2022, rreziqet teknologjike (industriale) janë:

- Teknologjike të instalimeve dhe pajisjeve në industrinë e kërkimit, prodhimit, përpunimit (rafinimit), transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre (lëndëve djegëse);
- Teknologjike të impianteve dhe instalimeve në industrinë e prodhimit, transportimit, përdorimit dhe depozitimit të substancave të rrezikshme industriale/kimike;
- Teknologjike të minierave dhe instalimeve në industrinë minerare, ne kërkimin (zbulimin) e shfrytëzimin e minierave dhe pasurimin e përpunimin e mineraleve;
- Teknologjike të impianteve dhe instalimeve të rrjeteve të furnizimit dhe shpërndarjes së ujit;
- Teknologjike të instalimeve industriale të prodhimit, transportimit dhe depozitimit të municioneve/lëndëve shpërthyese luftarake;
- Teknologjike të impianteve dhe instalimeve të transportimit, depozitimit dhe përdorimit të lëndëve bërthamore/radioaktive;
- Teknologjike të infrastrukturës së telekomunikacionit;
- Teknologjike të prodhimit/gjenerimit  dhe infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike;
- Teknologjike të impianteve dhe instalimeve të prodhimit në agroindustri.

Më 15 mars 2008, shpërthimi në vend-grumbullimin e municioneve pranë Tiranës shkaktoi 26 të vdekur, mbi 300 persona të plagosur, shkatërrimin e 2300 ndërtesave dhe shpërnguljen e 4000 personave. Të tjera si rrjedhjet e hidrokarbureve në 22 maj 2012 në Portin "Vlora-1" apo zjarri i rezervuarëve të naftës në Shëngjin më 17 dhjetor 2006 po tregojnë efektet negative që këto aksidente kanë në mjedis dhe ekonomi. Aksidentet e transportit janë gjithashtu të dokumentuara mirë në Shqipëri. Sipas INSTAT[13], numri i aksidenteve të raportuara të transportit në periudhën 2014-2021 është 13.742 me 18.491 viktima (të vrarë ose të plagosur). Edhe pse numri i viktimave në ngjarje individuale mund të jetë më i ulët në krahasim me aksidentet e tjera, në baza vjetore numri kolektiv është shumë më i madh duke imponuar

[13] http://www.instat.gov.al/en/themes/industry-trade-and-services/transport-accidents-and-characteristics-of-road-vehicles/#tab2

nevojën për veprime të planifikuara për zvogëlimin e këtij risku. Në tetor 2020, qeveria e Shqipërisë shpalli planin për të patur zero viktima nga aksidentet rrugore deri në vitin 2050.

Menaxhimi i riskut nga rreziqet teknologjike në Shqipëri ndër të tjera do të kërkojë:

- Përpjekje të vazhdueshme në vlerësimin e riskut dhe hartografimin e riskut të objekteve kritike që përmbajnë materiale të rrezikshme;
- Identifikimin e infrastrukturës kritike dhe mbrojtjen e saj;
- Zbatim të masave të kontrollit brenda objekteve që kanë të bëjnë me materiale dhe procese të rrezikshme;
- Ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të përfshira dhe organeve rregullatore për monitorimin dhe zbatimin e standardeve më të fundit lidhur me sigurinë në punë.
- Pajtueshmëri me konventat ndërkombëtare për transportin e substancave të rrezikshme (tokë, ajër, ujë);
- Pajtueshmëri me legjislacionin e BE-së për aksidentet detare që shkaktojnë ndotje detare;
- Pajtueshmëri me Direktivën SEVESO III të BE-së për parandalimin e aksidenteve industriale.

Duke pasur parasysh karakterin e parashikueshëm të rreziqeve teknologjike dhe lidhjen e tyre me proceset shumë të rregulluara në sektorin e industrisë, mundësia për të parashikuar shfaqjen dhe rezultatet e tyre duhet të jetë relativisht e drejtpërdrejtë. Kjo gjithashtu mund të mbështetet me një EWS të organizuar mirë që mund të parashikojë që këto ngjarje të ndodhin dhe të lëshojë paralajmërime në kohë për autoritetet dhe popullatën. Një EWS e një natyre të tillë duhet të integrohet me aktivitetet e gatishmërisë së reaguesve të parë. Zjarrfikësit, policia dhe shërbimi i ambulancës në Shqipëri duhet të njohin natyrën e materialeve të rrezikshme që ndodhen në Shqipëri dhe të kenë përgatitur protokolle se si të reagojnë kur janë në kontakt me ta.

## 3.6. Sëmundjet Infektive

Sëmundjet infektive lidhen me mikroorganizmat që shkaktojnë ose lidhen me sëmundjet tek njerëzit, kafshët dhe bimët. Ato përfshijnë mikroorganizma patogjene, toksina dhe substanca bioaktive që ndodhin natyrshëm ose lëshohen qëllimisht ose pa dashje duke shkaktuar humbje të konsiderueshme të jetës, duke prekur njerëzit dhe të gjithë faunën dhe florën dhe mund të çojnë në humbje të rënda ekonomike dhe mjedisore. Sëmundjet infektive kuptohen si ato që ndodhin në mënyrë të pavarur (ose pjesërisht në mënyrë të pavarur) ose si pasojë e ngjarjeve të tjera të fatkeqësive. Shumë rreziqe të tjera si përmbytjet, tërmetet, thatësirat mund të kenë pasoja potencialisht të rënda epidemiologjike si efekte dytësore.

Përveç kësaj, tendencat e ndryshimeve klimatike mund të ndikojnë gjithashtu në rreziqet infektive, pasi disa sëmundje të transmetuara nga vektorët mund të ndikohen nga temperaturat më të larta dhe ndryshimi i modeleve të reshjeve. Në këtë kuptim, supozohet përhapja e shtuar e makro parazitëve, e cila më pas shoqërohet me shfaqjen dhe qarkullimin e sëmundjeve të reja si pjesë e modeleve të reja të transmetimit.

Nga ana tjetër, ekziston edhe kërcënimi i terrorizmit biologjik, i cili kërkon gatishmëri për identifikimin efektiv laboratorik të patogjenëve të terrorit dhe ekzistencën e protokolleve të komunikimit të shpejtë për publikun.

Cenueshmëria ndaj rreziqeve biologjike lidhet me shumë faktorë të përfshirë në sistemet tona socio-politike, si mungesa e imunitetit midis njerëzve, bimëve dhe kafshëve ndaj një mikroorganizmi të ri dhe virulent; praktikat e ujit dhe kanalizimeve midis njerëzve; aftësia ripërtëritëse e sistemit të shëndetit publik; urbanizimi i paplanifikuar etj. Komunikimet e

ngarkuara dhe lidhja mes njerëzve janë gjithashtu një faktor që lehtëson transmetimin e shpejtë.

COVID-19 tregoi se një organizëm i ri virulent mund të futet në komunitetet tona dhe të bëjë dëme të rënda falë një popullate jo imune, rrjeteve të ngarkuara të komunikimit. Rrjetet e ngarkuara të komunikimit dhe një botë e globalizuar janë vetëm disa nga faktorët që kontribuojnë në transmetimin e shpejtë të virusit të ri. Në këtë kuptim, COVID-19 është shembulli i përsosur i natyrës sistematike të rreziqeve bashkëkohore me të cilat po përballemi brenda shoqërive tona dhe Shqipëria nuk bën përjashtim. COVID-19 preku jo vetëm sistemet shëndetësore, por zinxhirët e furnizimit dhe sektorin e transportit, aksesin në arsim, shpërndarjen e ushqimit etj.

Kriza pandemike COVID-19, ekspozoi dobësitë e ngulitura në të gjitha sistemet e shëndetit publik në të gjithë botën. Shqipëria, duke mos u përjashtuar nga ai mësim global, duhet t'i japë përparësi riskut të pandemisë në të ardhmen dhe shëndetit publik në përgjithësi, duke krijuar strategji të qëndrueshme për ndërtimin e kapaciteteve të strukturave të saj për të parashikuar, parandaluar dhe përgjigjur pandemive në të ardhmen.  Shumë herët në fazën e përgjigjes, sistemi i shëndetit publik në Shqipëri dhe në mbarë botën mësoi rëndësinë e zbulimit të hershëm, gjurmimit të kontakteve dhe komunikimit me publikun. Të gjitha këto janë komponentë të EWS dhe ato duhet të mbështeten me përpjekjet e vazhdueshme të të gjithë aktorëve kombëtarë në Shqipëri. Sipas OBSH-së[14], në Shqipëri nga 3 janari 2020 deri më 1 korrik 2022, ka pasur 280 298 raste të konfirmuara me 3499 vdekje dhe numër total prej 2 906 126 doza vaksinash të administruara.

Në një nivel më operacional, trajtimi i rreziqeve infektive në afat të shkurtër, Shqipëria mund të përfitojë nga:

- Përmirësimi i rrjetit laboratorik dhe forcimi i kapaciteteve laboratorike (teknike dhe personale) për zbulime dhe analiza të hershme.
- Përmirësimi i legjislacionit, krijimi i kompetencave të qarta dhe plotësimi i tyre me aktet e nevojshme nënligjore.
- Rritja e besueshmërisë së sistemeve të gjurmimit së ushqimit përmes ndërgjegjësimit të organizatave prodhuese të ushqimit.
- Forcimi i bashkëpunimit me ISHP-në në kuadër të menaxhimit të epidemisë.
- Ngritja e kapaciteteve të Qendrës Operacionale të Emergjencave të Shëndetit Publik.
- Vendosja e një Certifikate Kombëtare të Trajnimit për Biosigurinë dhe Biosigurimin

# 4. Vizioni, Treguesit dhe Objektivat Strategjikë

## 4.1. Vizioni

Një Shqipëri më e sigurt, e qëndrueshme, e aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive natyrore dhe efektet e ndryshimeve klimatike, për të përgatitur, përballuar dhe për tu rimëkëmbur, integruar në të gjithë sektorët me kapacitete të zhvilluara për të siguruar parandalimin e risqeve të reja dhe menaxhimin e riskut të mbetur, që të gjitha së bashku të ndihmojnë në forcimin e aftësisë ripërtëritëse dhe si rezultat në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë.

[14] https://covid19.who.int/region/euro/country/al

## 4.2. Misioni

Për të bërë përpjekje të koordinuara, të sigurohet bashkëpunimi dhe përdorimi i kapaciteteve dhe aftësive, teknologjive, burimeve ekzistuese dhe të reja të të gjithë sektorëve dhe palëve të interesit, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit.

Për të forcuar aftësinë ripërtëritëse në nivel kombëtar përmes ngritjes të strukturave institucionale të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse të sistemit të Mbrojtjes Civile për të rritur gatishmërinë dhe partneritetin për përgjigje, rimëkëmbje dhe rindërtim. Të forcohet aftësia ripërtëritëse e komunitetit duke aftësuar, fuqizuar dhe duke mbështetur individët, organizatat dhe komunitetet që të veprojnë për veten dhe të tjerët, për sigurinë dhe mirëqenien e të gjithëve.

## 4.3. Treguesit e ndikimit

Treguesit e ndikimit, të miratuar nga Kuadri Sendai dhe OZHQ-të janë:

Tabela 2. Treguesit e ndikimit

| Treguesi | Njësia matëse | Baza | | Synimi | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | viti | vlera | viti | vlera |
| Zvogëlim i ndjeshëm i numrit të të prekurve, duke synuar uljen e shifrës mesatare për 100,000 | Numër për 100,000 | 2018 | 163.15 | 2030 | Ulja e vlerës bazë me 10% |
| Zvogëlimi i humbjeve të drejtpërdrejta ekonomike nga fatkeqësitë e shkaktuara nga fatkeqësitë | Humbja/PBB | 2018 | 0,36 | 2030 | Ulja e vlerës bazë me 5% |

## 4.4. Objektiva Strategjike

1. Të menaxhohen risqet ekzistuese dhe parandalohen risqet e reja.
2. Të rritet ndërgjegjësimi, njohuritë kombëtare dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacionit për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe të krijohen komunitete ripërtëritëse dhe të qëndrueshme me vëmendje tek njerëzit me aftësi të kufizuara, barazi gjinore dhe grupet e tjera të cenueshme.
3. Të përmirësohen kapacitetet e përgjigjes përmes ndërtimit të infrastrukturave ripërtëritëse, nxitjes së industrializimit gjithëpërfshirës dhe nxitjes së inovacionit.

4. Të nxitet koherenca e politikave dhe kuadri rregullator që lidhet me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.
5. Forcimi i aftësive të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë me qëllim anëtarësim në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së ( MMC BE) në një periudhë të shkurtër kohore, rrjedhimisht duke u shndërruar në një faktor shtesë sigurie për rajonin dhe BE-në[15].

# 5. Strategjia e zbatimit dhe Korniza Financiare

Zbatimi i Strategjisë është planifikuar përmes fushave të përcaktuara kyçe të ndërhyrjes, të vlerësuara si më të rëndësishme për investimet e ardhshme të MRF-së. Secila prej fushave ka një listë të aktiviteteve të identifikuara në mënyrë që të arrihen të gjitha objektivat e përcaktuara të politikave në mënyrën më efektive. Plani financiar tregues do të jetë pjesë e secilit prej planeve të veprimit të hartuara për të ndihmuar në zbatimin e Strategjisë.

Për zbatimin e Strategjisë u zhvillua një sistem monitorimi dhe u hartua një strategji komunikimi për të siguruar transparencën dhe shpërndarjen e informacionit si për publikun ashtu edhe për aktorët përkatës të zbatimit.

## 5.1. Fushat e ndërhyrjes

Fushat kryesore të ndërhyrjes janë fushat që, siç analizohen nga Grupi Ndërsektorial i Punës, janë të rëndësisë dhe urgjencës më të madhe për të menaxhuar riskun e nivelit më të lartë në Shqipëri.

Secila prej fushave kyçe të ndërhyrjes përfshin një numër aktivitetesh të planifikuara që do të renditen, për çdo rrezik, në Planin e Veprimit që korrespondojnë me periudhën përkatëse kohore.

Korniza e përmbledhur, e përafërt financiare për Strategjinë do të jetë përmbledhja e secilit prej kornizave financiare të Planit të Veprimit përkatësisht.

### 5.1.1. Fusha 1: Të menaxhojë risqet ekzistuese dhe parandalojë risqet e reja.

Fusha 1 do të përfshijë aktivitete që kontribuojnë në: kërkimin, inovacionin dhe ndërtimin e parandalimit, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit, njohurive dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit në shërbim të zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile, dhe promovimin e koherencës së politikave dhe kuadrit rregullator në lidhje me zvogëlimin e riskut të fatkeqësive.

### 5.1.2. Fusha 2: Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes

Fusha 2 do të përfshijë aktivitete për të forcuar kapacitetet e përgjigjes përmes ndërtimit të infrastrukturave ripërtëritëse, duke promovuar industrializimin gjithëpërfshirës dhe inovacionin, si dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive me synimin forcimin e rolit të Shqipërisë në kuadër

[15] Vizioni, misioni dhe objektivat e strategjisë Kombëtare të ZRF u hartuan gjatë kohës që Shqipëria ishte në fazën e negociatave me Komisionin Evropian për nënshkrimin e "Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian, njëra palë dhe Republikës së Shqipërisë, pala tjetër, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit" dhe u miratuam nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC). Në këto kushte, edhe pse objektivi nr. 5, kishte nevojë të përditësohej në kushtet e reja të krijuara pas nënshkrimit të marrëveshjes së sipërcituar në datën 18.11.2022, kjo nuk u bë e mundur për shkak të kohës së pamjaftueshme në dispozicion.

të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së në të cilin ajo do të anëtarësohet zyrtarisht në 1.01.2023.

## 5.2. Komunikimi

AKMC si koordinatore e procesit dhe Qeveria e Shqipërisë si zotëruese dhe miratuese e Strategjisë siguron që të gjitha proceset dhe detyrimet kombëtare në lidhje me konsultimet me institucionet e tjera kombëtare dhe qeverisjen vendore, si dhe me publikun të konsultohen gjatë procesit të përshtatjes. Të gjitha palët e interesit janë njohur me draftin e Strategjisë përpara miratimit të saj.

Pas miratimit të Strategjisë, është e një rëndësie të madhe komunikimi i objektivave dhe qëllimit të saj tek institucionet kombëtare dhe publiku me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi për agjendën në fjalë. Komunikimi është gjithashtu vendimtar në zhvillimin e një baze solide zbatimi dhe pronësie në të gjitha institucionet zbatuese, duke rritur kështu shkallën e zbatimit.

**Qëllimet kryesore të komunikimit janë:**

1. Ngritja e vetëdijes për **Strategjinë dhe rëndësinë e saj** në mesin e të gjitha palëve të interesit - njohja e Strategjisë dhe përmbajtjes së saj është parakusht për veprim pozitiv të të gjitha palëve të interesit, institucioneve qeveritare dhe institucioneve shkencore dhe eksperte me role në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive.
2. Rritja e ndërgjegjësimit për **rëndësinë e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik** dhe për zvogëlimin e cenueshmërisë për shoqëritë – në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia, palët e interesit dhe publiku duhet të dinë rëndësinë e përpjekjeve të tyre.
3. Shpërndarja e **njohurive për riskun** dhe **ndërgjegjësimi për mënyrat për të zvogëluar riskun** – është e rëndësishme që të informohen dhe edukohen palët e interesit dhe publiku për riskun e fatkeqësive, por edhe për rolin e tyre në sistemin e ZRF dhe si të veprohet në mënyrë që të zvogëlohet në mënyrë efektive risku i fatkeqësive.

**Grupet e synuara të komunikimit:**

1. Publiku - popullata më e gjerë të cilës duam t'ia afrojmë temën e zvogëlimit të riskut sa më pranë duke ofruar informacione dhe udhëzime të qarta sesi zgjedhjet e tyre ditore mund të rrisin ose zvogëlojnë riskun e fatkeqësive, veçanërisht duke synuar ata që janë më të prekur nga fatkeqësitë dhe më të margjinalizuar në shoqëri., e cila thekson rëndësinë e gjinisë dhe cenueshmërisë
2. Institucionet qeveritare të përfshira në zbatimin e Strategjisë – sektorët kanë identifikuar aktivitetet kyçe për të zvogëluar riskun nga fatkeqësitë në Shqipëri. Është e rëndësishme që ata të njohin se cilat nga aktivitetet e tyre të rregullta janë gjithashtu veprimtari për zvogëlimin e riskut.

   P.sh., risku i klimës dhe i fatkeqësisë nuk është integruar ende si pjesë e planifikimit të buxhetit të qeverisë. Përfshirja e vlerësimit të riskut të klimës dhe të fatkeqësive natyrore në deklaratën e riskut fiskal të qeverisë do të ndihmojë për një kuptim më të mirë të detyrimeve kontigjente të qeverisë për shkak të fatkeqësive.
3. Vendimmarrësit në nivel qendror, qarku dhe bashkie - zvogëlimi i riskut të fatkeqësive është një fushë komplekse që hyn në sferën e të gjitha niveleve të qeverisjes, është e

rëndësishme që të gjitha nivelet të njihen me dokumentin dhe qëllimin e tij si dhe rolin e tyre në sistem.

**Mesazhet kryesore të komunikimit:**

1. Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive është me rëndësi të madhe kombëtare dhe prioritet kombëtar
2. Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive është çështje zgjedhjeje, vetëm zhvillimi që përfshin zvogëlimin e riskut të fatkeqësive është zhvillim i qëndrueshëm
3. Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive është çështje e të gjithëve

## 5.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe partneriteti global

Shqipëria hodhi një hap të rëndësishëm në rrugëtimin e saj në BE pasi në 19.07.2022 u shënua hapja e negociatave për anëtarësimin në BE në konferencën e parë ndërqeveritare mes Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut që u mbajt në  Bruksel.

Në përputhje me objektivin ‘F” të Kuadrit Sendai, lidhur me rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për ZRF, niveli i tij është në rritje dhe përmirësim të vazhdueshëm. AKMC, në zbatim të udhëzimeve teknike për monitorimin dhe raportimin mbi progresin në arritjen e objektivave globalë të Kuadrit Sendai duhet të udhëzojë dhe të bashkërendojë veprimtaritë e institucioneve përkatëse në këtë drejtim.

Bashkëpunimit ndërkombëtar i është dhënë një rëndësi e veçantë në ligjin 45/2019 duke i kushtuar tërësisht kreun VII të tij dhe duke vendosur bazat për një qasje të re proaktive dhe bashkëkohore në këtë fushë. Aktivitetet e bashkëpunimit ndërkombëtar janë mirë përcaktuar duke futur për herë të parë edhe konceptin e mbështetjes së vendit pritës. Ndryshe nga ligji i mëparshëm apo PKEC që më së shumti kishin ndonjë përcaktim për marrjen e asistencës ndërkombëtare, ligji 45/2019 ka vendosur përcaktime të detajuara edhe për dhënien e asistencës ndërkombëtare. Për këtë, ndër të tjera, ligji ka synuar përputhjen me Vendimin e Këshillit nr.1313/2013/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17.12.2013, “Mbi Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian”, i ndryshuar,  duke vendosur përcaktime për asistencën humanitare për vendet e tjera sikurse për modulet dhe kapacitetet e tjera të përgjigjes emergjente.

Rritja dhe forcimi i vazhdueshëm i kapaciteteve për ZRF dhe MC të Shqipërisë, përfshi dhe krijimin sipas mundësive, të moduleve dhe të kapaciteteve të tjera të përgjigjes emergjente, dhënia e asistencës jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë janë masat e duhura për një vend anëtarë të MMC BE.

Shqipëria është pjesëmarrëse aktive në një sërë konventash, traktatesh, protokollesh, marrëveshjesh, iniciativash, komitetesh, programesh rajonale, Evropiane e ndërkombëtare, të lidhura me ZRF dhe MC.

Ndër vite vendi ka pasur marrëdhënie shumë të mira bashkëpunimi të ndërsjellë me një sërë institucionesh dhe organizatash ndërkombëtare. Gjithashtu, ai ka nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare shumëpalëshe dhe dypalëshe në fushën e ZRF dhe MC duke i konsideruar ato si instrumente të rëndësishme politike që i sjellin shtetet dhe organizatat më pranë njëra tjetrës por edhe me vlera praktike të pazëvendësueshme që përfitohen gjatë implementimit të tyre.

Organizatat ku Shqipëria është anëtare sikurse marrëveshjet dhe memorandumet e nënshkruara dhe ato në proces, mund ti gjeni në shtojcën nr. 4 të strategjisë.

Në të kaluarën bashkëpunimi ndërkombëtar ka konsistuar më së shumti në marrjen e asistencës humanitare në rastet e fatkeqësive. Kështu Qeveria shqiptare ka shpallur gjendjen e fatkeqësisë natyrore në vitet 2007, 2010, 2011, 2012, 2019 dhe 2020. Ajo ka kërkuar aktivizimin e MMC BE në 2007, 2010, 2011, 2012, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Në emergjencat e mëdha të së kaluarës të cilat i kalonin aftësitë përballuese të vendit, Shqipëria i është drejtuar për asistencë si ERCC-së ashtu edhe Qendrës Euro Atlantike të Koordinimit të Përgjigjes Emergjente (Euro-Atlantic Disaster Response Coordination Centre /EADRCC)

Përveç bashkëpunimit ndërkombëtar në fazën e përgjigjes ndaj emergjencave, bashkëpunimi ndërkombëtar ka konsistuar më së shumti në:

a) Trajnimet e ekspertëve shqiptarë në kuadrin e programit të Trajnimit të Menaxhimit të Fatkeqësive të DPPI SEE, të Programit të Trajnimit të MMC BE dhe trajnimeve të tjera;
b) Pjesëmarrjet në trajnime e stërvitje të tjera të financuara nga BE, NATO etj.;
c) Vizitat studimore në ambientet e Qendrës së Koordinimit të Përgjigjes Emergjente dhe institucione të tjera homologe në Evropë dhe në botë;
d) Përvoja të tjera që lidhen me zbatimin e programeve dhe projekteve të financuara nga donatorë dhe partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë.

Objektivi i përgjithshëm i MMC BE është forcimi i bashkëpunimit ndërmjet shteteve pjesëmarrëse në fushën e mbrojtjes civile, me qëllim përmirësimin e parandalimit, përgatitjes dhe përgjigjes ndaj fatkeqësive. Përmes Mekanizmit, Komisioni Evropian luan një rol kyç në koordinimin e përgjigjes ndaj fatkeqësive në Evropë dhe më gjerë. Kur shkalla e një emergjence tejkalon aftësitë e përgjigjes së një vendi, vendi mund të kërkojë ndihmë nëpërmjet Mekanizmit, i cili, pasi aktivizohet, koordinon ndihmën e vënë në dispozicion nga shtetet pjesëmarrëse të tij. Aktualisht i vetmi shtet që nuk është anëtarësuar ende në Mekanizëm është Kosova.

Dokumenti i parë që evidentoi nevojën e anëtarësimit të Shqipërisë në MMC BE ishte PDNA 2015 i pasuar nga PDNA 2020 si edhe Progres Raportet e Komisionit Evropian 2019, 2020 dhe 2021. Në këto të fundit në mënyrë konstante rekomandohet përshpejtimi i përgatitjes për t'iu bashkuar MMC BE dhe vendosjen e lidhjes TESTA për ndërlidhjen me CECIS. Për mbështetjen e anëtarësimit të Shqipërisë në Mekanizëm, BE financoi Programin PRO NEWS (2017-2021). Rëndësia e PRO NEWS ishte strategjike për shkak se aplikimi i Shqipërisë për pjesëmarrje në Mekanizëm do të mund të fillonte atëherë kur zbatimi i programit të kishte avancuar thelbësisht. Pas nënshkrimit në datën 18.11.2022 në Tiranë, të "Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian, njëra palë dhe Republikës së Shqipërisë, pala tjetër, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit", duke filluar nga 1.01.2023, Shqipëria do të jetë anëtare me të drejta të plota në MMC BE.

Një listë të organizatave dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë me të cilët Shqipëria ka marrëdhënie të ngushta partneriteti në fushën e ZRF dhe MC gjendet në shtojcën nr.4 të strategjisë.

Në lidhje me bashkëpunime dhe marrëveshje të tjera të rëndësishme për MRF, nevojitet forcimi e lidhjeve operacionale të autoritetit meteorologjik dhe hidrologjik dhe AKMC-së me organizatat Evropiane të infrastrukturës meteorologjike si Qendra Evropiane e Parashikimin Afatmesëm të Motit (European Center for Medium-Range Weather Forecasts /ECMWF) dhe Agjencia Evropiane për Shfrytëzimin e Sateliteve Meteorologjike (European Agency for

Exploitation of Meteorological Satellites/EUMETSAT)[16]. Anëtarësimi në Global Health Security Agenda u evidentua gjithashtu si një nevojë gjatë hartimit të dokumentit të strategjisë. Bashkëpunimi me UNDRR përfshin angazhimin për zbatimin e politikave të MRF në përputhje me parimet dhe praktikat e Kuadrit Sendai. Për rastet e emergjencave, në lidhje me UNOCHA-n, kjo e fundit përfaqësohet nga zyra e Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së në Shqipëri. Vendet e Evropës Juglindore (EJL) shtrihen në një zonë të vogël gjeografike dhe rrjedhimisht, ndonëse ka dallime të dukshme në mjediset fizike dhe kulturat shoqërore midis vendeve të veçanta, në përgjithësi ndajnë të njëjtat risqe fatkeqësish. Shumë fatkeqësi janë ndërkufitare në efektet e tyre, si p.sh. moti i nxehtë dhe i thatë, thatësirat, ose përmbytje të disa sistemeve lumore, ndaj prej një qasjeje rajonale në lidhje me ZRF ka vend për përfitim për të gjithë.

*Vënia në përdorim të plotë e strukturave dhe shërbimeve ekzistuese*: Do të duhet që në radhë të parë të shfrytëzohen burimet aktuale të të dhënave, informacionit, dijeve, strukturave dhe proceseve për MRF dhe MC. Investimet për përmirësimin e sistemit të MRF brenda për brenda vendeve të EJL do të çojnë në rritje të aftësisë ripërtëritëse ndaj riskut të fatkeqësive për secilin vend më vete dhe gjithashtu mes të gjitha vendeve të EJL për të garantuar një menaxhim më të fuqishëm të riskut rajonal nga fatkeqësitë. Gjithashtu përpjekjet për rritjen e komunikimit dhe bashkëpunimit rajonal midis autoriteteve të MRF, sektorëve të MC dhe aktorëve të tjerë, duke përfshirë organet kërkimore dhe shkencore, sektorin privat, organizatat rajonale dhe organizatat ndërkombëtare të zhvillimit që punojnë në rajon, jo vetëm që do të sjellin një përmirësim të kapaciteteve në rang kombëtar dhe rajonal, por edhe do të zvogëlojnë mbivendosjen e aktiviteteve dhe do të ndihmojnë në procesin e kontrollit.

*Natyra ndërkufitare e rreziqeve*: Duke pasur parasysh natyrën ndërkufitare të rreziqeve dominuese në rajon, Shqipëria dhe vendet e tjera të rajonit kanë një nevojën të qartë për ruajtjen dhe forcimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit rajonal, në veçanti në fushat kryesore të azhurnimit të sistemeve të monitorimit ndërkufitar dhe ato të sistemit të paralajmërimit të hershëm. Një shembull shumë i mirë i bashkëpunimit ndërkufitar rajonal është ai i menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe menaxhimit të risqeve të përmbytjeve në lidhje me ndryshimet klimatike në basenin ndërkufitar të lumit Drin. Ka disa projekte në vazhdë brenda rajonit për krijimin e rrjeteve të monitorimit të motit dhe kushteve hidrologjike të cilat plotësojnë standardet e OBM-së, si edhe një rrjet stacionesh hidrometeorologjike që do të bënin të mundur përputhshmërinë me Direktivën Kuadër të BE-së për Ujin dhe Direktivën e BE-së për Përmbytjet.

Një fushë tjetër ndërkufitare ku ka nevojë për rritjen e bashkëpunimit rajonal është monitorimi dhe përballja me zjarret në pyje dhe ky njihet si një prioritet rajonal. Shqipëria nuk disponon ende një rrjet permanent vrojtimi dhe sinjalizimi për pyjet që janë në rrezik, sistemi i të cilit të vihet në punë nga shërbimi pyjor gjatë sezonit të zjarreve. Njëkohësisht, ka vend për përmirësim përsa i takon disponueshmërisë së infrastrukturës dhe pajisjeve për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, sidomos në dritën e modeleve të paparashikuara në kuadrin e ndryshimeve klimatike. Ekziston një nevojë e përgjithshme në rajon për asistencë teknike për ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe për punë kërkimore në lidhje me zjarret në pyje.

*Shkëmbim informacioni dhe dijesh*: Shqipëria dhe rajoni i EJL-së janë të vetëdijshme që aksesi i ditëve të sotme në lidhje me teknologjinë e komunikimit të informacionit, shkëmbimin e të dhënave, informacionit dhe të dijeve është një nga format më pak të kushtueshme, por gjithsesi më efikase të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

---

[16] Programi për Përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe Parandalimin e Përmbytjes në Shqipëri (PRO NEWS)

*Mekanizma rajonalë dhe ndërkombëtarë rregullatorë*: Shumë organizata rajonale dhe ndërkombëtare të MRF dhe MC kanë hartuar shumë mekanizma rregullatorë që përfshijnë standarde, kode etike dhe kode praktikash, kode ndërtimi, rregullore për përdorimin e tokës, rregullore për infrastrukturën etj. Duke qenë se këto ekzistojnë, vendet e EJL e kanë kuptuar që ky është një aktivitet relativisht i lirë, për të eksploruar mekanizmat përkatës rregullatorë, sipas nevojës dhe pastaj për të vlerësuar dhe nëse ia vlen për t'i përshtatur sipas nevojave kombëtare dhe sipas specifikave dhe prioriteteve rajonale. Njëkohësisht, përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike po krijon një nevojë të re për mekanizma të rinj apo të rishikuar rregullatorë.

*Ndarja e zhvillimit të kapaciteteve*: Trajnimi për ZRF ka nevojë për fuqizim të vazhdueshëm. Një sërë veprimtarish trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve, janë përqendruar në elementë të ndryshëm të përgjigjes ndaj emergjencave. Janë bërë shumë përpjekje edhe në kuadrin e trajnimeve rajonale për gatishmërinë në raste emergjencash. Ndarja në të ardhmen e përpjekjeve për trajnim dhe zhvillimin e kapaciteteve, në nivel rajonal dhe ndërkombëtar gjithashtu kërkon forcimin e rrjetëzimit, shkëmbimit të dijeve dhe bashkëpunimit në përgjithësi.

*Sfidat kryesore*: Sfidat në lidhje me bashkëpunimin rajonal përfshijnë burime financiare përgjithësisht të pamjaftueshme në nivel kombëtar dhe rajonal. Një sfidë tjetër në lidhje me bashkëpunimin gjatë momenteve të përgjigjes ndaj fatkeqësive është që shpesh fatkeqësia bie mbi të gjithë rajonin dhe çdo organizate kombëtare është e zënë "deri në fyt" me nevojat e veta.

Konteksti i ndryshimeve klimatike është një argument më tepër për përshkallëzimin e bashkëpunimit rajonal në lidhje me aspekte të ndryshme të përshtatjes klimatike. Nga pikëpamja pragmatike është e nevojshme të shtohen përpjekjet për të arritur njohje në nivele të larta të qeverisjes sa i takon rëndësisë shoqërore dhe ekonomike të investimeve në përpjekjet rajonale të MRF. Duhet mbajtur parasysh gjithashtu që bashkëpunimi rajonal është i nevojshëm gjatë përpjekjeve për financime nga institucionet rajonale dhe ndërkombëtare të zhvillimit dhe ato financiare.

## 5.4. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi




***Figura 2: Procesi i monitorimit të zbatimit të strategjisë***

### 5.4.1. Monitorimi dhe raportimi i progresit

Për të arritur shkallën optimale të zbatimit, procesi i zbatimit duhet të monitorohet rregullisht dhe të raportohet në mënyrë transparente.

Siç thuhet në Kuadrin Sendai, një zvogëlim thelbësor i riskut të fatkeqësive kërkon këmbëngulje dhe kokëfortësi, me një fokus më të qartë te njerëzit, shëndetin dhe jetesën e tyre, si dhe ndjekje të rregullt në vijimësi.[17]

Aktivitetet e kësaj Strategjie u zgjodhën duke përdorur udhëzimet SMART (**S**pecifike, të **M**atshme, të **A**rritshme, **R**ealiste dhe në **K**ohë).

Secili prej Grupeve të Punës së Rrezikut ka identifikuar boshllëqet dhe nevojat më të rëndësishme për të siguruar zvogëlimin efikas të riskut të fatkeqësive të shkaktuar nga rreziku i secilit prej grupeve përkatëse. Kjo u bë për të siguruar që produkti përfundimtar të jetë **realist** dhe i **arritshëm**.

Secila prej fushave kyçe të ndërhyrjes ka një sërë aktivitetesh të identifikuara që kontribuojnë në këtë fushë. Secili prej rreziqeve ka një listë të treguesve të rezultateve që do të ndihmojnë në monitorimin e progresit të zvogëlimit të riskut specifik. Kjo është për ta bërë strategjinë të **matshme**.

Për secilin nga boshllëqet, të përcaktuara në seksionin 3. “Gjendja aktuale dhe tendencat: Sfidat”, propozohen një ose më shumë aktivitete, ose projekte. Secili nga aktivitetet e propozuara ka një afat kohor të identifikuar, institucionin e zbatimit, buxhetin e përafërt dhe burimin e buxhetit. Informacioni i detajuar mbi projektet dhe aktivitetet e tyre kryesore të zbatuara në kuadër të një Plani Veprimi specifik janë të listuara në Planin përkatës të Veprimit. Kjo është për ta bërë strategjinë **specifike** dhe në **kohë**.

Progresi i arritur nga secili prej palëve përkatëse të interesit do të monitorohet nga **AKMC**-ja dhe **Grupi i Punës për Monitorimin e Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive (GPMSZRF)** mbi baza vjetore. Meqë Shqipëria nuk ka një Platformë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut të fatkeqësive (PKZRF), një tjetër bazë të një sistemi funksional multisektorial të MRF, grupi i punës i lartpërmendur do të duhej të ngrihej nëpërmjet Qeverisë Shqiptare në kuadër të një koordinimi mes Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe Komisionit Teknik Këshillimor. Prandaj, ky proces do të siguronte gjithashtu që të gjitha pjesët e sistemit të MRF të përfshihen vazhdimisht në zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë, si dhe në propozimin e amendamenteve të Strategjisë.

Informacioni mbi aktivitetet e realizuara dhe përqindjen e zbatimit si dhe hapat e mëtejshëm do t'i raportohet në mënyrë transparente Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Së bashku me raportin e progresit do të raportohet një vlerësim i rrezikut të zbatimit me zgjidhjet e propozuara.

### 5.4.2. Vlerësimi

Bazuar në raportimin e progresit çdo dy vjet, duke filluar nga viti 2024. Një vlerësim i zbatimit të Strategjisë do të bëhet nga një institucion i jashtëm i paanshëm me kërkesë të koordinatorit, AKMC-së.

[17] Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive 2015-2030

### 5.4.3. Përditësimi dhe përshtatja

Nëse vendoset kështu dhe evidentohet në ndonjë nga Raportet e Progresit dhe bazuar në përfundimet e vlerësimit, do t'i bëhet propozim ministrit përgjegjës për të përshtatur Strategjinë.

Në vijim të këtij propozimi dhe sipas nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 45/2019, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë do të rishikohet, të paktën çdo pesë vjet, nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes.

# 6. Elementet ndërsektoriale të Strategjisë së ZRF-së

Koncepti i Strategjisë Kombëtare të ZRF-së bazohet në filozofinë kryesore të ZRF-së dhe që është zvogëlimi i riskut të identifikuar, parandalimi i risqeve të rejave dhe menaxhimi i riskut të mbetur. Për ta bërë këtë, siç thuhet shumë herë në tekstin e Strategjisë, ZRF nuk mund të jetë thjesht një përgjegjësi e agjencisë përgjegjëse për mbrojtjen civile në Qeverinë Shqiptare, por e gjithë shoqërisë. Për të ndërtuar atë ndjenjë llogaridhënieje dhe pronësie, procesi i hartimit të Strategjisë u përshtat me kujdes për të lejuar gjithashtu identifikimin e elementeve ndërsektoriale që duhet të merren parasysh kur Shqipëria trajton ZRF. Lista e mëposhtme nuk është shteruese kur bëhet fjalë për fushat ndersektoriale të ZRF, megjithatë ajo përmban ato që përdoren më shpesh, duke hedhur dritë në lidhjet horizontale me sektorët e tjerë. Të gjithë elementët e listuar më poshtë, dhe të rinjtë që do të dalin nga zbatimi i Strategjisë, duhet të merren parasysh kur projektet e ZRF-së të hartohen dhe zbatohen.

## 6.1. Lidhja me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive 2015 – 2030 u miratua në Konferencën e tretë Botërore të OKB-së për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive në 2015 nga anëtarët e Kombeve të Bashkuara. Nëpërmjet Kuadrit Sendai, vendet në mbarë botën njohin rëndësinë jo vetëm të menaxhimit të fatkeqësive, por menaxhimit të riskut të fatkeqësive.

Kuadri Sendai përshkruan shtatë objektiva dhe katër prioritete për veprim për të parandaluar dhe zvogëluar riskun ekzistues të fatkeqësive. Shtatë objektivat globale janë: (a) të zvogëlojë ndjeshëm vdekshmërinë globale nga fatkeqësitë deri në vitin 2030, duke synuar uljen e mesatares për 100,000 në shkallë globale të vdekshmërisë në dekadën 2020-2030 krahasuar me periudhën 2005-2015; (b) të zvogëlojë ndjeshëm numrin e njerëzve të prekur globalisht deri në vitin 2030, duke synuar uljen e shifrës mesatare globale për 100,000 në dekadën 2020–2030 krahasuar me periudhën 2005–2015; (c) të zvogëlojë humbjet e drejtpërdrejta ekonomike nga fatkeqësitë në lidhje me produktin e brendshëm bruto global (GDP) deri në vitin 2030; (d) të zvogëlojë ndjeshëm dëmtimin nga fatkeqësitë në infrastrukturën kritike dhe ndërprerjen e shërbimeve bazë, mes tyre objekteve shëndetësore dhe arsimore, duke përfshirë zhvillimin e aftësisë ripërtëritëse të tyre deri në vitin 2030; (e) Të rrisë thelbësisht numrin e vendeve me strategji kombëtare dhe lokale për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive deri në vitin 2020; (f) të rrisë ndjeshëm bashkëpunimin ndërkombëtar me vendet në zhvillim përmes mbështetjes adekuate dhe të qëndrueshme për të plotësuar veprimet e tyre kombëtare për zbatimin e këtij Kuadri deri në vitin 2030; dhe (g) Të rrisë thelbësisht disponueshmërinë dhe qasjen ndaj sistemeve të paralajmërimit të hershëm me shumë rreziqe dhe informacioneve dhe vlerësimeve të riskut të fatkeqësive për njerëzit deri në vitin 2030. Katër prioritetet globale të Kuadrit Sendai janë: të kuptuarit e riskut të fatkeqësive; forcimi i qeverisjes së riskut të fatkeqësive për të menaxhuar riskun e fatkeqësive; investimi në Zvogëlimin e Riskut të

Fatkeqësive për aftësinë ripërtëritëse; dhe rritja e gatishmërisë ndaj fatkeqësive për përgjigje efektive, dhe për të "Ndërtuar më mirë" në rimëkëmbje, rehabilitim dhe rindërtim.[18]

Kuadri Sendai përcaktoi rastin që zhvillimi të jetë i informuar për riskun në mënyrë që të jetë i qëndrueshëm. Nuk ka zhvillim të qëndrueshëm pa zvogëlimin e riskut të fatkeqësive. Si rezultatet e Kuadrit Sendai ashtu edhe të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) janë produkt i proceseve të ndërlidhura sociale dhe ekonomike. Ka shumë sinergji midis dy instrumenteve të politikave. Monitorimi i Kuadrit Sendai synon të plotësojë monitorimin e 11 treguesve të OZHQ. [19]

## 6.2. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe ZRF

Zbatimi i KSZRF dhe në këtë kontekst SKZRF është e lidhur ngushtë me të gjitha OZHQ-të, por veçanërisht:

OZHQ 1. Jo varfëri (1.5 Deri në vitin 2030, të ndërtohet aftësia ripërtëritëse e të varfërve dhe atyre në situata të cenueshme dhe të zvogëlohet ekspozimi dhe cenueshmëria e tyre ndaj ngjarjeve ekstreme të lidhura me klimën dhe fatkeqësive dhe tronditjeve të tjera ekonomike, sociale dhe mjedisore);

OZHQ 3. Shëndeti dhe mirëqenia (3.9 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndjeshëm numri i vdekjeve dhe sëmundjeve nga kimikatet e rrezikshme, ndotja dhe kontaminimi i ajrit, ujit dhe tokës);

OZHQ 5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave (5.c Miratimi dhe forcimi i politikave të shëndosha dhe legjislacionit të detyrueshëm për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave në të gjitha nivelet)

OZHQ 6. Uji i pastër dhe kanalizimet (6.3 Deri në vitin 2030, përmirësimi i cilësisë së ujit duke zvogëluar ndotjen, minimizuar çlirimin e kimikateve dhe materialeve të rrezikshme, duke përgjysmuar përqindjen e ujërave të zeza të patrajtuara dhe duke rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt);

OZHQ 9. Ndërtimi i infrastrukturës ripërtëritëse, promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe nxitja e inovacionit (9.1 Zhvillimi i infrastrukturës cilësore, të besueshme, të qëndrueshme dhe ripërtëritëse, duke përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien, me fokus në qasje të përballueshme dhe akses të barabartë për të gjithë);

OZHQ 11. Qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme (11.5 Deri në vitin 2030, zvogëlim i ndjeshëm në numrin e vdekjeve dhe numrin e njerëzve të prekur si dhe të ulen ndjeshëm humbjet e drejtpërdrejta ekonomike në raport me produktin e brendshëm bruto të shkaktuar nga fatkeqësitë, duke përfshirë fatkeqësitë e lidhura me ujin, me një fokusim në mbrojtjen e të varfërve dhe njerëzve, në situata të cenueshme);

OZHQ 13. Ndryshimet klimatike (13.1 Forcimi i aftësisë ripërtëritëse dhe kapacitetit përshtatës ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe fatkeqësive natyrore në të gjitha vendet).

Në këtë kontekst, të gjitha projektet dhe të gjitha aktivitetet si pjesë e kësaj SKZRF duhet të marrin në konsideratë OZHQ-të e shënuara dhe më pas, pasi të zbatohen, të kontribuojnë në arritjen e këtyre qëllimeve të veçanta.

[18] Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive 2015-2030
[19] www.undrr.org

## 6.3. Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe ZRF[20], ndryshueshmëria dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike

Nevoja për koherencë midis Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike (PNK) dhe ZRF është identifikuar nga OZHQ-të në nivel global dhe nga BE-ja në nivel rajonal. Gjetjet dhe raportet ekzistuese të PNK-së që vijnë nga burime të ndryshme që flasin për kushtet e qëndrueshme të temperaturave të larta dhe reshjeve të ulëta, ndryshimin e modeleve dhe shpeshtësinë e situatave që shkaktojnë përmbytje të shpejta dhe rrëshqitje të tokës, ndër të tjera, nuk kontestohen nga sektori i ZRF. Përkundrazi, marrja në konsideratë e skenarëve afatgjatë të klimës po bëhet një kërkesë e vlerësimeve të ardhshme të riskut të fatkeqësive dhe rrjedhimisht e strategjive kombëtare të ZRF. Prandaj, aty ku është e zbatueshme, masat PNK duhet të përfshihen fuqishëm në projektet e zbatuara siç është planifikuar në këtë SKZRF.

Marrëveshja e Parisit dhe Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm (përfshirë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm) theksojnë rëndësinë e përshtatjes klimatike dhe zvogëlimit të riskut të fatkeqësive. UNDRR thekson se nëse duam të zvogëlojmë riskun, ne gjithashtu duhet të bashkohemi në qasjet tona dhe duhet të përfshijmë të gjithë sektorët përkatës, të bashkëpunojmë brenda institucioneve dhe të sigurojmë harmoni nga politika në aktivitet.

Duke e njohur këtë, Shqipëria vendosi të zhvillojë këtë Strategji duke lidhur të gjitha strategjitë përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare në një qëllim të përbashkët – të zvogëlojë humbjet nga fatkeqësitë dhe të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm.

Institucionet shpesh veçohen në axhendën e tyre duke synuar vetëm arritjen e qëllimeve të tyre të veçanta, prandaj është e rëndësishme të pranohet se të gjitha axhendat e lartpërmendura ndërkombëtare si dhe shumë nga ato kombëtare do të arriheshin më shpejt dhe me efikasitet nëse institucionet do të bashkëpunonin. Kufizimi i ndikimit të fatkeqësive tani dhe në të ardhmen kërkon një përpjekje të koordinuar në dhe brenda shumë fushave duke përfshirë planifikimin e përdorimit të tokës, infrastrukturën, menaxhimin e emergjencave, politikat sociale, bujqësinë, arsimin, shëndetin, zhvillimin e komunitetit, energjinë dhe mjedisin.

Siç thuhet në të gjithë kapitullin 3 të kësaj Strategjie, ndryshimi i klimës ndikon negativisht në shumicën e risqeve kyçe të identifikuara në Shqipëri, d.m.th., duke rritur nivelin e riskut. Më poshtë janë gjetjet nga NDC e Rishikuar e Shqipërisë siç janë artikuluar në dokument.

### Temperatura

Tendencat e parashikuara tregojnë se temperatura mesatare vjetore në Shqipëri do të rritet ndërmjet 1,3°C dhe 2,2°C deri në vitin 2050 dhe ndërmjet 1,2°C dhe 4,4°C deri në vitin 2100 nga vlera bazë 1986-2005 prej 11,8°C. Rritjet më të rëndësishme do të ndodhin midis qershorit dhe shtatorit (5.8°C nën RCP 8.5), duke sjellë temperaturën mesatare të verës rreth 27°C deri në vitin 2100.

Si pasojë, numri dhe kohëzgjatja e valëve të të nxehtit pritet të rritet. Temperatura mbi 95 përqindshin e bazës 1986-2005, pritet të rritet ndjeshëm deri në vitin 2050 sipas të gjithë skenarëve, me një mesatare ndërmjet 20 dhe 41 ditë, nga 2.5 ditë

[20] Një fragment nga “Shqipëria. Kontributet e përcaktuara kombëtare e rishikuar (NDC)

### Reshjet

Nivelet mesatare të reshjeve kanë mbetur relativisht të qëndrueshme që nga viti 1901, megjithëse me një tendencë të lehtë në rënie. Deri në vitin 2050, reshjet për Shqipërinë pritet të ulen ndërmjet 2.1% (RCP 2.6) dhe 4.3% (RCP 8.5)

### Ndikimet e ndryshimeve klimatike

Ndryshimet aktuale dhe të parashikuara të klimës do të kenë efekte në kushtet meteorologjike dhe mjedisore në Shqipëri. Ndërsa temperatura mesatare rritet, ulja e reshjeve dhe rritja e nivelit të detit (SLR) do të kenë disa efekte në planin afat gjatë. Këto ndryshime do të rezultojnë gjithashtu në rritje të shpeshtësisë dhe intensitetit të fatkeqësive të lidhura me motin

Tabela 3. Përmbledhje e ndryshimeve klimatike dhe efektet/risqet në 2100 (Burimi: Albania Revised NDC)

| Faktorët | Siperfaqja | Ndryshimi | Kohështrirja (në 2100) | Efektet/Risqet |
|---|---|---|---|---|
| **Temperatura** | Shqipëria | Rritja e temperaturës mesatare vjetore , veçanërisht për muajt e verës | +1,2-4,4°C (Verë: +1.-5.8°C) | Rritja e avullimit Rritja e temperaturës së ditëve të ftohta Rritja e përqindjes në reshjet e dimrit në formë shiu (në vend të borës) |
| | Bregdeti Shqiptar | Rritja e temperaturës minimale dhe maksimale (të gjitha stinët) | Maksimumi i verës: +1,5-6,4°C Min. dimri: +0,9-3,8°C | |
| | Bregdeti Shqiptar | Rritja e shpeshtësisë së temperaturave jashtëzakonisht të larta | Ulja e periudhës ciklike nga 100 vjet në 9.2 – 3.6 vjet (shembulli i Tiranës) | Rritja e frekuencës së thatësirave |
| | Shqipëria | Rritja e numrit të netëve tropikale | Nga 1 në 10-70 / vit | |
| | Shqipëria | Rritja e numrit dhe kohëzgjatjes së valëve të të nxehtit | +17,5 – 38,5 ditë (deri në vitin 2050) | |
| **Reshjet** | Bregdeti Shqiptar | Ulje e reshjeve vjetore, veçanërisht për muajt e verës | -1.6 në -7.1% | |
| | Bregdeti Shqiptar | Rritje e reshjeve për muajt e dimrit | +1.8 to +7.8% | Rritje e shfaqjeve të përmbytjeve, sidomos gjatë dimrit, por edhe gjatë muajve të |
| | Bregdeti Shqiptar | Ndryshueshmëri e shtuar e reshjeve, me frekuencë dhe intensitet të shtuar të ngjarjeve të reshjeve të dendura | Ulja e periudhës ciklike nga 100 vjet në 60-75 vjet | |

| Faktorët | Siperfaqja | Ndryshimi | Kohështrirja (në 2100) | Efektet/Risqet |
|---|---|---|---|---|
| | | | (shembulli i Tiranës) | vjeshtës dhe të pranverës. |
| | Bregdeti Shqiptar/Shqipëria | Ulja e bilancit kumulativ 12-mujor të ujit (SPEI) | -0.34 deri - 2.08 | Rritje e shpeshtësisë së thatësirave Ulje e rrjedhjes vjetore të lumenjve (pellgu i Vjosës) |
| **Rritja e nivelit të detit (SLR)** | Bregdeti Shqiptar | Rritja e nivelit të detit | Baseni i Vjosës: mesatarisht +45 cm (RCP 4.5) deri +60 cm (RCP 8.5) | Kripëzimi i akuifereve bregdetare Rritja e cenueshmërisë së zonave bregdetare ndaj përmbytjeve nga stuhitë dhe erozioni |

Ndryshimet e parashikuara në modelet e reshjeve gjatë muajve të dimrit, vjeshtës dhe pranverës rrisin riskun e përmbytjeve të lumenjve. Për shkak të rrafshësisë së tyre, zonat bregdetare nuk janë vetëm të ndjeshme ndaj përmbytjeve të parashikuara në rritje nga lumenjtë, por edhe nga valët e stuhive për shkak të rritjes se nivelit te detit. Përmasat e përmbytjeve dhe erozionit të zonave bregdetare pritet të rriten, duke prekur në mënyrë jo proporcionale plazhet, grykëderdhjet e lumenjve dhe lagunat dhe duke shkaktuar rrëshqitje toke. Duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e infrastrukturës së Shqipërisë ndodhet në zonën e saj bregdetare, ajo mund të preket. Bregdeti i Adriatikut, dhe delta e lumenjve Drini dhe Mati në veçanti janë identifikuar me "cënueshmëri kritike" ndaj ndryshimeve klimatike.

Infrastruktura e furnizimit me ujë bën pjesë në infrastrukturën e rrezikuar nga ndryshimet klimatike, pasi përmbytjet dhe stuhitë mund të ndikojnë në rrjetin ekzistues dhe impiantet e trajtimit. Për më tepër, rritja e nivelit te detit parashikohet të rrisë nivelin e ujit të lumenjve, duke përmbytur brigjet e lumenjve dhe duke rritur kripëzimin e akuiferëve bregdetarë. Rritjet e parashikuara të temperaturës do të çojnë në rritje të avullimit, veçanërisht në verë. Disponueshmëria e ujit do të ndikohet më tej nga ulja e reshjeve të parashikuara të jenë më të forta gjatë muajve të verës, duke rezultuar në uljen e rrjedhjes së lumenjve.

Nga ana tjetër, kërkesa për ujë pritet të rritet. Kjo lidhet kryesisht me rritjen e aksesit në furnizim me ujë dhe rritjen e përdorimit personal të ujit për mirëqenien, si dhe sfidat për qeverisjen e tij. Edhe pse efekti margjinal i ndryshimit të klimës është i vështirë për t'u parashikuar, valët e të nxehtit dhe thatësirat ka të ngjarë të çojnë në kulme të larta të kërkesës.
Duke pasur parasysh varësinë e lartë të vendit nga hidrocentralet dhe gjendjen e keqe të infrastrukturës përkatëse, furnizimi me energji është i prekshëm nga ndryshimet klimatike. Ulja e parashikuar e rrjedhjes vjetore të lumenjve do ta përkeqësojë këtë situatë. Në të vërtetë, Politika Kombëtare e Ndryshimeve Klimatike (2019) vlerëson se “deri në vitin 2050, prodhimi mesatar vjetor i energjisë elektrike nga hidrocentralet e mëdha të Shqipërisë mund të reduktohet me rreth 15% dhe nga hidrocentralet e vegjël me rreth 20%”. Infrastruktura

hidroelektrike mund të dëmtohet gjithashtu gjatë ngjarjeve të reshjeve të mëdha, të cilat tentojnë të shkaktojnë sasi jashtëzakonisht të larta të sedimenteve që derdhen në lumenj dhe diga.

Nga ana e kërkesës konsumatore, temperaturat e rritura do të shkaktojnë një rritje të ditëve të ftohta midis majit dhe shtatorit, gjë që do të reflektojë në kërkesën më të lartë për energji elektrike. Rrjeti i energjisë është i ekspozuar ndaj rritjes së kërkesës pikërisht në periudhën e vitit ku furnizimi pritet të jetë më i ulët. Prandaj, muajt e thatë të verës, me avullim më të lartë dhe thatësira më të shpeshta, do të ndikojnë në nivelin e rezervuarëve në muajt e verës.
Rritja e frekuencës dhe intensitetit të valëve të të nxehtit dhe thatësirave ka të ngjarë të rrisë numrin e zjarreve, veçanërisht zjarret në pyje, të cilat kërcënojnë mjedisin natyror, por edhe jetesën, vendbanimet dhe jetët njerëzore.

Fatkeqësitë e lidhura me klimën do të rrisin riskun e lëndimit dhe vdekjes së parandalueshme në mesin e popullatës, dhe veçanërisht në mesin e grupeve të cenueshme. Përmbytjet kanë qenë rreziku natyror që ka prekur shumicën e njerëzve midis viteve 1985-2019 dhe kjo tendencë është rritur vitet e fundit. Përveç pasojave të drejtpërdrejta të shëndetit fizik dhe mendor nga përmbytjet, përfshihen sëmundjet e transmetueshme nga uji ndaj të cilave foshnjat dhe fëmijët janë më të cenueshëm.

## 6.4. Grupet e cënueshme dhe ZRF

Fatkeqësitë prekin të gjitha sferat e shoqërisë, megjithatë disa grupe sociale janë më të prekura se të tjerat për shkak të cenueshmërive të tyre specifike. Këtyre grupeve duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë gjatë përgjigjes ndaj fatkeqësive, por gjithashtu të përfshihen në fazat e gatishmërisë dhe parandalimit pasi ka një vlerë të shtuar në zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse jo vetëm për grupin në fjalë, por për të gjithë shoqërinë.

Të gjitha fazat e menaxhimit të riskut të fatkeqësive dhe të gjitha projektet e identifikuara nga SKZRF do të duhet të marrin në konsideratë elementin e grupeve të cenueshme dhe cilat do të jenë efektet për mirëqenien e tyre. Për më tepër, kapilarizimi i elementeve të kësaj strategjie të grupeve të cenueshme është thelbësor për nivelin e hartimit dhe zbatueshmërisë së planeve të pushtetit vendor për menaxhimin e riskut të fatkeqësive. Prandaj, dispozitat e përgjithshme strategjike lidhur me grupet e cenueshme do të duhet të përshtaten në strategjitë dhe planet e nivelit vendor në përputhje me nevojat përkatëse lokale.

Grupet më të cenueshme përbëhen nga familje të pafavorizuara financiarisht, komunitete të margjinalizuara dhe të përjashtuara nga shoqëria, duke përfshirë minoritetet dhe anëtarët e komunitetit LGBTQ, gratë, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Risku i fatkeqësisë varet nga aftësia ripërtëritëse e strukturës sociale, ekonomike dhe politike dhe mund të zvogëlohet duke zvogëluar ekspozimin dhe cenueshmërinë dhe duke rritur këtë aftësi ripërtëritëse. Ndërtimi i aftësisë ripërtëritëse në të gjitha pjesët e shoqërisë kërkon përfshirje dhe partneritet të gjithë sektorëve. Ai gjithashtu kërkon pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, të aksesueshme dhe jodiskriminuese, duke i kushtuar vëmendje të veçantë njerëzve jashtëzakonisht të cenueshëm ndaj fatkeqësive.

Kjo Strategji dhe aktivitetet e planifikuara duhet t'u përmbahen nevojave dhe kërkesave të grupeve të cenueshëm. Kuptimi i cenueshmërive të ndryshme është i rëndësishëm për zvogëlimin e risqeve dhe për të siguruar që nevojat e veçanta të plotësohen në të gjitha fazat e MRF. Grupet e cenueshme mund të përballen me sfida specifike gjatë dhe pas fatkeqësive. Këto përfshijnë mungesën e aksesit në informacion dhe komunikim, lehtësira dhe shërbime të

paarritshme, mungesë aksesi në burimet e nevojshme mbështetëse, mungesë kornizash të politikave përfshirëse dhe të përgjegjshme etj.

Disa veprime mbështesin aftësinë ripërtëritëse të grupeve të cenueshme Këto përfshijnë: mbështetjen e projektimit dhe zbatimit të gatishmërisë emergjente të fokusuar në aftësinë ripërtëritëse; zgjidhje të qëndrueshme nga te cilat përfitojnë të gjithë nëse grupet e cenueshme përfshihen në planifikimin dhe zbatimin e menaxhimit të emergjencave, strategjitë efektive dhe gjithëpërfshirëse të menaxhimit të emergjencave dhe aktivitetet e përgjigjes, rimëkëmbjes dhe rigjenerimit që përfshijnë cenueshmërinë.

Rehabilitimi social është një pjesë e rëndësishme e rehabilitimit nga fatkeqësitë. Grupet e cenueshme shpesh kanë nevojë për mbështetje të veçantë sociale për t'i mbijetuar ndikimeve të fatkeqësive. Kështu, ky lloj rehabilitimi do të përfshinte aktivitete të ndryshme si aktivitete edukative dhe mbështetje psikologjike. Objektet arsimore mund të vuajnë shumë në fatkeqësi - duke shkaktuar stres të konsiderueshëm te fëmijët. Prandaj, është e rëndësishme, në fazën e rehabilitimit, të jepen këshilla të rregullta për mësuesit, prindërit dhe fëmijët, të inkurajohen fëmijët të ndjekin rregullisht shkollën, t'u sigurohet fëmijëve materiale shkrimi dhe libra, t'i bëjmë fëmijët të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet duke arritur normalitet në oraret ditore , në shkollë dhe shoqëri.

### *Personat me aftësi të kufizuara dhe ZRF*

Edhe në kohë normale (faza para fatkeqësisë) personat me aftësi të kufizuara janë subjekt i diskriminimit dhe përjashtimit. Cenueshmëria e tyre rritet me ndryshimin e rrethanave për shkak të fatkeqësive. Zbatimi i SKZRF-së në Shqipëri duhet të krijojë kushte dhe të forcojë rrjetet e aftësisë së kufizuar në fazën para fatkeqësisë, duke identifikuar kapacitetet e tyre dhe duke i përfshirë në procesin e planifikimit. Të qenit me aftësi të kufizuara nuk e bën dikë të pambrojtur sipas përkufizimit, madje mund të zbulojë gjithashtu kapacitete dhe aftësi të atij personi ose një grupi personash me vlerë të shtuar për komunitetin që nuk ekzistonin më parë. Për ta bërë këtë, sistemi për mbrojtjen sociale luan një rol vendimtar dhe për këtë arsye duhet të krijohen lidhje efektive me ZRF.

### *Gjinia dhe ZRF*

Meqenëse fatkeqësitë prekin burrat, gratë, djemtë dhe vajzat në mënyra të ndryshme, integrimi i perspektivave gjinore në zbatimin e SKZRF-së u mundëson të gjithëve, pavarësisht aftësive dhe prejardhjes sociale, të gëzojnë të njëjtat mundësi. Zbatimi i një lente gjinore në këtë iniciativë ZRF do të mundësojë adresimin e kapaciteteve specifike gjinore dhe nevojave konkrete në popullatën e prekur, si dhe aftësinë e komuniteteve të prekura të grave dhe burrave për t'u përballur dhe rimëkëmbur nga fatkeqësitë. Gjinia shpesh ndërthuret me faktorë të tjerë si mosha, orientimi seksual, lëvizshmëria sociale, përkatësia etnike, prejardhja kulturore, statusi ekonomik ose profesioni, duke përforcuar cenueshmërinë e një individi ndaj fatkeqësive. Këta faktorë i bëjnë gratë dhe vajzat më të prirura për t'u prekur në mënyrë jo proporcionale nga fatkeqësitë dhe çojnë në një rritje të humbjes së mjeteve të jetesës, dhunës me bazë gjinore dhe vdekjeve. Meqenëse gjinia përcaktohet nga shpërndarja aktuale e pushtetit në shoqëri dhe lidhja e ngushtë e saj me normat dhe vlerat ekzistuese shoqërore, të pasurit e perspektivave gjinore të trajtuara në projektet e ZRF të identifikuara me Strategjinë e ZRF do të mundësojë adresimin më të mirë të nevojave të grave dhe vajzave të prekura nga perspektivat ndërsektoriale si dhe synimin dhe zbatimin e projekteve kuptimplotë.

Kuadri Sendai thekson rëndësinë e angazhimit të grave në ndërtimin e programeve të aftësive ripërtëritëse ndaj fatkeqësive. Rekomandimet specifikojnë marrjen në konsideratë të perspektivës së gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar dhe kulturore në të gjitha politikat dhe praktikat e ZRF-së, pasi: “Pjesëmarrja e grave është kritike për menaxhimin efektiv të riskut të

fatkeqësive dhe hartimin, dhënien e burimeve dhe zbatimin e politikave, planeve dhe programeve për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive me ndjeshmëri gjinore; dhe duhet të merren masa adekuate për ngritjen e kapaciteteve për të fuqizuar gratë për gatishmëri, si dhe për të ndërtuar kapacitetin e tyre për mjete alternative të jetesës në situatat pas fatkeqësisë."

Për më tepër, angazhimi i grave dhe vajzave në rritjen e aftësisë ripërtëritëse të komunitetit është thelbësor për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, veçanërisht OZHQ 5 (barazia gjinore dhe fuqizimi i grave). Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave janë çështje ndërsektoriale dhe parakushte për arritjen e shumë OZHQ-ve të tjera, duke përfshirë OZHQ 1 (pa varfëri), OZHQ 11 (qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme) dhe OZHQ 13 (Ndryshimet klimatike). Përmbushja e OZHQ -ve mbështetet në vlerësimin dhe promovimin e kapaciteteve unike të grave kur bëhet fjalë për ZRF. Të bësh këtë jo vetëm që do të ndihmojë politikëbërësit, ekipet e shpëtimit dhe profesionistët e ZRF-së që t'u shërbejnë komuniteteve të prekura në mënyrë më efektive, por gjithashtu mund të korrigjojnë pabarazitë dhe padrejtësitë ekzistuese gjinore.

SKZRF do t'u ofrojë grave mundësi për të marrë role udhëheqëse në zvogëlimin e riskut, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen, i pozicionon ato të ndikojnë në drejtimin e zhvillimit dhe mundëson shfaqjen e roleve dhe marrëdhënieve gjinore më progresive.

Një nga kriteret buxhetore në planin e veprimit për projektet strategjikë do të jetë edhe ndjeshmëria gjinore për të cilën do të ketë një listë kontrolli me kritere buxhetore të ndjeshme gjinore.

***Të moshuarit, fëmijët, minoritetet dhe komuniteti LGBTQ***

Të moshuarit, fëmijët dhe minoritetet e margjinalizuara dhe anëtarët e komunitetit LGBTQ janë më të prekshëm pas një fatkeqësie të madhe. Prandaj, është e rëndësishme që në fazën e rehabilitimit të organizohen këshillime të rregullta për forcimin e shëndetit, veçanërisht mendor të grupeve të cenueshme; kushtim vëmendje te shëndetit, ushqyerjes dhe higjienës në paketën e rehabilitimit afatgjatë; aktivizim ose riaktivizim për qendrat e kujdesit ditor dhe shtëpitë e të moshuarve; promovim për grupet e vetëndihmës etj.

Përveç këtyre veprimeve, është e rëndësishme që reaguesit e emergjencës të jenë të vetëdijshëm dhe kompetent në planifikimin, përgjigjen dhe rimëkëmbjen gjithëpërfshirëse, në mënyrë që grupet e cenueshme të mund të marrin pjesë në aftësinë ripërtëritëse, përgjigjen dhe rimëkëmbjen në të njëjtën bazë si të tjerët.

Në fund, ka një njohje në rritje në Evropë të komplementariteteve të shumta dhe një konvergjence në rritje në qasjet ndërmjet ndihmës së ofruar në kontekste krize dhe qasjeve të mbrojtjes sociale të miratuara në kontekste më të qëndrueshme. Kështu, vendi duhet të marrë në konsideratë zbatimin dhe funksionimin e programeve të mbrojtjes sociale në situata tronditjesh dhe krizash të zgjatura dhe lidhjen e ndihmës humanitare me sistemet e mbrojtjes sociale.[21].

[21] https://socialprotection.org/discover/publications/tools-and-methods-series-reference-document-no-26-social-protection-across

# Shtojca 1: Analiza SWOT

## Pikat e forta

Ekzistojnë disa statistika dhe baza të dhënash
Personeli i përgatitur dhe i gatshëm për të ndërmarrë udhëtime të reja në fushën e arsimit
Burime të rëndësishme njerëzore (staf mësimdhënës + studentë) të gatshëm për të kontribuar në këtë fushë
Institucionet krijojnë akte ligjore të miratuara dhe në proces
Planet e Menaxhimit për zonat e mbrojtura.
Planet operacionale për parandalimin e rrëshqitjeve të tokës, erozionit, përmbytjeve, zjarreve.

## Pikat e dobëta

Mungesa e mjeteve të nevojshme nga buxheti kombëtar
Zhvendosje masive e popullsisë në zonat pranë burimeve ujore
Ndërgjegjësim dhe njohuri e ulët për përgjigjen dhe riskun
Investime të pamjaftueshme në kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme dhe
Mungesë trajnimi dhe ndërgjegjësimi
Rolet e paqarta dhe mungesa e njohurive dhe kapaciteteve teknike në institucione
Mungesa e kuadrit ligjor të përshtatshëm
Mungesa e kurrikulave për menaxhimin e fatkeqësive
Mungesa e kapaciteteve inspektuese

FAKTORËT E BRENDSHËM

## MUNDËSITË

Mbështetje institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare për përfshirje në projekte dhe programe në fushën e Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive
Intensifikimi i kërkimit shkencor në fushën e Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive
Përmirësimi i EUROKODEVE për të rritur sigurinë nga përmbytjet
Programet dhe trajnimet ekzistuese
Zbatimi i Kuadrit Sendai
Bashkëpunimi brenda dhe ndërmjet institucioneve

## KËRCËNIMET

Ndërtim pa leje pa kriter
intensitet i lartë ndërtimi në zona me risk të lartë
Rregulla dhe rregullore të pazbatuara
terren i vështirë dhe i paarritshëm për t'iu përgjigjur fatkeqësive të caktuara
Mungesa e planeve dhe legjislacionit për ndryshimin e klimës

FAKTORËT E JASHTËM

POZITIVE

NEGATIVE

# Shtojca 2: Lista e dokumenteve kombëtare në përputhje me Strategjinë

Tabela 4. Lista e dokumenteve kombëtare

| Nr. | Dokumenti |
|---|---|
| 1. | Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë |
| 2. | Ligji Nr. 103/2014 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë” |
| 3. | VKM nr. 348, datë 11.5.2016 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020" |
| 4. | Progres Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë |
| 5. | VKM nr.91, datë 9.2.2022 “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2022–2024” |
| 6. | Ligji nr. 75/2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes së Parisit, në kuadër të konventës kuadër të kombeve të bashkuara, për ndryshimet klimatike” |
| 7. | Raporti i Vlerësimit të rreziqeve në Shqipëri, Tetor 2003 |
| 8. | Plani Kombëtar për Emergjencat Civile në Shqipëri |
| 9. | Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar |
| 10. | Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar |
| 11. | Ligji nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut” |
| 12. | Ligji nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin” |
| 13. | Ligji nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” |
| 14. | VKM nr. 810 prot., datë 21.10.2020 “Për miratimin e dokumentit “standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri - tema: zonat me rreziqe natyrore” |
| 15. | Aktet nënligjore të Ligjit Nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” |
| 16. | Ligji nr.45/2019, “Për Mbrojtjen Civile” |
| 17. | Aktet nënligjore të Ligjit 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile” |
| 18. | VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” |
| 19. | VKM nr. 148, datë 24.2.2016 “Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të integruar të informacionit dhe statistikës të Këshillit të Ministrave” |
| 20. | VKM nr. 501, datë 13.9.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes”, i ndryshuar me VKM nr. 9, datë 12.1.2018. |

| Nr. | Dokumenti |
|---|---|
| **21.** | Ligji nr.10 435, datë 23.6.2011 "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë" |
| **22.** | Ligji nr. 72/2015 "Për miratimin e strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë" |
| **23.** | VKM nr. 628, datë 25.9.2019 "Për miratimin e dokumentit të rishikimit të strategjisë së mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë" |
| **24.** | VKM-të përkatëse lidhur me përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrive |
| **25.** | Ligji nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" |
| **26.** | Aktet nënligjore të Ligjit nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" |
| **27.** | VKM nr. 345, datë 22.5.2019 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të ujitjes dhe kullimit 2019–2031 dhe të planit të veprimit" |
| **28.** | VKM nr. 437, datë 17.5.2017 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë" |
| **29.** | VKM nr. 221, datë 26.4.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", i ndryshuar |
| **30.** | Ligji nr. 24/2017 "Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit" |
| **31.** | Udhëzim nr.12, datë 30.12.2019 "Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit" |
| **32.** | VKM nr. 73, datë 7.2.2018 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, 2018–2027" |
| **33.** | Ligji nr. 8681, datë 2.11.2000 "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", i ndryshuar |
| **34.** | Ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar |
| **35.** | VKM nr. 147 datë 18.3.2004 "Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave" |
| **36.** | Urdhri nr. 370, datë 11.6.2019 "Për miratimin e statutit tip të Organizatës së Përdoruesve të Ujit" |
| **37.** | Urdhri nr. 697, datë 30.12.2019 "Për miratimin e regjistrave të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, bashkive dhe organizatave të përdoruesve të ujit" |
| **38.** | VKM nr. 1015, datë 16.12.2020 "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet" |
| **39.** | VKM nr.1157, datë 25.11.2009 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit", i ndryshuar |
| **40.** | VKM nr.567, datë 14.7.2010 "Për transferimin e rezervuarëve dhe skemave ujitëse përkatëse nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore dhe për një ndryshim në vendimin nr.1157, datë 25.11.2009 të KM "për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit" |

| Nr. | Dokumenti |
|---|---|
| **41.** | VKM nr.1108, datë 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit", i ndryshuar |
| **42.** | Projekti i Programit të Rimëkëmbjes nga Përmbytjet: UTF/ALB/010/ALB "Rikuperimi i dëmeve bujqësore dhe rivendosja e kapacitetit prodhues" |
| **43.** | Ligji nr. 57/2020, datë 30.4.2020, "Për pyjet" |
| **44.** | Ligji nr.9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar |
| **45.** | Ligji nr.10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar |
| **46.** | VKM nr. 1080, datë 22.12.2010, "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve". |
| **47.** | VKM nr.290, datë 30.4.2004, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota" |
| **48.** | Dokument "Mbi politikat e sektorit të pyjeve në Shqipëri" |
| **49.** | Zbatimi i Politikës pyjore për kujdesin dhe shërbimet cilësore ndaj pyjeve-Politikat 10; 11 dhe 12 - Masat-31; 32; 33; 34; 35; 36; 37; 38; 39 and 40 |
| **50.** | Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar |
| **51.** | VKM nr.80, datë 28.1.2005 "Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore" |
| **52.** | Urdhri nr. 535, datë 27.9.2019 "Për miratimin e marrëveshjes tip të bashkëpunimit ndërmjet bashkisë dhe shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor" |
| **53.** | Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025 |
| **54.** | Menaxhimi i riskut nga fatkeqësitë për trashëgiminë botërore – Manual 2010 |
| **55.** | Ligji nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" |
| **56.** | VKM nr. 420, datë 15.6.2022 "Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura" |
| **57.** | VKM nr. 1125, datë 30.12.2020 "Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre" |
| **58.** | Menaxhimi i Riskut të fatkeqësive të Siteve të Trashëgimisë Kulturore në Shqipëri- 2014 |
| **59.** | Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Trashëgimisë Kulturore pa Kufij (OJQ): Përmirësimi i sistemit të monitorimit të gjendjes së pasurive kulturore |
| **60.** | Planet për përgatitjen për emergjencat civile, të Ministrisë së Kulturës dhe 28 institucioneve në varësi |
| **61.** | VKM nr. 1099 datë 24.12.2020 "Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore" |

| Nr. | Dokumenti |
|---|---|
| 62. | Analiza e Riskut Sizmologjik - Gjeo-rrezikut dhe Udhëzimet për Zvogëlimin e Riskut të fatkeqësive për parkun arkeologjik të Apolonisë, qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës dhe Butrintit" |
| 63. | Ligji nr. 7864, datë 29.9.1994 “Për Kryqin e Kuq Shqiptar”, i ndryshuar. |
| 64. | Ligji nr.7865, datë 29.9.1994, “Për mbrojtjen e emblemës dhe të emrit të Kryqit të Kuq” |
| 65. | Plani i KKSH për gatishmërinë dhe përgjigjen ndaj fatkeqësive |
| 66. | Politika e KKSH-së në fushën e Emergjencave dhe Krizave |
| 67. | Strategjia KKSH për Zhvillim 2020-2030 |
| 68. | VKM nr.290, datë 30.4.2004, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota”. |
| 69. | Akti Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me ligjin 97/2019 |
| 70. | Gjithë paketa ligjore e përbërë nga ligjet, Aktet Normative dhe VKM-të që lidhen me Komisionin Shtetëror të Rindërtimit dhe më pas me Ministrin e Shtetit për Rindërtimin e cila gjendet në: https://rindertimi.gov.al/ligje/ |
| 71. | Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit |
| 72. | Ligji nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar |
| 73. | VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", i ndryshuar |
| 74. | Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar |
| 75. | Ligji 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” |
| 76. | Ligji nr. 111/2015, datë 15. 10. 2015 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar” |
| 77. | Ligji nr. 8025, datë 9.11.1995 Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese, i ndryshuar |
| 78. | Ligji nr. 824, datë 18.12.2019 “Për miratimin e strategjisë sektoriale të menaxhimit të financave publike 2019-2022” |
| 79. | Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar |
| 80. | Legjislacioni i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit |
| 81. | Strategjia e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive në Bashkinë Lezhë, 2020 |
| 82. | Vlerësimi i Riskut të Fatkeqësive në bashkinë Lezhë, 2020 |
| 83. | Plani vendor për emergjencat civile në bashkinë Lezhë, 2020 |
| 84. | Komanda Evropiane e Shteteve të Bashkuara (USEUCOM) "Raporti i Vlerësimit të aftësive të Kundërtrafikimit të Armëve të Shkatërrimit në Masë/ Menaxhimit të Pasojave dhe Gatishmërisë ndaj Fatkeqësive". Korrik 2014 |
| 85. | Raporti i Nevojave pas Përmbytjes në Shqipëri, prill 2015 |
| 86. | Menaxhimi i Fatkeqësive në Shqipëri. Analiza e Mangësive. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Prezenca në Shqipëri. 2017 |

| Nr. | Dokumenti |
|---|---|
| 87. | Analizë gjithëpërfshirëse e reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe e sistemit të menaxhimit për bujqësinë në Shqipëri |
| 88. | Komunikimi i Tretë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë mbi Ndryshimet Klimatike |
| 89. | Vlerësimi i Nevojave pas Fatkeqësive (PDNA) në Shqipëri, shkurt 2020 |
| 90. | "Drejt strategjisë gjithëpërfshirëse të menaxhimit të riskut të fatkeqësive në Shqipëri". Vlerësimi i kapacitetit të sistemit të menaxhimit të riskut të fatkeqësive. Raport vlerësimi. UNDP 2020 |
| 91. | Diagnostikimi i Financave të Riskut të Fatkeqësive. Shqipëri. Banka Botërore. Dhjetor 2020 |
| 92. | Raport diagnostikues. Vlerësimi i gatishmërisë dhe përgjigjes emergjente. Shqipëri. Banka Botërore 2021 |
| 93. | Raport investimesh. Vlerësimi i gatishmërisë dhe përgjigjes emergjente. Shqipëri. Banka Botërore 2021 |
| 94. | Përmirësimi i informacionit për riskun e fatkeqësive dhe humbjet në Shqipëri. Katalogu i informacionit të lidhur me riskun - Detyra 1. Banka Botërore. Shkurt 2022 |
| 95. | Përmirësimi i informacionit për riskun e fatkeqësive dhe humbjet në Shqipëri. Vlerësimi dhe përmirësimi i aksesit të informacionit të lidhur me riskun - Detyra 2. Banka Botërore. Mars 2022 |
| 96. | Përmirësimi i informacionit për riskun e fatkeqësive dhe humbjet në Shqipëri. Rekomandime për përmirësimin e informacionit për humbjen pas fatkeqësisë. Detyra 3. Banka Botërore. Mars 2022 |
| 97. | Përmirësimi i informacionit mbi riskun dhe humbjet nga fatkeqësitë në Shqipëri. Përmbledhje ekzekutive. Maj 2022 |
| 98. | Planifikimi Kombëtar i Përshtatjes (NAP) ndaj ndryshimit të klimës në Shqipëri. Kornizë për procesin e vendit |
| 99. | Raporti i parë i përditësimit dyvjeçar të Shqipërisë, korrik 2021 |
| 100. | Standardi ISO 31000 për Menaxhimin e Riskut |
| 101. | Dokumenti i Referencës së Serisë së Mjeteve dhe Metodave Nr. 26: Mbrojtja sociale përgjatë lidhjes së zhvillimit humanitar. Një ndryshues loje në mbështetjen e njerëzve përmes krizave |
| 102. | VKM Nr. 866, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020-2023 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj” |
| 103. | VKM Nr. 276, datë 12.05.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021-2025” |
| 104. | Ligj Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. |
| 105. | VKM Nr. 400, datë 30.06.2021 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore, 2021 – 2030 dhe të planit të saj të veprimit” |

# Shtojca 3: Plani i Veprimit për Zvogëlimin e Riskut të fatkeqësive për Shqipërinë 2023-2027.

Menaxhimi i Riskut të Fatkeqësive është një fushë jashtëzakonisht komplekse dhe ka një efekt shumë-sektorial në pothuajse të gjitha aspektet e jetës dhe zhvillimit. Ai përfshin politika të ndryshme që duhet të veprojnë në sinergji për të përmirësuar aktivitetet e parandalimit, përgjigjes dhe rimëkëmbjes.

Si pjesë e zhvillimit të Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, është hartuar Plani i Veprimit për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për periudhën 2023-2027 si akt që bën operacional zbatimin e Strategjisë. Për periudhën e mbetur të zbatimit të Strategjisë do të zhvillohet edhe një plan veprimi, përkatësisht Plani i Veprimit për periudhën 2028-2030.

Shumat në Planin e Veprimit i referohen vlerësimit tregues të kornizës financiare të çdo aktiviteti ose kostos së zbatimit të projektit dhe bëhen në bazë të hulumtimit të tregut dhe përvojës së propozuesve.

Plani i veprimit i referohet aktiviteteve të menaxhimit të gjithsej 6 risqeve të përcaktuara për qëllime të hartimit të Strategjisë deri në vitin 2030. Për secilin risk janë përcaktuar një sërë aktivitetesh që do të realizohen me prioritet deri në fund të vitit 2026. Krahas aktiviteteve individuale të menaxhimit të riskut, Plani i Veprimit përfshin grupe aktivitetesh që njëkohësisht ndikojnë në nivelin e të gjitha ose më shumë risqeve njëherësh: aktivitete për forcimin e Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive.

## 1. Menaxhimi i riskut të fatkeqësive me shumë risqe[22]

Tabela 5. Projektet e menaxhimit të riskut të fatkeqësive me shumë risqe

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | Ministria e Mbrojtjes dhe ministritë e linjës. Projekti do të mbështetet nga UNDP RESEAL |

[22] Kostot e të gjithë projekteve strategjikë në seksionet 1-7 janë vendosur në monedhën origjinale të projekteve strategjikë të propozuar nga anëtarët e grupeve ndërinstitucionale të punës për hartimin e SKZRF-së

<table>
<tr><td>Projekti strategjik 1:</td><td>Përmbushja e mëtejshme e detyrimeve të Shqipërisë si një vend anëtar i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian (MMC BE)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Përshkrimi: Pas nënshkrimit në datën 18.11.2022 të “Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian, njëra palë dhe Republikës së Shqipërisë, pala tjetër, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit” Shqipëria është tashmë anëtarja e 35-të me të drejta të plota në MMC BE. . Zbatimi i procedurave kërkon aktet nënligjore që kërkohen për zbatimin e TESTA-s në mënyrë që të bëhet funksionale në Shqipëri duke siguruar kështu lidhjen me sistemin e përbashkët të komunikimit dhe informacionit emergjent (CECIS).<br><br>AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti mes këtij projekti dhe:<br>- Projektit Strategjik nr.3: “Zbatimi i plotë dhe në të gjithë territorin e Shqipërisë i numrit të unifikuar të Emergjencave Civile 112”<br>- Projektit Strategjik nr.4: “Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri”;</td></tr>
<tr><td>Afati kohor:</td><td>2023 - 2027</td></tr>
<tr><td>Aktivitetet kryesore:</td><td>1. Identifikimi i kërkesave teknike dhe institucionale për qasje në TESTA<br>2. Mbështetja e përgatitjes së udhërrëfyesit për ngritjen e sistemit TESTA<br>3. Zhvillimi i materialeve të trajnimit dhe planeve dhe programeve mësimore në përputhje me udhëzimet e BE-së.<br>4. Mbështetje për ngritjen e sistemit TESTA<br>5. Mbështetje për forcimin e protokolleve të bashkëpunimit dhe qasjes së pikës së vetme të kontaktit në trajtimin e MMC BE<br>6. Kryerja e trajnimeve mbi legjislacionin e MMC BE, rregullat zbatuese dhe procedurat e përgjithshme<br>7. Rekomandime teknike në lidhje me vendosjen e lidhjeve të komunikimit me Qendrën Koordinuese të Përgjigjes Emergjente të BE-së (ERCC)<br>8. Aktivizimi i lidhjes dhe lidhshmërisë me mjetet e monitorimit të BE-së dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm (EFAS, EFFIS, Copernicus)<br>9. Sigurimi i planifikimit në kohë të burimeve financiare të nevojshme për pagesën e tarifave vjetore për TESTA si dhe anëtarësimin në MMC BE</td></tr>
<tr><td>Korniza financiare/burimi:</td><td>Gjithsej 1.840.000 USD - EUR Buxheti i BE/OKB/Buxhet Kombëtar<br>nga të cilat 840,000 USD do të jenë të projektit UNDP RESEAL</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |

<table>
<tr><td>Institucione kontribuuese</td><td>Ministria e Mbrojtjes</td></tr>
<tr><td>Projekti strategjik 2:</td><td>Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së AKMC-së dhe forcave operacionale përmes krijimit të një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot"</td></tr>
<tr><td colspan="2">Përshkrimi: Krijimi i një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot" sipas standardeve ndërkombëtare për t'iu bashkuar kapaciteteve të EERC. Ky modul do të certifikohet nga Komisioni Evropian dhe do të jetë gati për t'iu bashkuar EERC-së.<br><br>AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti mes këtij projekti dhe:<br>- Projektit Strategjik nr.4: “Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri”;<br>- Projektit Strategjik nr.12: “Forcimi i sistemit të Paralajmërimit të Hershëm”;<br>- Projektin strategjik nr.8 të tërmeteve: “Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të Forcave Operacionale ndaj tërmeteve nëpërmjet krijimit të një moduli të Kërkim Shpëtimit të Rëndë Urban (HUSAR)”;<br>- Projektin strategjik nr.8 të përmbytjeve: “Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj përmbytjeve duke plotësuar modulet ekzistuese FRB dhe FC të BE-së për përmbytje”;<br>- Projektin strategjik nr.5 të zjarreve në pyje: “Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj zjarreve në pyje përmes modulit "Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje" të BE-së”</td></tr>
<tr><td>Afati kohor:</td><td>2023 - 2025</td></tr>
<tr><td>Aktivitetet kryesore:</td><td>1. Studimi për ngritjen e një “Ekipi me mjete ajrore pa pilot”.<br>2. Kryerja e të gjitha procedurave të nevojshme kombëtare të nevojshme për miratimin dhe fillimin e komunikimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO.<br>3. Kryerja e aktiviteteve të nevojshme të komunikimit dhe koordinimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO<br>4. Kryerja, në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe DG ECHO, të aktiviteteve të trajnimit dhe/ose ushtrimeve në prani të autoriteteve të Komisionit Evropian<br>5. Kryerja e procesit të certifikimit të modulit si dhe regjistrimi i tij në EERC<br>6. Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për modulin si dhe pagesat e tjera vjetore të funksionalitetit dhe operimit të tij</td></tr>
<tr><td>Korniza financiare/burimi:</td><td>Kostot e zhvillimit: 15,500,000 euro (fondi maksimal i nevojshëm për krijimin e një moduli është vendosur)<br>Mirëmbajtja: 7'500’000 EURO<br>Dislokimi: 8’308’160 EURO<br>Në total = 31,308,160 EURO</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Ministria e Mbrojtjes |
| Institucione kontribuuese | Ministria e Brendshme dhe ministri të tjera të linjës |
| Projekti strategjik 3: | *Zbatimi i plotë dhe në të gjithë territorin e Shqipërisë i numrit të unifikuar të Emergjencave Civile 112* |
| *Përshkrimi: Vënia në zbatim e Numrit të Unifikuar të Emergjencave 112, bazuar në fazën aktuale të zbatimit të tij si edhe studimin e fizibilitetit dhe projektin e zbatimit të hartuar në vitin 2011, nëpërmjet projektit të Bankës Botërore Al-DRMAP.*<br>*AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti dhe:*<br>- *Projektit Strategjik nr 1: "Përmbushja e mëtejshme e detyrimeve të Shqipërisë si një vend anëtar i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian (MMC BE)"*<br>- *Projektit Strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";* | |
| Afati kohor: | *2023 - 2026* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Hartimi dhe miratimi i VKM-së "Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112"*<br>2. *Hartimi i një studimi për gjendjen e zbatimit të 112 në Shqipëri, bazuar në gjendjen faktike dhe studimin e fizibilitetit dhe projektin e zbatimit të vitit 2011.*<br>3. *Nëse është e nevojshme, bazuar në përfundimet e studimit, hartimi i një projekti të ri për zbatimin e numrit 112.*<br>4. *Zbatimi i numrit të Unifikuar të Emergjencës Civile 112 bazuar në konkluzionet e studimit të kryer dhe projektit të ri/studimit të fizibilitetit dhe projektit të zbatimit, të kryer në dhjetor 2011, në kuadër të projektit të Bankës Botërore "Projekti për Zbutjen dhe Përshtatjen ndaj Riskut të Fatkeqësive" (AL-DRMAP).*<br>5. *Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për zbatimin e numrit të unifikuar të emergjencës civile 112 sikurse pagesat e tjera vjetore të funksionimit dhe operimit të tij.* |
| Korniza financiare/burimi: | 30,000,000 EURO BE/OKB/Buxhet kombëtar |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | Struktura qendrore e MZSH-së, përfshirë 12 drejtoritë e MZSH në bashkitë - qendra qarqesh. Projekti do të mbështetet nga AICS |
| Projekti strategjik 4: | *Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri* |
| *Përshkrimi: Në vijim të Konferencës së Donatorëve, të datës 17 Shkurt 2020 (mbajtur për tërmetin e datës 26 Nëntor 2019), Cooperazione Italiane në bashkëpunim me qeverinë Italiane, do të menaxhojnë fondet për mbrojtjen civile që do të investohen apo dhurohen në Shqipëri nga të gjithë donatorët.* Projekti konsiston në financimin nga Qeveria Italiane në formën e kredisë është një projekt i tërë dhe me nën komponentë të ndërtimit dhe infrastrukturave teknologjike të godinës së re të AKMC-së, pajisjet për sallat e operacionale në katër qendrat e AKMC-s dhe 8 Prefektura, mjetet dhe pajisjet, kampus shkollor për trajnim<br><br>*AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti dhe:*<br><br>- *Projektit strategjik nr.1: "Përmbushja e mëtejshme e detyrimeve të Shqipërisë si një vend anëtar i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian (MMC BE)"*<br>- *Projektit strategjik nr.2: Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së AKMC-së dhe forcave operacionale përmes krijimit të një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot";*<br>- *Projektit strategjik nr.3: "Zbatimi i plotë dhe në të gjithë territorin e Shqipërisë i numrit të unifikuar të Emergjencave Civile 112";*<br>- *Projektin strategjik nr.9: "Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile":*<br>- *Projekti strategjik nr.17: "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave"*<br>- *Projektin strategjik nr.22: "Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të zjarrfikësve, sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe mjete";*<br>- *Projektin strategjik nr.7 të zjarreve në pyje: "Forcimi i kapaciteteve teknike të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit";*<br>- *Projektin strategjik nr. 23: "Forcimi i kapacitete të gatishmërisë së forcave operacionale përmes trajnimeve, ushtrimeve dhe stërvitjeve"* | |
| Afati kohor: | *2022 - 2026* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Ndjekja e të gjitha procedurave të nevojshme për miratimin e Marrëveshjes së Kredisë*<br>2. *Ndërtimi dhe pajisja e ndërtesës së re të AKMC-së;*<br>3. *Sigurimi i furnizimit me mjete, automjete dhe pajisje për AKMC-në dhe Shërbimin e MZSH-së;*<br>4. *Rritja e formimit profesional të stafit të MZSH-së;* |

| | |
|---|---|
| Korniza financiare/burimi: | 30,000,000 euro |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | Ministria e Mbrojtjes dhe ministritë e linjës |
| Projekti strategjik 5: | *Politikat dhe legjislacioni* |
| *Përshkrimi: Përfundimi i hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore, në zbatim të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile".*<br>*AKMC duhet të sigurojë sinergjinë dhe komplementaritetin e:*<br>*Aktivitetit nr.3 të këtij projekti me projektet respektive të lidhura me metodologjinë e vlerësimit të riskut të veçantë sikurse janë:*<br>- *Projektin strategjik nr.15: "Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të riskut të fatkeqësive në nivel qarku"*<br>- *Projekti strategjik nr.2 i tërmetit: "Përmirësimi, përditësimi dhe harmonizimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga tërmetet";*<br>- *Projekti strategjik nr,2 i zjarreve në pyje "Përmirësimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga zjarri në territor";*<br>- *Projekti strategjike nr.1 i sëmundjeve infektive/biologjike "Metodologjia e zhvillimit për vlerësimin e riskut biologjik"*<br>*Aktivitetit nr.4 të tij me:*<br>- *Projektin strategjik nr.7: "Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)".*<br>- *Projektin strategjik nr. 20: "Përmirësimi i të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Menaxhimi i Informacionit të Riskut"* | |
| Afati kohor: | *2023 - 2025* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Bazuar në rezultatet e konsulencës së dokumentit të PKEC-së, zhvillimi i vazhdimësisë së planifikimit të operacioneve (COOP) dhe vazhdimësisë së Qeverisë (COG) në ministri dhe institucione të tjera të sigurisë dhe mbrojtjes;*<br>2. *Hartimi i metodologjisë për Planin e Emergjencave Civile në nivel qendror, qarku dhe vendor si dhe për infrastrukturën kritike, SEVESO dhe institucione të tjera (sipas detyrimit përkatës që buron nga neni 23, pika 6, shkronja "dh" e ligjit 45/2019);*<br>3. *Hartimi i Metodologjisë/Udhëzimit për Vlerësimin e Riskut të fatkeqësive në nivel qendror, qarku dhe vendor si dhe infrastrukturën kritike;* |

| | |
|---|---|
| | 4. *Hartimi i udhëzimeve për funksionet e Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë në ndihmë të përdoruesve të tij;*<br>5. *Hartimi i udhëzimeve, rregulloreve dhe manualeve të përcaktuara nga konsulenca e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile* |
| Korniza financiare/burimi: | 500,000 EURO |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | Projekti do të mbështetet nga UNDP RESEAL |
| Projekti strategjik 6: | *Zhvillimi i Procedurave Standarde Operacionale prioritare të sistemit të MC (UNDP RESEAL)* |
| *Përshkrimi: Identifikimi i sfidave të bashkëpunimit në përgjigje të emergjencave brenda dhe ndërmjet agjencive të emergjencave në Shqipëri dhe përpjekje për të ndërtuar kapacitete për t'i trajtuar ato në përputhje me rrethanat. Projekti do të bazohet në rezultatet e konsulencës së Planit Kombëtar të Emergjencave Civile që përfshin:*<br>- *kryerjen e një analize të mangësive të procedurave aktuale për zhvillimin e procedurave standarde të funksionimit të komunikimit dhe njoftimit të gjithë qeverisë (SOP) dhe ushtrimin e tyre në nivel kombëtar, qarku, bashkie dhe incidenti;*<br>- *Rekomandime për udhëzimet, rregulloret, manualet dhe PSO-të e reja që do të zhvillohen në vend;*<br><br>*AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:*<br>- *Aktivitetin nr.3 "Zhvillimi i procedurave standarde operacionale" të Projektit strategjik nr.17: "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave";*<br>- *Projektin strategjik nr.1 të zjarreve në pyje "Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shërbimeve homologe të rajonit të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi)"* | |
| Afati kohor: | *2023 - 2024* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Bazuar në rezultatet e Konsulencës së PECK, kryerja e një analize të mangësive të procedurave aktuale për të zhvilluar procedurat standarde të funksionimit të komunikimit dhe njoftimit të gjithë qeverisë (SOP) dhe ushtrimin e tyre në nivel kombëtar, qarku, bashkie dhe incidenti;*<br>2. *Bazuar në rezultatet e Konsulencës së PECK për SOP që do të zhvillohet në Shqipëri:* |

| | |
|---|---|
| | *2.1. SOP-të e identifikuara me prioritet të zhvilluara në konsultim me palët e interesit dhe institucionet përkatëse*<br>*2.2. Mbështetje konsultimesh për SOP dhe miratimin e tyre* |
| Korniza financiare/burimi: | 150,000 USD. UNDP. Projekti RESEAL |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | Projekti do të mbështetet nga UNDP RESEAL |
| Projekti strategjik 7: | *Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)* |
| *Përshkrimi: Pas miratimit të VKM nr. 345, datë 26.5.2022 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të humbjeve nga fatkeqësitë" pritet të miratohen edhe udhëzime për funksionet e bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në mbështetje të përdoruesve të saj. Projekti do të ndihmojë në përmbushjen e detyrimit ligjor për të krijuar një bazë të dhënash për humbjet nga fatkeqësitë, që është një detyrim për AKMC-në, ministritë dhe institucionet qendrore si dhe institucionin e prefektit dhe bashkitë.*<br><br>*AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:*<br>- *Projektin strategjik nr.5: Politikat dhe legjislacioni"*<br>- *Projektin strategjik nr.20 "Përmirësimi i të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Menaxhimi i Informacionit të Riskut";*<br>- *Projektin strategjik nr.22: "Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcimi i kapaciteteve monitoruese të zjarrfikësve, sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe mjete".*<br>- *Projektin strategjik nr.3 të tërmeteve: "Baza e të dhënave të vetive strukturore të ndërtesave"* | |
| Afati kohor: | *2023 - 2024* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Studimi i të gjitha raporteve ekzistuese në lidhje me të dhënat e humbjeve nga fatkeqësitë në Shqipëri dhe identifikimi i gjendjes ekzistuese*<br>2. *Zbatimi i bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë*<br>3. Mirëmbajtja e bazës së të dhënave dhe përmirësime ligjor |

| | |
|---|---|
| Korniza financiare/burimi: | 100,000 USD. UNDP. Projekti RESEAL |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Ministria e Arsimit dhe Sportit (vetëm për kurrikulat) |
| Institucione kontribuuese | Strukturat vendore të shërbimit të MZSH |
| Projekti strategjik 8: | *Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut* |
| *Përshkrimi: Krijimi dhe përfshirja në kurrikulat e njohurive të Mbrojtjes Civile, si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore përmes trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm. Përgatitja e një programi ndërgjegjësues të komunitetit dhe të planit përkatës të punës si dhe zbatimi i tij.* | |
| Afati kohor: | *2023 - 2025* |
| Aktivitetet kryesore: | *1. Kryerja e një studimi për përfshirjen në planet dhe programet mësimore të njohurive të Mbrojtjes Civile, verifikim nëse niveli parauniversitar ofron njohuri për mbrojtjen dhe parandalimin e fatkeqësive, në përputhje me profilin e tyre.*<br>*2. Në përputhje me përfundimet e studimit, hartimi i një plani veprimi për përmbushjen e detyrimit ligjor.*<br>*3. Zbatimi i planit të veprimit për përfshirjen në planet dhe programet mësimore të njohurive të Mbrojtjes Civile*<br>*4. Zhvillimi i një programi ndërgjegjësimi publik për ZRF dhe të planit të veprimit*<br>*5. Zbatimi i planit të veprimit të ndërgjegjësimit publik për ZRF* |
| Korniza financiare/burimi: | 600,000 EURO Buxheti i BE/OKB/Kombëtar |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | |
| Projekti strategjik 9: | *Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile* |

| | |
|---|---|
| *Përshkrimi: Sipas nenit 26, pika 6, shkronja "f" të ligjit 45/2019, AKMC përgatit Programin e Trajnimit të Strukturave Civile të Mbrojtjes Civile, në nivel qendror dhe vendor. AKMC, nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Trajnimit për Mbrojtjen Civile, kryen trajnime të strukturave shtetërore, subjekteve private dhe vullnetare. Nga ana tjetër, bashkitë duhet të organizojnë trajnime në fushën e Mbrojtjes Civile për punonjësit dhe banorët në territorin e tyre. Projekti mbështet AKMC-në në zhvillimin e moduleve të trajnimit me qëllim që të fillojë sa më shpejt zbatimi i Programit të Trajnimit të Personelit në të gjithë sistemin e Mbrojtjes Civile të vendit.*<br><br>*AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:*<br>- *Projektin strategjik nr.17 të planifikuar nga Banka Botërore "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave";*<br>- *Projektin strategjik nr.19: "Forcimi i Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive në Bashki;*<br>- *Projektin strategjik nr.22: "Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të zjarrfikësve, sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe mjete";*<br>- *Projektin strategjik nr.23: "Forcimi i kapacitete të gatishmërisë së forcave operacionale përmes trajnimeve, ushtrimeve dhe stërvitjeve"* | |
| Afati kohor: | *2023 - 2027* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Zhvillimi i Programit të Trajnimit të Mbrojtjes Civile bazuar, ndër të tjera, në Planin e ri Kombëtar të Emergjencave Civile dhe veçanërisht në rekomandimet e konsulencës të PKEC lidhur me të.*<br>2. *Mbështetja e konsultimeve ndërinstitucionale dhe miratimi i programit të trajnimit*<br>3. *Implementimi i Programit të Trajnimit të Mbrojtjes Civile* |
| Korniza financiare/burimi: | 1,000,000 EURO Buxheti i BE/OKB/Kombëtar |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | Do të mbështetet nga JICA dhe donatorë të tjerë |
| Projekti strategjik 10: | *Ngritja dhe forcimi i sistemit të paralajmërimit dhe njoftimit të hershëm për zjarret në pyje (JICA)* |
| *Përshkrimi: Qëllimi i këtij projekti është forcimi i sistemit të integruar të menaxhimit të emergjencave në Shqipëri me kapacitet të zhvilluar të agjencive qeveritare për mbrojtjen nga zjarret në pyje dhe fatkeqësitë e tjera natyrore. Një sistem të tillë të paralajmërimit të hershëm, JICA e ka zhvilluar në Maqedoninë e Veriut dhe kjo shihet si një qasje për kontribut rajonal* | |

| | |
|---|---|
| *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:*<br>- *Projektin strategjik nr.4 të Zjarreve në pyje: "Studim mbi nevojat për ngritjen e sistemit të sinjalizimit dhe të vëzhgimit";*<br>- *Projektin strategjik nr.11: "Alb-Adapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse"";*<br>- *Projektin strategjik nr.1 të zjarreve në pyje: "Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shërbimeve homologe të rajonit të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi)"* | |
| Afati kohor: | *2023-2025* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Kryerja e një misioni nga ekspertët japonezë për një vlerësim të gjendjes ekzistuese të sistemit të paralajmërimit të hershëm. Identifikimi i boshllëqeve, mangësive dhe propozimet për përmirësim*<br>2. *Nënshkrimi i Marrëveshjes Teknike për Asistencën Teknike të Qeverisë së Japonisë*<br>3. *Implementimi i projektit* |
| Korniza financiare/burimi: | Kosto e përafërt e Projektit JICA 4,000,000 Euro |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e mbështetur nga donatorët dhe institucione të tjera |
| Institucione kontribuuese | Do të mbështetet nga GIZ, donatorë dhe institucione të tjera |
| Projekti strategjik 11: | *Alb-Adapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse"* |
| *Përshkrimi: Projekti kërkon të transformojë të gjithë zinxhirin e vlerës së shërbimeve klimatike: nga ndërtimi i një Kornize Kombëtare për Shërbimet Klimatike tek ndërtimi i një sistemi paralajmërimi të hershëm të bazuar në ndikim me shumë rreziqe për veprim të hershëm dhe mobilizimin e burimeve financiare për masat e adaptimit. Për të zvogëluar ndikimet e rreziqeve hidrometeorologjike të shkaktuara nga klima, qasja në kohë në Sistemet e Informacionit Klimatik dhe Paralajmërimit të Hershëm (Climate Information & Early Warning Systems / CIEWS) dhe shpërndarja e masave dhe investimeve të synuara do të përmirësohet ndjeshëm përmes projektit. Si rezultat, komunitetet dhe vendimmarrësit e prekshëm shqiptarë do të jenë në gjendje të ndërmarrin veprime të hershme, të marrin vendime të informuara financiare të klimës dhe do të jenë më ripërtëritës ndaj ndikimeve të ndryshimit të klimës, veçanërisht ato që lidhen me rreziqet që lidhen me ujin në zonat bregdetare.* | |

| | |
|---|---|
| *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:*<br>- *Projektin strategjik nr.4 të Zjarreve në pyje: "Studim mbi nevojat për ngritjen e sistemit të sinjalizimit dhe të vëzhgimit";*<br>- *Projektin strategjik nr.10: "JICA - Ngritja dhe forcimi i sistemit të paralajmërimit dhe njoftimit të hershëm për zjarret në pyje";*<br>- *Projektin strategjik nr.21: "Rehabilitimi i 16 stacioneve të rrjetit hidrometeorologjik të siguruara në kuadër të projektit të Bankës Botërore "Zbutja dhe Përshtatja ndaj Riskut të Fatkeqësive" (AL-DRMAP)" dhe që nuk u rehabilituan në kuadër të Programit PRO NEWS;*<br>- *Projektin strategjik nr. 3 të përmbytjeve: "Vlerësimi i riskut nga përmbytjet dhe paralajmërimi i hershëm";*<br>- *Projektin strategjik nr.4 të përmbytjeve: "Vlerësimi i riskut nga thatësira";*<br>- *Projektin strategjik nr.1 të zjarreve në pyje: "Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shërbimeve homologe të rajonit të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi)"* | |
| Afati kohor: | *2023-2027* |
| Aktivitetet kryesore: | *Komponenti 1 - Shërbimet e Informacionit për Klimën*<br>*Komponenti 2- Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm dhe Veprimit të Hershëm me shumë rrezitje të bazuara në ndikim*<br>*Komponenti 3 Vendime dhe investime të informuara nga klima* |
| Korniza financiare/burimi: | *Green Climate Fund (GCF) dhe GIZ*<br>*Fondi i kërkuar i GCF 35,450,000 euro*<br>*Kostoja totale e projektit (GCF + bashkëfinancim) 49,950,000 euro* |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | |
| Projekti strategjik 12: | *Forcimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm* |
| *Përshkrimi: Qëllimi i këtij projekti është forcimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm në vend nëpërmjet teknologjive të avancuara bashkëkohore sikurse janë dronët dhe blerjeve të një softueri që do të ndihmojë sistemin e paralajmërimit të hershëm të tipit Katwarn, Nokia*<br><br>*AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:* | |

| | |
|---|---|
| - *Projektin strategjik nr.2: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së AKMC-së dhe forcave operacionale përmes krijimit të një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot"";*<br>- *Projektin strategjik nr.4 të Zjarreve në pyje "Studim mbi nevojat për ngritjen e sistemit të sinjalizimit dhe të vëzhgimit";* | |
| Afati kohor: | *2023-2027* |
| Aktivitetet kryesore: | *1. Blerja e 4 dronëve të nivelit mesatar për 4 qendrat Rajonale të Mbrojtjes Civile.*<br>*2. Trajnimi i nevojshëm për përdorimin e dronëve*<br>*3. Identifikimi i mangësive të tjera duke pasur parasysh investimet në vijim ose Zhvillimi i Listës Kontrolluese të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm*<br>*4. Në një periudhë afat shkurtër: blerja e një softueri që do të ndihmojë sistemin e paralajmërimit të hershëm të tipit Katwarn, Nokia*<br>*5. Blerja e Licencave përkatëse për Software, Instalim, Integrim*<br>*6. Parashikimi i kostove të mirëmbajtjes dhe llogaritja e kostove përkatëse për tarifat vjetore për kompanitë që blejnë licenca.* |
| Korniza financiare/burimi: | Kosto totale: 1,582.530 euro |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | Projekti do të mbështetet nga donatorë |
| Projekti strategjik 13: | *IPA CBC STRATEGJIK Shqipëri, Mali i Zi, Itali* |
| *Përshkrimi: Pesë akset prioritare janë: 1. Adriatik i Jugut krijues; 2. Adriatik i Jugut i ripërtëritës; 3. Adriatik i Jugut i lidhur; 4. Adriatik i Jugut i zgjuar; 5. Qeverisja e mirë e Adriatikut të Jugut. Shtylla kryesore në të cilën përfshihet Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është shtylla nr. 2, Adriatik i Jugut i ripërtëritës;* | |
| Afati kohor: | *2023-2025* |
| Aktivitetet kryesore: | *1. Rritja e qëndrueshmërisë së burimeve ujore ose qëndrueshmërisë së territoreve të prekura nga fatkeqësitë ujore ose të dyja.* |

| | |
|---|---|
| | 2. *Rritja e kapaciteteve për aftësinë ripërtëritëse ndërkufitare, me investime të vogla në infrastrukturë, për mbrojtjen nga zjarri në pyje dhe studime të mundshme fizibiliteti dhe çdo studim tjetër vlerësues që nevojitet sipas legjislacionit shqiptar dhe atij të BE-së.* |
| Korniza financiare/burimi: | 2.000,000 EURO Buxheti i BE/OKB/Kombëtar |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| Institucione kontribuuese | Do të mbështetet nga Banka Botërore |
| Projekti strategjik 14: | *Forcimi i gatishmërisë financiare të vendit përmes miratimit të një Programi Kombëtar të Financimit të Riskut të fatkeqësive* |
| *Përshkrimi: Programi synon të rrisë aftësinë ripërtëritëse financiare të vendeve me të ardhura të mesme kundër fatkeqësive natyrore dhe të mbështesë kapacitetin e tyre për të përmbushur nevojat e financimit pas fatkeqësisë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve këshillimore neutrale dhe të pavarura. Ai synon të thellojë dialogun, të ndihmojë vendet të arrijnë një rimëkëmbje të gjelbër, ripërtëritëse dhe gjithëpërfshirëse. Programi mbështet Shqipërinë që nga viti 2019.* | |
| Afati kohor: | *2022 - 2026* |
| Aktivitetet kryesore: | *1. Menaxhimi i detyrimeve kontingjente të qeverisë lidhur me fatkeqësitë*<br>*1.1. Transparenca e shpenzimeve pas fatkeqësisë dhe ofrimi i likuiditetit të shpejtë*<br>*1.2. Rritja e efikasitetit të kostos së përdorimit të financave publike*<br>*1.3. Mobilizimi i kapitalit të sektorit privat për menaxhimin e detyrimeve të qeverisë*<br>*1.4. Rregullimi i procesit të financimit pas fatkeqësisë*<br>*1.5. Rritja e disponueshmërisë së fondeve për qeveritë vendore*<br>*2. Qasje në shërbimet financiare pas fatkeqësisë nga familjet, fermerët dhe bizneset dhe të varfrit*<br>*2.1. Sigurimi nga tërmetet për familjet*<br>*2.2. Qasje në financa (nga fermerët, NMV-të)*<br>*2.3. Mbrojtja sociale e përshtatur*<br>*2.4. Zhvillimi i tregut të sigurimeve*<br>*2.5. Futja e instrumenteve financiare që mund të forcojnë aftësinë ripërtëritëse të sektorit financiar dhe privat kundër fatkeqësive dhe ndryshimeve klimatike* |

| | |
|---|---|
| | *3. Menaxhimi i risqeve të lidhura me fatkeqësitë e sektorit financiar dhe privat dhe mobilizimi i financave për forcimin e aftësisë ripërtëritëse (investime të gjelbra dhe të qëndrueshme)*<br>*3.1. Rritja e aftësisë ripërtëritëse së sektorit financiar dhe privat kundër fatkeqësive* |
| Korniza financiare/burimi: | Korniza financiare/burimi: SECO rreth 450.000 USD |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Institucionet e Prefektit të Qarkut |
| Institucione kontribuuese | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Projekti strategjik 15: | *Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të Riskut të fatkeqësive në nivel qarku* |
| *Përshkrimi; Institucioni i Prefektit të qarkut ka një sërë detyrimesh në menaxhimin e riskut dhe të vetë të fatkeqësive të cilat përcaktohen në nenin 28 të ligjit 45/2019. Ndërkohë që niveli qendror dhe ai i bashkisë kanë në dispozicion burimet financiare për përmbushjen e këtyre detyrimeve, institucioni i Prefektit të Qarkut nuk ka buxhet për këtë qëllim. Është e domosdoshme hartimi i dokumenteve të vlerësimit të riskut të fatkeqësive në nivel qarku i cili do të kryhet krahas rishikimit të planeve të EC që do të kryhet në kuadër të projektit strategjik nr.4 "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri".. Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të riskut në nivel qarku do të mbështetet tek dokumenti i VRF në nivel qendror, tek projekti pilot në bashkinë Lezhë por edhe në përvojën e hartimit të dokumenteve në gjashtë bashkitë e qarkut Fier që është në proces implementimi.*<br><br>*AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:*<br>- *Projektin strategjik nr.5: "Politikat dhe legjislacioni":*<br>- *Projektin strategjik nr.2 të tërmeteve: "Përmirësimi, përditësimi dhe harmonizimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga tërmetet";*<br>- *Projektin strategjik nr. 2 të zjarreve në pyje: "Përmirësimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga zjarri në territor";*<br>- *Projektin strategjik nr.1 të sëmundjeve infektive/biologjike : "Metodologjia e zhvillimit për vlerësimin e riskut biologjik"* | |
| Afati kohor: | *2023 - 2025* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Përgatitja e vlerësimit të riskut të fatkeqësive në nivel qarku në qarqe<br>2. *Miratimi i dokumenteve të vlerësimit të riskut në nivel qarku nga Institucioni i Prefektit të Qarkut* |

| | |
|---|---|
| Korniza financiare/burimi: | 2,640,000 EURO Buxheti i BE/OKB/Kombëtar |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| Institucione kontribuuese | AKMC dhe ministritë e linjës |
| Projekti strategjik 16: | Hartimi dhe miratimi i bazës ligjore për infrastrukturën kritike |
| *Përshkrimi: Ligji 45/2019 ka kapitullin V "Mbrojtja e infrastrukturës kritike dhe e trashëgimisë kulturore" të kushtuar mbrojtjes së infrastrukturës kritike dhe trashëgimisë kulturore. Ai ka gjithashtu një nen në këtë kapitull kushtuar infrastrukturës kritike me efekt ndërkufitar. Ligji 45/2019 nuk siguron përafrim të plotë me Direktivën e BE-së për IK prandaj dhe prej kohësh është evidente në praktikë nevoja e hartimit të bazës ligjore për infrastrukturën kritike që do të sigurojë bazën ligjore të munguar me qëllim, ndër të tjera, marrjen e masave të vazhdueshme për të siguruar rritjen e aftësisë ripërtëritëse të saj. Legjislacioni i IK do të sigurojë njëkohësisht edhe përafrim të plotë të legjislacionit shqiptar me Direktivën e Këshillit 2008/ 114/KE, datë 8.12.2008, "Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre"* | |
| Afati kohor: | *2023 - 2024* |
| Aktivitetet kryesore: | *1. Hartimi dhe miratimi i ligjit "Për infrastrukturën kritike" duke siguruar, ndër të tjera, përafrim të plotë me Direktivën e Këshillit të BE-së 2008/114, datë 8 dhjetor 2008, "Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturës kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojave për përmirësimin e mbrojtjes së tyre".*<br>*2. Hartimi i të gjitha akteve nënligjore të ligjit "Për infrastrukturën kritike" që hap rrugën për rritjen e aftësisë ripërtëritëse të infrastrukturës kritike dhe zbatimin në praktikë të Direktivës përkatëse të BE-së* |
| Korniza financiare/burimi: | |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e MZSH dhe strukturat vendore të MZSH |
| Institucione kontribuuese | Projekti do të mbështetet nga Banka Botërore |

<table>
<tr><td>Projekti strategjik 17:</td><td>Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave</td></tr>
<tr><td colspan="2">Përshkrimi: Një vlerësim i kohëve të fundit[23] thekson mangësitë e rëndësishme në sistemet e gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave, duke përfshirë sistemet e informacionit, paralajmërimit të hershëm, strehimet, kapacitetet e përgjigjes dhe shpëtimit, zjarrfikësit dhe strukturat e organizimit të incidenteve. Sistemi sfidohet nga pajisjet pjesërisht të vjetruara dhe mungesa e një qendre operacionale të emergjencës (EOC) të integruar, të pajisur mirë dhe funksionale, dhe një qendre kombëtare trajnimi. Banka Botërore ka identifikuar investimet e nevojshme të gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave në tre horizonte: afatshkurtra (10.6 milionë USD), afatmesme (54.8 milionë USD) dhe afatgjata (33.0 milionë USD).<br><br>AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:<br>- Projektin strategjik nr.4: “Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri”;<br>- Projektin strategjik nr.9: “Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile”;<br>- Projektin strategjik nr.19: “Forcimi i Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive në Bashki”;<br>- Projektin strategjik nr.22: “Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të zjarrfikësve, sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe mjete”;<br>- Projektin strategjik nr.23: “Forcimi i kapacitete të gatishmërisë së forcave operacionale përmes trajnimeve, ushtrimeve dhe stërvitjeve”;<br>- Projektin strategjik nr.7 të “Zjarreve në pyje”: “Forcimi i kapaciteteve teknike të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”;<br>- Në veçanti duhet siguruar sinergjia dhe komplementariteti i aktivitetit nr.3 “Zhvillimi i procedurave standarde operacionale” me projektin strategjik nr.6 “Zhvillimi i Procedurave Standarde Operacionale prioritare të sistemit të MC (UNDP RESEAL)”</td></tr>
<tr><td>Afati kohor:</td><td>2024 – 2027</td></tr>
<tr><td>Aktivitetet kryesore:</td><td>1. Prokurimi i pajisjeve të përgjigjes ndaj emergjencave dhe sistemeve të TIK<br>2. Punime të mundshme për qendrat e operacionale dhe qendrave të trajnimit<br>3. Zhvillimi i procedurave standarde operacionale<br>4. Trajnime<br><br>Aktivitetet e mësipërme janë të gjitha nga projekti strategjik nr.2 i Bankës Botërore, “Forcimi i Gatishmërisë dhe Përgjigjes Emergjente”</td></tr>
<tr><td>Korniza financiare/burimi:</td><td>$10 milion - $30 milion (me gjasa më e lartë)</td></tr>
</table>

[23] https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/35716

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Institucionet publike, strukturat qendrore dhe vendore apo subjektet private, të cilët i kanë në pronësi/administrim infrastrukturat e përzgjedhura. Instituti i Ndërtimit |
| Institucione kontribuuese | Projekti do të mbështetet nga Banka Botërore |
| Projekti strategjik 18: | *Përmirësimi i aftësive ripërtëritëse të infrastrukturës kritike dhe ndërtesave publike* |
| *Përshkrimi: Duke pasur parasysh rolin kritik të stacioneve të përgjigjes së parë (zjarrfikës, polici, etj.), spitaleve, shkollave dhe ndërtesave të tjera publike, aftësia ripërtëritëse e tyre duhet të vlerësohet dhe nëse është e nevojshme të përforcohet, në mënyrë që jo vetëm të rritet siguria, por edhe të sigurohet vazhdimësia e shërbimeve, veçanërisht gjatë krizave. Kjo do të ofronte gjithashtu mundësinë për të përmirësuar funksionalitetet e infrastrukturës dhe për t'i bërë ato më gjithëpërfshirëse dhe efikase për energjinë.*<br>*AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:*<br>- *Projektin strategjik nr.16: “Hartimi dhe miratimi i bazës ligjore për infrastrukturën kritike”;*<br>- *Projektin strategjik nr. 7 të “Zjarreve në pyje”: “Forcimi i kapaciteteve teknike të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH)”;*<br>- *Projektin strategjik nr.3 të risqeve teknologjike-industriale: “Krijimi i një baze të dhënash për llogaritjen, menaxhimin dhe parandalimin e risqeve teknike dhe teknologjike, sipas sektorëve”* | |
| Afati kohor: | *2024 – 2027* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Vlerësimi i stacioneve të përgjigjes së parë (si dhe infrastrukturës tjetër të përzgjedhur kritike publike) për aftësinë ripërtëritëse prej fatkeqësive (fizike dhe funksionale)*<br>2. *Projektimi i stacioneve/ndërtesave ripërtëritëse*<br>3. *Punime ndërtimi/rehabilitimi* |
| Korniza financiare/burimi: | 20$ milion - 40$ milion (me gjasa më e lartë) |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Bashkitë e përzgjedhura |

| | |
|---|---|
| Institucione kontribuuese | Institucioni i Prefektit të Qarkut, Ministria e Brendshme dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.<br><br>Projekti do të mbështetet nga Banka Botërore |
| Projekti strategjik 19: | *Forcimi i Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive në Bashki* |
| *Përshkrimi: Legjislacioni aktual vendos përgjegjësi të konsiderueshme për Menaxhimin e Riskut të Fatkeqësive mbi bashkitë, shumë prej të cilave po përpiqen të mobilizojnë burimet dhe kapacitetet e nevojshme për të përmbushur nevojat lokale. Ndonëse pjesa më e madhe e investimeve të sipërpërmendura në infrastrukturën kritike të aftësisë ripërtëritëse do të realizohen në nivel bashkie, shumë bashki nuk e shfrytëzojnë buxhetin e angazhuar zyrtarisht për Menaxhimin e Riskut të Fatkeqësive, dhe sistemi me të cilin autoritetet lokale aksesojnë dhe marrin mbështetje nga institucionet kombëtare duhet të të bëhet më i menaxhueshëm, i besueshëm dhe më i fortë.*<br><br>*AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:*<br>- *Projektin strategjik nr.9: "Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile";*<br>- *Projektin strategjik nr.17: "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave"*<br>- *Projektin strategjik nr.23: "Forcimi i kapacitete të gatishmërisë së forcave operacionale përmes trajnimeve, ushtrimeve dhe stërvitjeve"* | |
| Afati kohor: | *2023 – 2024* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Trajnime*<br>2. *Prokurimi i sistemeve përkatëse TIK/GIS* |
| Korniza financiare/burimi: | $1 milion - $3 milion |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | Projekti do të mbështetet nga Banka Botërore |
| Projekti strategjik 20: | *Përmirësimi i të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Menaxhimi i Informacionit të Riskut* |

| | |
|---|---|
| *Përshkrimi: Ndërsa vlerësimi i riskut të fatkeqësive dhe mbledhja e të dhënave të humbjeve të fatkeqësive janë kryer për shumë vite në Shqipëri, detyrimet sipas ligjit 45/2019 zyrtarizojnë kërkesat dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira dhe synojnë të sigurojnë që informacioni përkatës të përdoret në mënyrë pro-aktive për të dhënë përparësi, planifikuar dhe zbatuar ZRF. Projekti synon të mbështesë Shqipërinë për ta arritur këtë, në përputhje me praktikat e mira globale dhe duke ndjekur rekomandimet e zhvilluara gjatë një vlerësimi të fundit të Bankës Botërore*[24]. <br><br> AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me: <br> - *Projektin strategjik nr.7: "Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)";* <br> - *Projektin strategjik nr. 5: "Politikat dhe legjislacioni";* <br> - *Projektin strategjik nr.22: "Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të zjarrfikësve, sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe mjete";* <br> - *Projektin strategjik nr.3 të tërmeteve: "Baza e të dhënave të vetive strukturore të ndërtesave"* | |
| Afati kohor: | *2023 – 2024* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Zhvillimi i procedurave standarde operacionale* <br> 2. *Prokurimi i sistemeve përkatëse TIK/GIS* <br> 3. *Trajnime* |
| Korniza financiare/burimi: | $1 milion - $3 milion |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Instituti i Gjeoshkencave |
| Institucione kontribuuese | Ministria e Mbrojtjes |

[24] https://documents1.worldbank.org/en/publication/documents-reports/documentdetail/099430106142216471
https://documents1.worldbank.org/en/publication/documents-reports/documentdetail/099430006142239792

| | |
|---|---|
| Projekti strategjik 21: | *Rehabilitimi i 16 stacioneve të rrjetit hidrometeorologjik të siguruara në kuadër të projektit të Bankës Botërore "Zbutja dhe Përshtatja ndaj Riskut të Fatkeqësive" (AL-DRMAP) dhe që nuk u rehabilituan në kuadër të Programit PRO NEWS.* |
| *Përshkrimi: 40 stacione hidrometeorologjike janë blerë dhe instaluar në vitin 2013 në kuadër të Projektit të Bankës Botërore "Zbutja dhe Përshtatja ndaj Riskut të Fatkeqësive" (AL-DRMAP). AKMC është pronare e këtyre stacioneve të cilat i kanë kaluar për operim Institutit të Gjeoshkencave nëpërmjet një marrëveshje të përbashkët operacionale. Në kuadër të komponentit "D" të Programit "Përmirësimi i Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe Parandalimi i Përmbytjeve" / PRO NEWS u rehabilituan vetëm 24 nga 40 stacionet e planifikuara. 16 stacionet e mbetura janë edhe ato më problematiket dhe të cilat nevojitet që të rehabilitohen sa më shpejt. Projekti përfshin gjithçka nevojitet për funksionalitetin e plotë në rrjet të stacioneve.*<br><br>*AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me projektin strategjik nr. 11: ALBAdapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse".* | |
| Afati kohor: | *2023 – 2024* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Inspektimi i 16 stacioneve për të konstatuar gjendjen e tyre reale dhe nevojat për rehabilitim*<br>2. *Sigurimi i burimeve financiare të nevojshme për projektimin dhe zbatimin e investimit rehabilitues*<br>3. *Hartimi i projektit të zbatimit bazuar mbi gjendjen e evidentuar nga inspektimet sikurse në të gjithë dokumentacionin dhe përvojën e realizimit të projektit të rehabilitimit të 24 stacioneve nëpërmjet programit PRO NEWS*<br>4. *Implementimi i projektit, mbikëqyrja, marrja në dorëzim* |
| Korniza financiare/burimi: | 535,928.56 euro |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Projekti do mbështetet nga AICS |
| Projekti strategjik 22: | *Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të AKMC-së; sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe pajisje.* |

| | |
|---|---|
| *Përshkrimi: Projekti synon plotësimin e disa mangësive të evidentuara në shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit. Ai konsiston në forcimin e kapaciteteve të sistemit të mbrojtjes civile sikurse janë përmes krijimit të ekipeve me qen për S&R. Ai do të implementohet në bashkëpunim me* Agjencinë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim.<br><br>*AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me:*<br>- *Projektin strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";*<br>- *Projektin strategjik nr.7: "Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)";*<br>- *Projektin strategjik nr.9: "Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile";*<br>- *Projektin strategjik nr.17: "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave";*<br>- *Projektin strategjik nr.20: "Përmirësimi i të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Menaxhimi i Informacionit të Riskut";* | |
| Afati kohor: | *2023 – 2025* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Ndërgjegjësimi dhe ngritja e organizatave vullnetare;*<br>2. *Forcimi i teknologjisë për monitorimin operacional;*<br>3. *Sistemi për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore;*<br>4. *Mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe pajisje.* |
| Korniza financiare/burimi: | 4,000,000 euro |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Projekti do të mbështetet nga AICS |
| Projekti strategjik 23: | *Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë së forcave operacionale përmes trajnimeve, ushtrimeve dhe stërvitjeve* |
| *Përshkrimi: Projekti synon që të rrisë gatishmërinë e sistemit të mbrojtjes civile përmes trajnimeve të stafit të AKMC, pajisjeve, forcimit të kapaciteteve njerëzore të forcave zjarrfikëse si dhe mbështetje të tjera në fushën e ZRF. Projekti do të zbatohet me mbështetjen e AICS.*<br><br>*AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me:* | |

| | |
|---|---|
| - *Projektin strategjik nr.9: "Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile";*<br>- *Projektin strategjik nr.17: "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave";*<br>- *Projektin strategjik nr.19: "Forcimi i Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive në Bashki"* | |
| Afati kohor: | *2023 – 2025* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Zhvillimi i trajnimeve për stafin e AKMC-së;*<br>2. *Sigurimi i pajisjeve të forcave zjarrfikëse;*<br>3. *Forcimi i kapaciteteve njerëzore të forcave zjarrfikëse;*<br>4. *Ngritja e ekipit me qen për MZSH-në* |
| Korniza financiare/burimi: | 1,000,000 euro |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit |
| Institucione kontribuuese | Projekti do të mbështetet nga donatorët |
| Projekti strategjik 24: | Sigurimi i ndihmës teknike për MTM për Kap.27 -Shkrimi dhe negociatat; dhe sigurimi i ndihmës teknike për MTM për të identifikuar nevojat e planifikimit dhe për të mbështetur zbatimin e dokumenteve të planifikimit strategjik. Faza **II**, SANE 27. |
| *Përshkrim: Faza e re e quajtur "Mbështetja e negociatave shqiptare në mjedis, Kapitulli 27 (SANE27)- Faza 2" zbatohet nga Brooks Hannas & Partners, e financuar nga Sida dhe në thelb ka të njëjtën njësi zbatuese që ishte përfshirë për fazën e parë. Programi i ri ka filluar në 1 Shtator 2021, ka një periudhë të fillimit dy-mujor dhe një periudhë të zbatimit njëzet e gjashtë muaj.*<br><br>*SANE27 konsiderohet si program horizontal që përfshin të gjitha çështjet që lidhen me Kapitullin 27 Bisedimet e BE -së dhe qëllimi i tij është: (i) të sigurojë ndihmë teknike për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTE) për Kap.27 -Shkrimi dhe negociatat; dhe (ii) të sigurojë ndihmë teknike për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për të identifikuar nevojat e planifikimit dhe për të mbështetur zbatimin e dokumenteve të planifikimit strategjik.*<br><br>*Përfituesi kryesor i programit do të jetë Ministria e Turizmit dhe Mjedisi me një fokus të veçantë në Departamentin e Integrimit, Koordinimit, Marrëveshjes dhe Ndihmës (Dicaa). Sidoqoftë, të gjitha institucionet dhe personat e lidhur të përfshirë në proceset e integrimit në lidhje me Kapitullin 27 do të përfitojnë nga programi. Programi do të vazhdojë të ketë marrëdhënie të ngushta pune me të gjithë palët e interesuara dhe gjithashtu të përpiqet të krijojë* | |

| | |
|---|---|
| *qëndrueshmëri dhe transferim të njohurive. Programi do të mobilizojë një kombinim të ekspertëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë që do të mbështesin stafin e projektit dhe përfituesit në arritjen e rezultateve. Projekti do të funksionojë bazuar në planet e punës 6-mujore që do të rishikohen dhe miratohen nga komiteti drejtues që përfshin përfaqësues nga MTE dhe SIDA. Takimi i Planifikimit do të mbahet para se të merret dakord secila plan pune* | |
| Afati kohor: | *1/09/2021 – 21/12/2023* |
| Aktivitetet kryesore: | Bazuar në sa më sipër programi është i strukturuar rreth dy rezultateve:<br>Rezultati Nr.1 - Ministria dhe institucionet e tjera të Kap.27 kanë forcuar aftësinë për shqyrtimin dhe negociatat e Kap.27.<br>Sipas këtij rezultati, programi do të mbështesë MTM për të koordinuar procesin e negociatave të BE -së, veçanërisht për të përgatitur përgjigje për pyetjet zyrtare të shqyrtimit të BE -së, të përgatisë prezantime për takime bilaterale të KE, të përgatisë pozicione negociuese dhe të propozojë veprime për të mbyllur boshllëqet e identifikuara. Gjithashtu, ai do të mbështesë MTM në krijimin e një sistemi të mirë të menaxhimit të procesit për të ndjekur përparimin e negociatave të BE -së. Kur kërkohet do të mbështesë MTM me hartimin e vogël ligjor që rrjedhin nga PKIE dhe për të përmbushur detyrimet nga përfundimet e takimeve të nën-komitetit me KE. Ekipi SANE27 do të jetë një shërbim këshillues për MTM kur të jetë e nevojshme.<br>Rezultati Nr.2 - Nevojat për planifikimin strategjik të Kap.27, dokumentet e planifikimit strategjik të rëndësishëm për negociatat e BE -së janë përgatitur dhe ofrohet mbështetje për zbatimin e tyre.<br>Sipas këtij rezultati, programi do të mbështesë MTM në identifikimin e dokumenteve të planifikimit të nevojshëm për negociatat e BE-së, të propozojë veprime për të përgatitur dokumente të tilla dhe për të ndjekur zbatimin e tyre. Gjithashtu, ajo do të mbështesë MTM në programimin e fondeve IPA të BE-së dhe fondeve të tjera të donatorëve me përgatitjen e dokumenteve të veprimit, TOR, propozimet e projektit dhe dokumentet e tjera të prokurimit. Ai do të sigurojë mbështetje në rritjen e koordinimit të donatorëve për sektorin e mjedisit në Shqipëri dhe për të krijuar mekanizma të mirë për planifikimin e investimeve në sektorin e mjedisit. |
| Kuadri financiar/burimi: | Kosto 2,200,000 euro |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | |
| Projekti strategjik 25: | Hulumtimi, zhvillimi dhe zbatimi i një Sistemi Kombëtar të Menaxhimit të Incidenteve (SKMI) |

<table>
<tr><td colspan="2"> Përshkrim: Menaxhimi i incidenteve është një proces sistematik i njohur globalisht për agjencitë e menaxhimit emergjent dhe reaguesit e parë për të menaxhuar emergjencat operacionale, krizat ose fatkeqësitë. Një SMI i standardizuar lehtëson të gjitha agjencitë që punojnë së bashku me procedura, terminologji dhe procese të përbashkëta. Një sistem Shqiptar i menaxhimit të incidenteve (SSHMI) është një koncept thelbësor i shumë-agjencive, me shumë nivele i përdorur për koordinimin dhe zgjidhjen efektive dhe efikase të incidenteve emergjente, pavarësisht nga shkalla ose kompleksiteti. Një SMI i udhëhequr nga AKMC përshtatet me të gjitha rreziqet dhe risqet që rezultojnë në ndërveprim optimal në tokën e incidentit dhe në qendrat operacionale të emergjencës (QOE).
AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:
- Projektin strategjik nr.1: “Përmbushja e mëtejshme e detyrimeve të Shqipërisë si një vend anëtar i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian (MMC BE)”;<br>
- Projektin strategjik nr.4: Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri<br>
- Projektin strategjik nr.6: Politikat dhe legjislacioni;<br>
- Projektin strategjik nr. 7 të zjarreve në pyje: Forcimi i kapaciteteve teknike të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;<br>
- Projektin strategjik nr. 9: Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile;<br>
- Projektin strategjik nr. 17: Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave;<br>
- Projektin strategjik nr.22: Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të AKMC-së; sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe pajisje;<br>
- Projektin strategjik nr.23: Forcimi i kapacitete të gatishmërisë së forcave operacionale përmes trajnimeve, ushtrimeve dhe stërvitjeve </td></tr>
<tr><td>Afati kohor:</td><td>2023 – 2024</td></tr>
<tr><td>Aktivitetet kryesore:</td><td>1. Faza e hulumtimit që përfshin një analizë të boshllëqeve dhe nevojave të sistemeve, procedurave, palëve të interesit dhe burimeve;<br>2. Hartimi dhe zhvillimi i një kuadri kombëtar të sistemit të menaxhimit të incidenteve dhe procedurave standarde operacionale;<br>3. Dizajnimi dhe përshtatja e Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile (QKOEC) dhe Qendrave të Emergjencave Civile në Qarqe (QOECQ);<br>4. Programi i Trajnimit dhe Zhvillimit Kombëtar dhe në qarqe i SMI me shumë nivele për agjencitë e palëve të interesit;<br>5. Zbatimi i platformës së softuerit të menaxhimit të incidenteve i lidhur me platformat e reja ose ekzistuese të TIK -ut.</td></tr>
<tr><td>Kuadri financiar/burimi:</td><td>Kosto 3,250,000 euro. Buxheti i BE/OKB/Kombëtar</td></tr>
</table>

## 2. Tërmetet

Tabela 6. Projektet e lidhura me tërmetet

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Instituti i Gjeoshkencave |
| Institucione kontribuuese | Universiteti Politeknik i Tiranës |
| Projekti strategjik 1: | *Përmirësimi dhe ristrukturimi i Rrjetit Sizmologjik Shqiptar* |
| *Përshkrimi: Projekti do të përfshijë përmirësime teknologjike në monitorimin e aktivitetit sizmik dhe dendësimin e rrjetit aktual sizmologjik, si rrjetin e lëkundjeve të forta ashtu edhe atë të lëkundjeve të dobëta, të cilat do të rrisin kapacitetin e Departamentit të Sizmologjisë të Institutit të Gjeoshkencave për të monitoruar aktivitetin sizmik,si dhe për të vlerësuar rrezikun sizmik në nivel kombëtar. Gjithashtu, do të kryhet edhe rinovimi i stacioneve sizmike si dhe i Qendrës Kombëtare të Monitorimit Sizmik.* | |
| Afati kohor: | 2023 - 2025 |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Përmirësimi i teknologjisë aktuale të monitorimit të Rrjetit Sizmologjik Shqiptar;<br>2. Dendësimi i stacioneve të rrjetit të monitorimit të tërmeteve, dhe atyre të lëkundjeve të forta, për karakterizimin e impaktit sizmik në kushte të ndryshme trojesh;<br>3. Përmirësimi i teknologjisë dhe sistemimi i rrjetit aktual në Qendrën Kombëtare te Monitorimit Sizmik;<br>4. Ripërtëritja e stacioneve sizmologjike aktuale. |
| Korniza financiare/burimi: | 2,200,000 euro nga buxheti i shtetit dhe/ose donatorë |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Ndërtimit, Instituti i Gjeoshkencave, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar |
| Institucione kontribuuese | Universiteti Politeknik, dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Projekti strategjik 2: | *Përmirësimi, përditësimi dhe harmonizimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga tërmetet* |
| *Përshkrimi: Projekti do të kontribuojë në qëllimin strategjik të zvogëlimit të riskut nga tërmetet duke:*<br>● *Siguruar një sistem monitorimi sa më modern dhe kapilar për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave, që do të shërbejë si bazë për trajtimin shkencor të tyre dhe nxjerrjen e konkluzioneve dhe konsideratave strategjike në nivel lokal dhe kombëtar.*<br>● *Duke pasur parasysh se në nivel evropian është bërë përpilimi i të dhënave për hartën e riskut nga tërmetet, ngjarjet e fundit sizmike kanë ndikuar që Shqipëria të përditësojë dhe korrigjojë konkluzionet e deritanishme në lidhje me ekspozimin sizmik të Shqipërisë.*<br>● *Sa më të sakta të jenë të dhënat e mbledhura dhe ngjarjet e regjistruara, aq më efikase do të jenë ndërhyrjet për parandalimin ose zvogëlimin e risqeve nga tërmetet. Natyrisht, kjo kërkon harmonizimin e planeve strategjike të zhvillimit të të gjithë aktorëve, harmonizimin e kuadrit legjislativ të institucioneve përgjegjëse për përgjigjen, përmirësimin e situatës ekzistuese të masave apo mekanizmave parandalues dhe në fund të fundit zhvillim të qëndrueshëm në nivel lokal apo kombëtar.*<br><br>*Përfitimet e pritshme të këtij projekti lidhen me standardizimin e praktikave të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të riskut, standardizimin e sistemit të monitorimit të riskut nga tërmetet në të gjitha bashkitë, praktikat e certifikimit të sigurisë së ndërtesave, etj. Rezultati përfundimtar i këtij projekti është një metodologji e unifikuar për vlerësimin e riskut nga tërmetet, i harmonizuar me praktikat e BE-së ose procedurat standarde ndërkombëtare.*<br>*AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me:*<br>- *Projektin strategjik nr.5 "Politikat dhe legjislacioni";*<br>- *Projektin strategjik nr.15: "Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të Riskut të Fatkeqësive në nivel qarku";*<br>- *Projektin strategjik nr.2 të zjarreve në pyje: "Përmirësimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga zjarri në territor";*<br>- *Projektin strategjik nr.1 infektiv/biologjik: "Metodologjia e zhvillimit për vlerësimin e riskut biologjik";* | |
| Afati kohor: | 2023 - 2025 |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Një studim i gjerë mbi vlerësimet moderne të riskut i cili përfshin një pasqyrë të situatës në vend dhe një strategji zbatimi.<br>2. Trajnime me ekspertë të fushës për Modelin Evropian të Riskut Sizmik për vlerësimin e riskut në nivel kombëtar dhe rajonal.<br>3. Analiza dhe vlerësimi i kuadrit rregullator për përshtatjen e kornizave të institucioneve përgjegjëse për parandalimin, gatishmërinë dhe përgjigjen, të cilat përfshijnë rezultatet e vlerësimit të riskut me qëllim menaxhimin më të mirë të riskut nga tërmetet dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. |
| Korniza financiare/burimi: | 400,000 euro nga buxheti i shtetit dhe fondet e BE-së, donatorë të tjerë |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Ndërtimit, bashkitë, prefekturat, |
| Institucione kontribuuese | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Ministria e Brendshme |
| Projekti strategjik 3: | *Baza e të dhënave të vetive strukturore të ndërtesave* |

*Përshkrimi: Shqipëria klasifikohet si një vend me sizmicitet mesatar (i karakterizuar nga tërmete me intensitet të vogël dhe të mesëm). Lëkundjet janë subjekt i një periodiciteti të caktuar. Zhvendosja masive e popullsisë në zonat urbane me ndërtime pa respektuar kriteret e sigurisë, si dhe në zonat me risk të lartë, mbetet prezente dhe përbën një nga segmentet më në risk nga fatkeqësitë natyrore. Po kështu, ndërtimet pa leje, problemet me çështjet pronësore, gjendja ekonomike, veçanërisht në zonat rurale, vlerësohen si problematike për sa i përket kritereve të ndërtimit si dhe aftësisë për tu rimëkëmbur nga pasojat e tërmeteve.*

*Ky projekt përcakton bazën e nevojshme për të gjitha aktivitetet që lidhen me rrezikun e tërmeteve nga pikëpamja e ndërtimit, dhe përbëhet nga një bazë të dhënash cilësore e stokut të ndërtesave, të vlerësuara si të pambrojtura nga risqet e tërmeteve. Për shembull, për riskun e tërmetit është thelbësore të përcaktohet parametri i ekspozimit që në përgjithësi lidhet me grumbullimin e atributeve në vetitë strukturore të ndërtesave, për shpëtimin dhe evakuimin është thelbësore të dihet se në cilën ndërtesë duhet të hyni ose cilat janë rreziqet dhe si ti afrohesh (depërtim, mbështetje). Të dhënat e besueshme për dëmtimet e ndërtesave pas tërmetit janë thelbësore për të përcaktuar përforcimet tipike dhe të ngjashme.*

*Prioritetet kryesore të projektit janë si më poshtë:*

- *përditësimin dhe korrigjimin e bazës së të dhënave për stokun e ndërtesave informale të ndërtuara pa marrë parasysh risqet natyrore (tërmete, rrëshqitje toke, përmbytje) si dhe ndërtesa të tjera (jo banesore) të vlerësuara si të riskuara nga tërmetet;*
- *rivlerësim/vlerësim periodik i sigurisë sizmike të objekteve publike me rëndësi strategjike, si diga, shkolla, konvikte, spitale, objekte të trashëgimisë historiko-kulturore etj., në mënyrë që siguria e këtyre objekteve të garantohet për periudha më të gjata (në qindra vjet);*
- *rivlerësimi i sigurisë së digave (të mëdha) mbi 20 vjeçare, siguria e të cilave mund të jetë cenuar nga tërmeti i vitit 2019; kjo mund të përfshijë gjithashtu një rivlerësim të stokut të minierave të braktisura dhe të pa rehabilituara, të cenueshme nga aktivitetet sizmike;*
- *përditësimi i hartave sizmike, miratimi i hartave të zonave sizmike, rishikimi i kodeve teknike të projektimit në përputhje me standardet e BE-së.*

*Rezultati i pritshëm i projektit është krijimi i një baze të dhënash cilësore që përfshin atributet e kërkuara për të gjitha aktivitetet, ku është thelbësore që njerëzit me njohuri dhe përvojë në këtë fushë të punojnë mbi bazat (korrigjimi i të dhënave është problematik). Gjithashtu, baza e të dhënave duhet të lidhet me risqet dhe nevojat e tjera të shërbimeve të ndryshme në nivel vendor dhe shtetëror. Krijimi i bazës së të dhënave është një aktivitet shumë i gjerë që përfshin aktivitete specifike që lidhen me aspektet e ndërtimit, por edhe ndërlidhjen/harmonizimin me bazat e tjera të të dhënave (p.sh. të dhënat kadastrale të përfshira në Sistemin e Përbashkët të Informacionit të Regjistrimit dhe Kadastrës së Tokës dhe baza të ndryshme GIS, statistika...) Baza e të dhënave do të mundësojë adresimin sistematik të riskut si dhe një planifikim më të mirë të kapaciteteve institucionale dhe financiare si dhe minimizimin e kostove të ndërhyrjes.*
*AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me:*

| | |
|---|---|
| - *Projektin strategjik nr.7: "Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)";*<br>- *Projektin strategjik nr.20: "Përmirësimi i të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Menaxhimi i Informacionit të Riskut";*<br>- *Projektin strategjik nr.4 të tërmeteve: "Përgatitja e kodeve të reja të ndërtimit sipas Eurokodit dhe e shtojcave kombëtare (UNDP RESEAL)"* | |
| Afati kohor: | 2023 - 2027 |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Është krijuar një sistem për mbledhjen e të dhënave i cili përfshin analizën e bazave të të dhënave ekzistuese (kadastra, të dhënat nga procesi i legalizimit, arkivat), rregullimi i atributeve në vetitë e projektimit, modelimi i bazës së të dhënave (aplikacione, servera, cloud, etj.).<br>2. Janë përgatitur rekomandime për rinovimin e hartave sizmike, kodeve teknike të projektimit në përputhje me standardet e BE-së.<br>3. Kryerja e seminareve dhe trajnimeve (minimumi 3 në vit) të cilat përfshijnë dhe lidhin ekspertë të disponueshëm brenda sistemit (minimumi 100 ekspertë në të gjithë vendin).<br>4. Grumbullimi i atributeve të disponueshme për pasuritë e ndërtesa ndërtimore në qytetet kryesore të vendit ku rreziku i tërmeteve është i lartë. |
| Korniza financiare/burimi: | 7.875.000 EURO buxheti i shtetit, fondet e BE-së, donatorë të tjerë |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Ndërtimit dhe Instituti i Gjeoshkencave |
| Institucione kontribuuese | Projekti do të mbështetet nga UNDP RESEAL |
| Projekti strategjik 4: | *Përgatitja e kodeve të reja të ndërtimit sipas Eurokodit dhe e anekseve kombëtare (UNDP RESEAL)* |
| *Përshkrimi: Ky rezultat lidhet me asistencën teknike që do t'i jepet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për përditësimin e kodeve të ndërtimit (20-vjeçare) sipas Eurokodit si dhe anekseve kombëtare përkatëse. Raporti i PDNA 2020 thekson nevojën urgjente për përditësimin e kodeve shqiptare të ndërtimit, duke përfshirë formalizimin e integrimit të Eurokodit, dhe që rindërtimi të bazohet në parimin "rindërto më mirë" (BBB), me standarde të përditësuara dhe sipas kodeve të reja të ndërtimit*<br>*AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me Projektin strategjik nr. 3 të tërmeteve: "Baza e të dhënave të vetive strukturore të ndërtesave";* | |
| Afati kohor: | 2023 - 2024 |

| | |
|---|---|
| Aktivitetet kryesore: | 1. Përgatitja e anekseve kombëtare, me fokus në Paketën 2.1 (ndërtesë prej betoni të armuar).<br>2. Përditësimi i Udhëzimeve Kombëtare për zbatimin e Eurokodit në Shqipëri.<br>3. Përgatitja e 4 grupeve të udhëzuesve projektues.<br>4. Mbështetja e trajnimeve rajonale të inxhinierëve në bashkëpunim me MIE-në, AKMC dhe Prefekturat. |
| Korniza financiare/burimi: | 850,000 USD. UNDP RESEAL |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore |
| Institucione kontribuuese | Projekti do të mbështetet nga donatorë |
| Projekti strategjik 5: | *Ndërhyrje përforcuese dhe restauruese në objektet e trashëgimisë kulturore "Kalaja Krujës"* |
| *Përshkrimi: Projekti përfshin restaurimin e Kalasë së Krujës si dhe përforcimin e shpatit shkëmbor në të cilin ndodhet Kalaja. Projekti u hartua pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Shoqërisë Urbatrans (2020) për të kryer rilevimin gjeologjik dhe për të shkruar projektin e plotë. Projekti është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM).* | |
| Afati kohor: | 2023 - 2025 |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Restaurimi i Kalasë së Krujës<br>2. Stabilizimi i shpatit të pjesës verilindore të Kalasë së Krujës |
| Korniza financiare/burimi: | 6,600,000 EURO - Buxheti i BE/Kombëtar |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore |
| Institucione kontribuuese | Projekti do të mbështetet nga UNOPS |
| Projekti strategjik 6: | *Masat për rehabilitimin e objekteve të trashëgimisë kulturore* |

| | |
|---|---|
| *Përshkrimi: Projekti parashikon ruajtjen, restaurimin dhe rehabilitimin sipas parimit "Rindërto më Mirë" të:*<br>- *Muzeut Etnografik të Kavajës, monument kulture i kategorisë së parë,*<br>- *Teatrit të Kukullave, Tiranë, monument kulture i kategorisë së parë,*<br>- *Godina e Institucionit të të Përndjekurve Politikë, Tiranë, monument kulture i kategorisë së dytë,*<br>- *Ish-Ndërtesa e Kryepeshkopit Durrës, Delbnisht, Lezhë, monument kulture i kategorisë së dytë,*<br>*pasi u dëmtua nga tërmeti i 26 nëntorit 2019.*<br>*Faza e projektimit e financuar nga BE-ja ka përfunduar dhe aktualisht projektet janë në fazën e realizimit, të implementuar nga UNOPS në partneritet me Ministrinë e Kulturës në kuadër të programit EU4Culture. Projekti është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM).* | |
| Afati kohor: | 2022 - 2024 |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Projektim arkitektonik dhe strukturor.<br>2. Restaurimi, përforcimi strukturor dhe përmirësimi i instalimeve.<br>3. Hartimi i planit të menaxhimit dhe biznesit. |
| Korniza financiare/burimi: | 4,038,300 EURO - Buxheti i BE/Kombëtar |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore |
| Institucione kontribuuese | |
| Projekti strategjik 7: | *Ngritja e kapaciteteve për zbutjen e riskut sizmik në vendet e trashëgimisë kulturore nëpërmjet:*<br>- Trajnimit të mjeshtrave në fushën e restaurimit dhe transmetimit të njohurive mbi materialet dhe teknikat tradicionale në ndërtim;<br>- Përpilimit të manualeve dhe udhëzuesve për tipologjitë tradicionale të ndërtimit;<br>- Përmirësimit të normave teknike të projektimit në fushën e restaurimit. |
| *Përshkrimi:*<br>***Trajnimi i mjeshtrave në fushën e restaurimit dhe transmetimi i njohurive mbi materialet dhe teknikat tradicionale në ndërtim:*** *Parashikon vazhdimin e programit Aftësia për punësimin e së nesërmes (APN), me qëllim kryesor ruajtjen e mjeshtërive dhe teknikave tradicionale, kualifikimin e personave që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore, rritjen e cilësisë së punimeve (sipas standardeve bashkëkohore të restaurimit dhe konservimit) si dhe rritjen e mundësive të punësimit për mjeshtrit me përvojë, si dhe për praktikantët e rinj që do të kualifikohen në këtë fushë. Projekti synon të ruajë dhe të transmetojë njohuri mbi materialet dhe teknikat tradicionale në ndërtim, të cilat do të ndihmojnë gjithashtu në zbutjen e efekteve që risku i* | |

| | |
|---|---|
| *tërmetit mund të ketë në asetet kulturore. Projekti përfshin zhvillimin e moduleve (6-mujore brenda çdo viti) ku pritet të marrin pjesë rreth 40 pjesëmarrës/vit. Ky program u zbatua fillimisht në periudhën 2016-2019, nga fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Institutin e Monumenteve të Kulturës, MFE, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Berat, Gjirokastër dhe Korçë si dhe Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik në Gjirokastër, Korçë dhe Berat. Kurrikulumi për këtë program i hartuar në bashkëpunim me IKTK-në dhe me mbështetje teknike nga ekspertë vendas dhe të huaj është miratuar si pjesë e trajnimit profesional në Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik.*<br><br>***Përpilimi i manualeve dhe udhëzuesve për tipologjitë tradicionale të ndërtimit**: Udhëzuesi (rast studimor Qendrat Historike Berat dhe Gjirokastër, trashëgimi botërore) synon ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore materiale nëpërmjet studimit, njohjes dhe promovimit dhe ndërgjegjësimit të specialistëve dhe komunitetit për përdorimin e teknikave tradicionale të ndërtimit. Gjithashtu ai do të shërbejë për orientimin e të gjithë të interesuarve për ruajtjen, zhvillimin e qëndrueshëm dhe rehabilitimin e këtyre qendrave historike me qëllim zbutjen e risqeve të fatkeqësive. Ai do t'u drejtohet jo vetëm banorëve, por edhe pronarëve apo përdoruesve të ndërtesave, si dhe administratorëve, institucioneve, kompanive të ndërtimit, specialistëve dhe mjeshtërve të ndërtimit. Ky udhëzues do të përshkruajë aspektet historike, problemet ekzistuese dhe do të japë rekomandime praktike se si të kryhen punimet e mirëmbajtjes dhe restaurimit, si dhe riparimet dhe rindërtimet në këto qendra historike.*<br><br>***Përmirësimi i normave teknike të projektimit në fushën e restaurimit:** Synon të përmirësojë standardet e projektimit në restaurimin e pasurive kulturore. Përmirësimi i normave teknike do të synojë përfshirjen e normave teknike të sigurisë ndaj riskut sizmik dhe zjarrit si dhe efiçencës së energjisë.* | |
| Afati kohor: | 2024 - 2026 |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Trajnimi i mjeshtrave në fushën e restaurimit dhe transmetimi i njohurive mbi materialet dhe teknikat tradicionale në ndërtim.<br>1.1. Zhvillimi i Sesioneve Teorike për forcimin e njohurive mbi trashëgiminë kulturore (pjesë e modulit 6-mujor).<br>1.2. Sesione praktike ku njohuritë praktike do të forcohen në aplikim sipas specifikimeve të materialeve "gur", "punime druri", "llaç" (pjesë e modulit 6-mujor).<br>2. Përpilimi i manualeve dhe udhëzuesve për tipologjitë tradicionale të ndërtimit<br>2.1. Ndarja e ekspertizës ndërkombëtare (2 ekspertë) dhe kombëtare (3 ekspertë).<br>2.2. Punëtori në terren që përfshin profesionistë dhe studentë të arkitekturës.<br>2.3. Publikime.<br>3. Përmirësimi i normave teknike të projektimit në fushën e restaurimit.<br>3.1. Ekspertizë ndërkombëtare (2 ekspertë) dhe kombëtare (2 ekspertë)<br>3.2. Punë me grupet teknike të institucioneve të specializuara. |
| Korniza financiare/burimi: | - Trajnimit të mjeshtrave në fushën e restaurimit dhe transmetimi i njohurive mbi materialet dhe teknikat tradicionale në ndërtim: 450.000 EUR<br>- Përpilimi i manualeve dhe udhëzuesve për tipologjitë tradicionale të ndërtimit: 100.000 EUR<br>- Përmirësimi i normave teknike të projektimit në fushën e restaurimit: 200.000 EUR<br>Kosto totale: 750,000 EURO - BE/ Buxheti Kombëtar |

<table>
<tr><td>Institucioni përgjegjës:</td><td>Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Ministria e Mbrojtjes</td></tr>
<tr><td>Institucione kontribuuese</td><td>Drejtoria e Përgjithshme e MZSH</td></tr>
<tr><td>Projekti strategjik 8:</td><td>Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të Forcave Operacionale ndaj tërmeteve nëpërmjet krijimit të një moduli të Kërkim Shpëtimit të Rëndë Urban (HUSAR)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Përshkrimi: Krijimi i një moduli të Kërkim Shpëtimit të Rëndë Urban (HUSAR) kombëtar dhe ndërkombëtar sipas standardeve ndërkombëtare për t'iu bashkuar kapaciteteve të EERC. Zbatimi i këtij moduli kërkon procedurat kombëtare të nevojshme për miratimin dhe fillimin e komunikimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO.<br>AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me:<br>- Projektin strategjik nr.2: “Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së AKMC-së dhe forcave operacionale përmes krijimit të një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot“;<br>- Projektin strategjik nr.4: “Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri”;<br>- Projektin strategjik nr. 5 të zjarreve në pyje: “Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj zjarreve në pyje përmes modulit "Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje" të BE-së”;<br>- Projektin strategjik nr.8 të përmbytjeve: “Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj përmbytjeve duke plotësuar modulet ekzistuese FRB dhe FC të BE-së për përmbytjet”;</td></tr>
<tr><td>Afati kohor:</td><td>2023-2025</td></tr>
<tr><td>Aktivitetet kryesore:</td><td>1. Studimi për krijimin e një moduli të ri HUSAR.<br>2. Kryerja e të gjitha procedurave të nevojshme kombëtare të nevojshme për miratimin dhe fillimin e komunikimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO.<br>3. Kryerja e aktiviteteve të nevojshme të komunikimit dhe koordinimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO si komunikimi me Grupin Këshillimor Ndërkombëtar të Kërkimit dhe Shpëtimit (INSARAG).<br>4. Kryerja, në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe DG ECHO, të aktiviteteve trajnuese si dhe stërvitjes përfundimtare në prani të autoriteteve të Komisionit Evropian.<br>5. Kryerja e procesit të certifikimit të modulit si dhe regjistrimit të tij në EERC<br>6. Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për ngritjen e modulit si dhe pagesat e tjera vjetore të funksionimit dhe operimit të tij.</td></tr>
<tr><td>Korniza financiare/burimi:</td><td>Kostot përfshijnë: trajnim; Vaksinim: Amortizimi i pajisjeve; Mirëmbajtja dhe ruajtja e pajisjeve, materialeve të konsumueshme dhe automjeteve; Licencat: ushtrime; kostot e vendosjes etj.<br>Përafërsisht shpenzimet e dislokimit duke marrë maksimumin i cili mund të jetë nga toka ose ajri mund të jenë: 540,620 euro;</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | Kostot e mirëmbajtjes: 140,689 euro<br>Zhvillimi ose krijimi i modulit: 602,787 euro<br>1,284,096 EURO BE/OKB/buxheti i shtetit |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Instituti i Ndërtimit dhe donatorë |
| Projekti strategjik 9: | Hartimi i rregulloreve e dokumenteve teknike për vlerësimin dhe riaftësimin strukturor të veprave ndërtimore |
| *Përshkrimi: Tërmeti i datës 26.11.2019 nxori në pah një sërë të metash dhe nevojash për rritjen e aftësisë ripërtëritëse të ndërtesave ekzistuese dhe në veçanti të infrastrukturës publike dhe asaj kritike. Krahas tyre tërmeti nxori në pah edhe një nevojë urgjente për masa jostrukturore që konsistojnë në përmirësimin e bazës ligjore por edhe në zhvillimin e trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të inxhinierëve* | |
| Afati kohor: | 2023-2025 |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Përditësimi i kornizës ligjore për vlerësimin dhe riaftësimin e veprave ekzistuese.<br>2. Hartimi i udhëzueseve të përdorimit për vlerësimin dhe riaftësimin e veprave ekzistuese.<br>3. Përgatitja dhe përhapja e materialeve trajnuese në grupet e interesit |
| Korniza financiare/burimi: | 2,500,000 EURO BE/OKB/buxheti i shtetit |

## 3. Përmbytjet , vërshimet e ujit dhe çarjet e digave

Tabela 7. Projektet e lidhura me përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |

| | |
|---|---|
| Institucione kontribuuese | Bashkitë |
| Projekti strategjik 1: | *Rritja e sigurisë së mbrojtjes nga përmbytjet e lumenjve, nëpërmjet rehabilitimit/rindërtimit të argjinaturave ekzistuese dhe ndërtimit të strukturave të reja* |
| *Përshkrimi: Nëpërmjet këtij projekti strategjik, referuar frekuencës në rritje të përmbytjeve në vendin tonë dhe efekteve në pritshmërinë e ndryshimeve klimatike, synohet të vlerësohet situata e sigurisë së punimeve ekzistuese të mbrojtjes nga përmbytjet dhe të vendoset një standard më i lartë sigurie për punimet ekzistuese dhe ato të reja që duhet të ndërtohen, sipas dispozitave të Direktivës së Bashkimit Evropian për vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve nga përmbytjet (Direktiva e BE-së 2007/60 / EC ; Direktiva e Përmbytjeve - FD). Ndërsa minimizimi i përmbytjeve me standard më të lartë sigurie do të realizohet nëpërmjet rehabilitimit/rikonstruksionit të argjinaturave ekzistuese dhe ndërtimit të strukturave të reja të mbrojtjes nga përmbytjet dhe erozioni të brigjeve të lumenjve.*<br><br>*AKMC dhe MBZHR të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me Projektin strategjik nr.9 të përmbytjeve: "Përmirësimi i Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet";* | |
| Afati kohor: | *2019-2031* |
| Aktivitetet kryesore: | *1. Kryerja e studimeve të fizibilitetit për të përmirësuar mbrojtjen nga përmbytjet*<br>*1.1. Aktualisht është kryer studimi i fizibilitetit të lumenjve Mat dhe lumenjve Drin e Bunë.*<br>*1.2. Është në proces studimi i fizibilitetit për lumenjtë Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë, i cili pritet të përfundojë në vitin 2023.*<br>*2. Kryerja e projekteve të zbatimit*<br>*2.1. Aktualisht është duke u zhvilluar projekti i plotë i zbatimit për lumin Mat*<br>*3. Programimi buxhetor për ndërhyrjet strukturore në punimet e mbrojtjes nga përmbytjet*<br>*4. Rehabilitimi/Rikonstruksioni dhe ndërtimi i argjinaturave kundër përmbytjeve dhe strukturave mbrojtëse nga erozioni*<br>*5. Rritja e kapaciteteve operacionale, mirëmbajtjes dhe monitoruese të sigurisë së argjinaturave në strukturat përkatëse të MBZHR dhe Bashkive* |
| Korniza financiare/burimi: | 276.8 milionë USD me burim buxhetin e shtetit me investime të brendshme dhe të huaja |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| Institucione kontribuuese | Bashkitë përkatëse dhe Institucionet e Prefektit të qarkut |

| | |
|---|---|
| Projekti strategjik 2: | *Rritja e sigurisë së digave të rezervuarëve të ujitjes, nëpërmjet rehabilitimit/rindërtimit të digave ekzistuese* |
| *Përshkrimi: Nëpërmjet këtij projekti strategjik, referuar kontekstit aktual, ku rezulton se 626 diga janë në gjendje të vështirë teknike, pasi rreth 65% e tyre kanë probleme të ndryshme teknike (kryesisht në trupin e digës, shkarkuesin katastrofik, ujëlëshuesin etj. ) dhe ndërhyrjet rehabilituese në vazhdimësi në një pjesë të konsiderueshme janë një domosdoshmëri imediate, synohet rritja e sigurisë së digave sipas standardeve shqiptare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e zonave të banuara në pjesën e poshtme të digave dhe garantimin e burimeve ujore për ujitje, pasi në vetvete edhe thatësira është një risk për bujqësinë dhe sigurinë e prodhimit bujqësor. Projekti përfshin analizimin e gjendjes së çdo dige, përcaktimin e përdorimit të saj për periudhën në vijim, prioritizimin e ndërhyrjeve sipas shkallës së riskut dhe kryerjen e ndërhyrjeve strukturore përkatëse në trupin e digave. Projekti ka gjithashtu një komponent të rëndësishëm të ndërtimit të kapaciteteve teknike të bashkive për të monitoruar sigurinë e digave.* | |
| Afati kohor: | *2019-2031* |
| Aktivitetet kryesore: | *1. Kryerja e studimit të fizibilitetit të 626 digave*<br>*1.1. Aktualisht përmes projektit të Bankës Botërore është kryer studimi i parafizibilitetit për 195 diga dhe ndërkohë në kuadër të fondeve të granteve të WBIF dhe BE-së, pritet të kryhet parafizibiliteti për 431 diga të tjera deri në fund të vitit 2024.*<br>*2. Kryerja e një studimi fizibiliteti*<br>*2.1. Me përfundimin e para fizibilitetit bazuar në analizën shumë-kritere do të prioritizohen digat që do të kalojnë në studimin e fizibilitetit.*<br>*3. Kryerja e projekteve të zbatimit për grupin prioritar të digave*<br>*4. Programimi buxhetor për ndërhyrjet strukturore në diga*<br>*5. Rehabilitimi/Rikonstruksioni i digave ekzistuese sipas prioritetit të përcaktuar*<br>*6. Ngritja/Konsolidimi dhe trajnimi i Grupeve të Sigurisë së Digave për çdo bashki.*<br>*7. Koordinimi i aktiviteteve për sigurinë e digave ndërmjet MBZHR-Bashkive-Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha* |
| Korniza financiare/burimi: | 171 milionë USD me burim buxhetin e shtetit me investime të brendshme dhe të huaja |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Instituti i Gjeoshkencave |
| Institucione kontribuuese | |
| Projekti strategjik 3: | *Vlerësimi i riskut nga përmbytjet dhe paralajmërimi i hershëm* |

| | |
|---|---|
| *Përshkrimi: Nëpërmjet këtyre projekteve synohet vlerësimi i riskut nga përmbytjet dhe paralajmërimi i hershëm i tyre sipas Direktivës 2007/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23.10.2007, "Për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të përmbytjeve" dhe Ligjit 45/2019. Nëpërmjet këtij projekti synohet të realizohen modele të cilat parashikojnë dhe bëjnë të mundur paralajmërimin e hershëm të përmbytjeve në lumin Vjosa.*<br><br>AKMC dhe IGJEO të sigurojnë komplementaritetin dhe sinergjinë me Projektin strategjik nr.11: "Alb-Adapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse" | |
| Afati kohor: | *2022-2031* |
| Aktivitetet kryesore: | *1.Analiza Hidrologjike dhe Hidraulike*<br>*1.1. monitorimi i prurjeve, reshjeve, temperaturave, avullimit në territorin e Shqipërisë.*<br>*1.2. analiza e hidrologjike e prurjeve në lumenj*<br>*1.3. analiza hidraulike e përhapjes së plotave në lumenj.*<br>*2. Parashikimi i motit me një hapësire kohore 10 ditore*<br>*2.1. Anëtarësimi në Qendrën Evropiane për Parashikimin e Motit me interval mesatar ECMWF (European Centre for Medium-Range Weather Forecasts)*<br>*3. Parashikimi i Përmbytjeve në lumin Vjosa*<br>*3.1. Ndërtimi i një modeli hidrologjik për parashikimin e përmbytjeve.* |
| Korniza financiare/burimi: | 1.2 milion euro |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Instituti i Gjeoshkencave dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| Institucione kontribuuese | |
| Projekti strategjik 4: | *Vlerësimi i riskut nga thatësira* |
| *Përshkrimi: Një fenomen që po vjen gjithnjë dhe në rritje janë dhe thatësirat, të cilat lidhen drejtpërdrejt dhe me menaxhimin e integruar të burimeve ujore, sipas ligjit 111/2012.*<br>*Nëpërmjet këtij projekti synohet të ndërtohet një model i bilancit ujor i cili do të kryejë një analizë për optimizimin e shfrytëzimit të burimeve ujore.*<br>AKMC dhe IGJEO të sigurojnë komplementaritetin dhe sinergjinë me Projektin strategjik nr.11: "Alb-Adapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse" | |

| | |
|---|---|
| Afati kohor: | *2022-2031* |
| Aktivitetet kryesore: | *1. Ndërtimi i një modeli për analizën e bilancit ujor në lumin Seman*<br>*1.1. Nëpërmjet këtij projekt synohet ndërtimi i një modeli që do të bëjë një analizë të detajuar të kapacitetit dhe shfrytëzimit të ujit në basen. Gjithashtu do të jetë e mundur të menaxhohet sasia e ujit për të shmangur ose minimizuar thatësirat.*<br>*2. Analiza e transportit të sedimentit në lumin Seman*<br>*2.1. Nëpërmjet këtij projekti synohet vlerësimi i sedimenteve që transporton lumi Seman. Ndërtimi i një modeli i cili i analizon ato në varësi të reshjeve, llojit të terrenit, përdorimit të tokës, etj.* |
| Korniza financiare/burimi: | 500,000 euro |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore |
| Institucione kontribuuese | |
| Projekti strategjik 5: | *Zbutja, zvogëlimi i pasojave të mundshme negative të përmbytjeve* |
| *Përshkrimi: Nëpërmjet këtij projekti strategjik, referuar historisë dhe frekuencës në rritje të përmbytjeve në vendin tonë dhe efekteve në pritshmërinë e ndryshimeve klimatike, synohet zbutja, zvogëlimi i pasojave të mundshme negative të përmbytjeve.*<br>*AKMC, MBZHR dhe AMBU duhet të sigurojnë komplementaritetin dhe sinergjinë me:*<br>- *Projektin strategjik nr.2 të zjarreve në pyje: "Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shërbimeve homologe të rajonit të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi)"* | |
| Afati kohor: | *2021-2024* |
| Aktivitetet kryesore: | *Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet për basenet ujore: Vjosë, Seman, Shkumbin, Ishëm dhe Erzen;*<br>*Aktualisht:*<br>- *Ka përfunduar drafti përfundimtar i Planit të Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet për qarkun e Shkodrës (Baseni i Drinit). Parashikuar të miratohet në fund të vitit 2022;*<br>- *Janë hartuar raportet e vlerësimit paraprak dhe hartat e rrezikut nga përmbytjet për basenet e Ishmit, Erzenit, Shkumbinit, Semanit dhe Vjosës.*<br>- *Janë në proces Hartat e dëmeve dhe dokumenti i Planeve të Menaxhimit të Riskut të Përmbytjeve për këto basene ujore. Parashikuar të përfundojë në vitin 2023.* |

| | |
|---|---|
| Korniza financiare/burimi: | 2,000,000 EUR Buxheti i shtetit me investime të brendshme dhe të huaja |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore |
| Institucione kontribuuese | Projekti do të mbështetet nga UNDP |
| Projekti strategjik 6: | *Menaxhimi i integruar ndërkufitar i riskut nga përmbytjet në basenin e lumit Drin* |
| *Përshkrimi: Nëpërmjet këtij projekti strategjik, referuar historisë dhe frekuencës në rritje të përmbytjeve në vendin tonë dhe efekteve në pritshmërinë e ndryshimeve klimatike, synohet të menaxhohen njohuritë mbi risqet e rreziqeve; ndërtimi i një kuadri institucional ndërkufitar dhe politikave të menaxhimit të riskut nga përmbytjet; hartimin e masave për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike në dobi të komunitetit.* | |
| Afati kohor: | *2019 - 2024* |
| Aktivitetet kryesore: | *1. Rishikimi i procedurave të mbledhjes së të dhënave dhe cilësisë së tyre;*<br>*2. Vlerësimi i kërkesave të rrjetit monitorues për menaxhimin strategjik të rrezikut nga përmbytjet;*<br>*3. Vlerësimi i kapaciteteve institucionale për monitorimin e rrjetit hidrometrik;*<br>*4. Plani operacional për procedurat e raportimit;*<br>*5. Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve përkatëse për zhvillimin e një plani afatgjatë të zhvillimit të kapaciteteve dhe nevojave për trajnim.*<br>6. *Përpilimi i një listë opsionesh për të identifikuar më ekonomikisht të favorshme për basenin.* |
| Korniza financiare/burimi: | 642,430 USD (UNDP) |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore |

| | |
|---|---|
| Institucione kontribuuese | Projekti do të mbështetet nga Qeveria Turke |
| Projekti strategjik 7: | *Rritja e sigurisë së objekteve të trashëgimisë kulturore ndaj riskut të përmbytjeve - "Restaurimi dhe ndërtimi i sistemit të mbrojtjes nga përmbytjet të Xhamisë së Plumbit (Mehmet Pashë Bushatlliu) në Shkodër"* |
| *Përshkrimi: Projekti parashikon realizimin e punimeve për restaurimin e Xhamisë së Plumbit në Shkodër si dhe ndërtimin e një sistemi mbrojtjeje nga përmbytjet. Ndërhyrjet parashikojnë ndërtimin e një muri të vazhdueshëm me pilota. Hartimi i projektit si dhe realizimi i punimeve do të financohen nga Republika e Turqisë, Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve, bazuar në Protokollin e Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Turqisë në vitin 2020. Ka përfunduar procesit i hartimit të projektit të financuar nga TIKA dhe projekti është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) dhe Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT).* | |
| Afati kohor: | *2023 - 2024* |
| Aktivitetet kryesore: | *1. Restaurimi i Xhamisë së Plumbit*<br>*2. Ndërtimi i sistemit të pilotave për mbrojtjen nga përmbytjet* |
| Korniza financiare/burimi: | 4,000,000 EUR - Qeveria e Turqisë / Buxheti Kombëtar |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit |
| Projekti strategjik 8: | *Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj përmbytjeve duke plotësuar modulet ekzistuese FRB dhe FC të BE-së për përmbytjet* |
| *Përshkrimi: Forcimi i kapaciteteve do të realizohet duke plotësuar dy nga tre modulet ekzistuese të BE-së për përmbytjet. Studimi i këtij projekti do të jetë mbi 1/3 e moduleve kombëtare dhe ndërkombëtare të FRB dhe FC të krijuara nëpërmjet programit IPA Floods, si dhe kompletimi i tyre në module të plota që do t'i bashkohen EERC.*<br>AKMC duhet të sigurojnë komplementaritetin dhe sinergjinë me:<br>- Projektin strategjik nr.2: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së AKMC-së dhe forcave operacionale përmes krijimit të një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot"; | |

| | |
|---|---|
| - Projektin strategjik nr.4: “Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri”;<br>- Projektin strategjik nr.8 të tërmeteve: “Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të Forcave Operacionale ndaj tërmeteve nëpërmjet krijimit të një moduli të Kërkim Shpëtimit të Rëndë Urban (HUSAR)”;<br>- Projektin strategjik nr.5 të zjarreve Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj zjarreve në pyje përmes modulit ''Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje'' të BE-së. | |
| Afati kohor: | *2023 – 2026* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Kryerja e një studimi mbi situatën aktuale të 1/3 moduleve kombëtare dhe ndërkombëtare të krijuara përmes programit IPA Floods si më poshtë:*<br>*1.1. “Shpëtimi nga përmbytjet me varka”/ (Flood Rescue with Boats/FRB)*<br>*1.2. Mbrojtja nga Përmbytjet /* (*Flood Containment/ FC)*<br>2. *Kryerja e të gjitha procedurave të nevojshme kombëtare të kërkuara për miratimin dhe fillimin e komunikimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO*<br>3. *Kryerja e aktiviteteve të nevojshme të komunikimit dhe koordinimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO*<br>4. *Kryerja, në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe DG ECHO, të aktiviteteve të trajnimit dhe të stërvitjes përfundimtare në prani të autoriteteve të Komisionit Evropian*<br>5. *Kryerja e procesit të certifikimit të moduleve të plota FRB dhe FC si dhe regjistrimi i tyre në EERC*<br>6. *Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për ngritjen e moduleve si pagesat e tjera vjetore të funksionimit dhe operimit të tij* |
| Korniza financiare/burimi: | FRB<br>- Zhvillimi: 983,200 EURO<br>- Mirëmbajtja: 554,550 EURO<br>- Dislokimi: 203,000 EURO<br>TOTALI FRB = 1,740,750 EURO<br>FC:<br>- Zhvillimi: 116,356 EURO<br>- Mirëmbajtja: 554,550 EURO<br>- Dislokimi: 203,000 EURO<br>Totali FC = 873,906 EURO<br>Kosto totale FRB dhe FC = 2,614,656 euro |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| Institucione kontribuuese | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Projekti do të mbështetet nga Banka Botërore |
| Projekti strategjik 9: | *Përmirësimi i Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet* |
| *Përshkrimi: Disa partnerë zhvillimi po mbështesin Shqipërinë për të zhvilluar plane për menaxhimin e riskut nga përmbytjet për shtatë basenet ujorë kryesorë të saj. Në përputhje me Direktivën e BE-së për përmbytjet, planet rezultante (të pritshme deri në vitin 2024) duhet të përfshijnë plane investimi që fokusohen në parandalimin, mbrojtjen dhe gatishmërinë nga përmbytjet. Me synimin për t'u dhënë lumenjve më shumë hapësirë, ata duhet të marrin në konsideratë ku është e mundur mirëmbajtjen dhe/ose restaurimin e zonave të përmbytura, si dhe masat për të parandaluar dhe zvogëluar dëmin ndaj shëndetit të njerëzve, mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe aktivitetit ekonomik. Pritet që nevojat e identifikuara për investime të jenë rreth qindra miliona USD.* | |
| Afati kohor: | *2024 – 2027* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Studimet e fizibilitetit dhe projektimi i mbrojtjes strukturore dhe jostrukturore nga përmbytjet, me prioritet zgjidhjet e bazuara në natyrë*<br>2. *Punime ndërtimi/rehabilitimi*<br>3. *Planifikimi i mirëmbajtjes dhe prokurimi i pajisjeve të nevojshme*<br>4. *Trajnime* |
| Korniza financiare/burimi: | 20$ milion - 40$ milion (me gjasa më e lartë) |

## 4. Rrëshqitjet e tokës, reshjet e  dëborës dhe ortekët

Tabela 8. Projektet e lidhura me rrëshqitjet e tokës, rënien e  dëborës dhe ortekët

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Kulturës - Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, |
| Institucione kontribuuese | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Projekti do të mbështetet nga Banka Botërore, |

| | |
|---|---|
| Projekti strategjik 1: | *Masa përforcuese në objektet e trashëgimisë kulturore - Menaxhimi i sitit, Plan Interpretimi, projektimi dhe mbikëqyrja e punimeve në Kalanë e Kaninës, Kalanë e Borshit dhe Shpellën e Spilesë, Himarë. Ndërhyrje strukturore për përforcimin e shpateve shkëmbore të Kalasë së Borshit dhe Kalasë së Kaninës.* |
| *Përshkrimi: Projekti "Menaxhimi i sitit, Plani i Interpretimit, Projektimi dhe Mbikëqyrja e Punimeve në Kalanë e Kaninës, Kalanë e Borshit dhe Shpellën e Spilesë, Himarë. Ndërhyrja strukturore për përforcimin e shpateve shkëmbore të Kalasë së Borshit dhe Kalasë së Kaninës" është pjesë e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turistik (PZhIUT) financuar nga Banka Botërore dhe zbatuar nga FSHZH. Aktualisht, termat e referencës për projektin janë hartuar nga FSHZH.* | |
| Afati kohor: | *2023 - 2025* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Projektim/mbikëqyrje punimesh*<br>2. *Punimet restauruese dhe interpretimi i Kalasë së Kaninës, Kalasë së Borshit, Shpellës së Spilesë*<br>3. *Përforcimi i shpatit shkëmbor të kalasë së Kaninës*<br>4. *Përforcimi i shpatit shkëmbor të kalasë së Borshit* |
| Korniza financiare/burimi: | 2,800,000 dollarë - Banka Botërore/ Buxheti kombëtar |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar |
| Institucione kontribuuese | |
| Projekti strategjik 2: | *Identifikimi i rrëshqitjeve të tokës në të gjithë territorin e vendit, bazuar në kritere të standardizuara dhe pasqyrimi i tyre në një hartë të vetme, si dhe krijimi i një inventari kombëtar për rrëshqitjet, i cili përmban të gjitha të dhënat e tyre. Monitorimi i rrëshqitjeve më të fuqishme dhe më të rrezikshme për komunitetin* |
| *Përshkrimi: Territori i Republikës së Shqipërisë, duke qenë një tokë relativisht e re, ka një konfigurim të larmishëm dhe si i tillë është i ekspozuar ndaj dukurive gjeodinamike. Këto dukuri mund të rrezikojnë qendra të banuara, objekte të veçanta inxhinierike apo edhe vepra të ndryshme inxhinierike të kudo-gjendura.*<br><br>*Këto dukuri apo fenomene mund të jenë natyrore të shkaktuara nga faktorë të ndryshëm gjeologjikë, por mund të shkaktohen edhe nga veprimtaria praktike e njeriut. Në të dyja rastet, ato përbëjnë një rrezik gjeologjik për ekzistencën dhe shfrytëzimin normal dhe efektiv të mjedisit natyror gjeologjik dhe, për rrjedhojë, për përdorimin kompleks të plotë dhe racional të të gjitha objekteve inxhinierike të ndërtuara në fusha të ndryshme të ekonomisë së vendit. Ndër* | |

*dukuritë natyrore me rrezikshmëri të madhe janë rrëshqitjet e tokës (të cilat janë shumë të përhapura në Shqipëri), me pasoja të rënda për jetën e njerëzve. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, në lidhje me dukuritë negative gjeodinamike, zotëron një bazë të fuqishme të dhënash duke kryer një numër të madh studimesh me produktet përfundimtare:*

- *Harta gjeologo-inxhinierike e Shqipërisë në shkallën 1: 200,000*
- *Harta e rrezikut gjeologjik të Shqipërisë në shkallën 1: 200,000*
- *Harta e ndjeshmërisë ndaj rrëshqitjes së tokës në Shqipëri në shkallën 1: 200,000*
- *Harta e përshtatshmërisë ndërtuese të trojeve në shkallën 1: 100,000*
- *Hartat e rrezikut gjeologjik në shkallën 1: 100,000*
- *Hartat gjeologo-inxhinierike në shkallën 1: 100,000*
- *Harta e përshtatshmërisë ndërtuese të trojeve në shkallën 1: 50 000*
- *Hartat e rrezikut gjeologjik në shkallën 1: 50,000*
- *Hartat gjeologjiko-inxhinierike në shkallën 1: 50,000*
- *Hartat e rrezikut gjeologjik në shkallën 1: 25,000*
- *Hartat gjeologo-inxhinierike në shkallën 1: 25,000*

*Pavarësisht sa thamë më sipër, ka ende punë për të bërë në këtë drejtim, si në perfeksionimin e produkteve të nxjerra deri tani, ashtu edhe në avancimin e mëtejshëm, për përcaktimin dhe evidentimin e dukurive gjeodinamike, regjistrimin e tyre dhe monitorimin e atyre me rrezikshmëri të madhe për komunitetin. Kjo do të parandalonte pasoja të rënda, veçanërisht në jetën e njeriut.*

*Pra, me fjalë të tjera, projekti do të kontribuonte në synimin strategjik për zvogëlimin e riskut nga rrëshqitjet e tokës nëpërmjet identifikimit të tyre, mbledhjes së të dhënave dhe në fund marrjen e masave për parandalimin dhe zbutjen e riskut të fatkeqësive natyrore nga ky fenomen.*

*Rezultati i projektit do të ishte zhvillimi dhe harmonizimi i marrjes së të dhënave dhe njëkohësisht metodologjia e vlerësimit të riskut të rrëshqitjes së tokës në të gjitha nivelet bazë për aktivitetet e ardhshme ciklike të vlerësimit të riskut. Vlerësimet e riskut të rrëshqitjes së tokës janë baza për harmonizimin e planeve strategjike të zhvillimit urban të të gjitha njësive territoriale përgjegjëse për përgjigjen dhe përmirësimin e situatës ekzistuese si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.*

*AKMC në koordinim me MIE dhe SHGJSH duhet të sigurojnë komplementaritetin dhe sinergjinë e projektit me:*

- *Projektin strategjik nr.5: "Politikat dhe legjislacioni";*
- *Projektin strategjik nr.7: "Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)";*
- *Projektin strategjik nr.20: "Përmirësimi i të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Menaxhimi i Informacionit të Riskut";*
- *Projektin strategjik nr.22: "Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të zjarrfikësve, sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe mjete"*

| | |
|---|---|
| Afati kohor: | *2022 – Në vazhdim* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Është përgatitur baza e nevojshme për identifikimin dhe vlerësimin modern të riskut nga dukuritë negative gjeodinamike, e cila përfshin një pasqyrë të situatës në vend dhe shërben për strategjinë e ardhshme të perfeksionimit si të performancës aktuale, ashtu edhe të vazhdimësisë.*<br>2. *Përgatitja e propozimeve për ndryshime në legjislacion dhe përgatitja e rregulloreve, të cilat përfshijnë zbatimin e këtyre studimeve në planifikimin urban në të gjithë territorin e Republikës.* |
| Korniza financiare/burimi: | 100,000 EURO BE / OKB / Buxheti kombëtar |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar |
| Institucione kontribuuese | |
| Projekti strategjik 3: | *Rajonizimi gjeologo-inxhinierik në shkallën 1: 10 000, për planifikimin urban në zonat më të populluara të vendit, si dhe në zonat me premisë për zhvillime turistike.* |
| *Përshkrimi: Në dekadat e fundit, kemi qenë dëshmitarë të rritjes së dëmeve në përgjithësi të veprave të ndryshme inxhinierike (përfshi ndërtesa private dhe publike, monumente kulture, ura, diga, rrjete rrugore, hekurudha, rrjete elektrike etj.), si rezultat i proceseve dhe dukurive fiziko- gjeologjike negative. Kjo ka bërë që të rritet niveli i riskut gjeologjik, si për shkak të rritjes së elementëve të rrezikuar (objekte inxhinierike apo punime infrastrukturore), ashtu edhe për shkak të tolerancës së shoqërisë ndaj dëmtimeve (objekte inxhinierike dhe kryesisht jetë njerëzish). Në këto kushte, ndër të tjera, lind nevoja për kryerjen e studimeve gjeologo-inxhinierike në shkallë të ndryshme, për planifikimin urban në zonat më të populluara të vendit, si dhe në zona me pritshmëri për zhvillime turistike". Kjo do t'i lejonte ata të identifikonin zonat problematike në të gjithë territorin, veçanërisht në zonat më të populluara të vendit si dhe në zonat e prirura për zhvillimin e turizmit dhe mbi bazën e këtyre studimeve, strukturat e qeverisjes vendore që administrojnë territorin, planifikojnë zonat e zhvillimit urban në qendrat më të populluara si dhe në ato me premisa për zhvillime turistike.<br>Pra, rezultati i këtij projekti do të ishte përcaktimi i zonave me risk gjeologjik dhe orientimi i zhvillimeve urbane në zona të qëndrueshme, si në kapacitetin mbajtës të tokës ashtu edhe në riskun gjeologjik.* | |
| Afati kohor: | *2022 – Në vazhdim* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Është gati baza e nevojshme e studimeve të kryera më parë nga ShGjSh, të cilat do të shërbenin si bazë për realizimin e këtyre rajonizimeve gjeologo-inxhinierike. Mbetet organizimi dhe grumbullimi i të dhënave në terren nëpërmjet rilevimeve në shkallët përkatëse për të hartuar hartat përkatëse të rajonizimit në shkallën e planifikuar.* |

| | |
|---|---|
| | 2. *Hartimi i propozimeve për ndryshime legjislative dhe parapërgatitja e rregulloreve, të cilat përfshijnë zbatimin e këtyre studimeve në planifikimet urbane në të gjithë territorin e vendit.* |
| Korniza financiare/burimi: | 150,000 EURO BE / OKB / Buxheti kombëtar |

## 5. Zjarret në Pyje

Tabela 9. Projektet e lidhura me zjarret në pyje

| **Rreziku** | Përmbytjet dhe zjarret në pyje |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | Strukturat e MZSH-së në nivel qendror dhe vendor |
| Projekti strategjik 1 | Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shërbimeve homologe të rajonit të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi) |
| *Përshkrimi: Programi 3-vjeçar IPA "Floods and Fires" i financuar nga BE synon përmirësimin e kapaciteteve për menaxhimin e riskut nga përmbytjet dhe nga zjarri në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë*, Mali i Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Turqi. Programi është i strukturuar në dy komponentë përkatësisht për përmbytjet dhe zjarret pyjore. Duke nxitur bashkëpunimin rajonal dhe shkëmbimin e praktikave të mira, IPA "përmbytjet dhe zjarret" bashkëpunon me autoritetet lokale të mbrojtjes civile dhe agjencitë dhe institucionet e tjera përkatëse lokale për të përmirësuar kornizën ligjore dhe institucionale në lidhje me Direktivën e Përmbytjes së BE -së, dhe Koordinimin institucional midis të gjithë aktorëve të përfshirë në zbatimin e EUFD dhe për të përmirësuar parandalimin, gatishmërinë dhe aftësinë për t'iu përgjigjur zjarreve pyjore në nivelin qendror, rajonal dhe BE.*<br><br>*AKMC duhet të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë e projektit me:*<br>- *Projektin strategjik nr.6: "Zhvillimi i Procedurave Standarde Operacionale prioritare të sistemit të MC (UNDP RESEAL)";*<br>- *Projektin strategjik nr.5 të zjarreve në pyje: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj zjarreve në pyje përmes modulit "Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje" të BE-së".*<br>- *Projektit strategjik nr.10: "JICA - Ngritja dhe forcimi i sistemit të paralajmërimit dhe njoftimit të hershëm për zjarret në pyje";* | |

| | |
|---|---|
| - *Projekti strategjik nr.11: "ALBAdapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse""*<br>- *Projekti strategjik nr.6 të përmbytjeve: "Menaxhimi i integruar ndërkufitar i riskut nga përmbytjet në basenin e lumit Drin"* | |
| Afati kohor: | 2023-2026 |
| Aktivitetet kryesore: | Komponenti 1: Përmbytjet<br>Hartimi i një Udhëzuesi për Planin e Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet (FRMP) në përputhje me masat e renditura në Udhëzimin për zbatimin e Direktivës së Përmbytjes së BE-së.<br>Vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese për planet e menaxhimit të riskut nga përmbytja / FRMP-të dhe planet e menaxhimit të baseneve lumore (RBMP).<br>1.1 Ndërtimi i kapaciteteve për planet e menaxhimit të riskut nga përmbytja (FRMP) bazuar në praktikat e mira të Shteteve Anëtare të BE-së dhe Direktivën e Përmbytjes së Bashkimit Evropian (EUFD).<br>1.2 Ndërtimi i kapaciteteve për zhvillimin e planeve të përbashkëta ndërkufitare.të menaxhimit të riskut nga përmbytja (FRMP)<br>1.3 Zhvillimi i procedurave dhe marrëveshjeve për përfshirjen rishtas të sistemeve të paralajmërimit të hershëm në planet lokale/qendrore të përgjigjes ndaj emergjencave (ERP).<br>1.4 Harmonizimi i Planit të Menaxhimit të Riskut të Përmbytjes (FRMP) me Planin e Menaxhimit të Basenit Lumor (RBMP).<br>1.5 Hartimi i procedurave specifike për zhvillimin e FRMP dhe harmonizimin me RBMP.<br>Komponenti 2: Zjarret në pyje<br>2.1 Sigurimi i mbështetjes teknike për zhvillimin e Vlerësimeve të Riskut nga Zjarri në Pyje (FFRA) dhe aftësive të menaxhimit të riskut nga zjarri në pyje.<br>2.2 Ngritja, Pajisja, Trajnimi  i Moduleve të Mbrojtjes Civile të Shuarjes së zjarrit nga toka (GFFF) në përputhje me Vendimin e Komisionit për Modulet e Mbrojtjes Civile të BE-së.<br>2.3 Krijimi i protokolleve të Kalimit Kufitar (BC) dhe Mbështetjes së Vendit Pritës (HNS) në përputhje me Udhëzimet e BE-së për Mbështetjen e Vendit Pritës (HNS).<br>2.4 Organizimi i ushtrimeve rajonale në tavolinë (TTX) dhe një stërvitjeje fushore (FX) për modulet GFFF. |
| Korniza financiare/burimi: | 1,000,000 EURO |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Instituti i Gjeoshkencave |
| Institucione kontribuuese | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e MZSH |

| Projekti strategjik 2: | Përmirësimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga zjarri në territor |
|---|---|
| *Përshkrimi: Nisur nga qëllimi strategjik i zvogëlimit të riskut nga zjarret masive në pyje, dhe varësia e tij nga të dhënat e sakta, është i nevojshëm përditësimi i të dhënave aktuale për gjendjen e territorit, cenueshmëria e tij ndaj zjarreve, përditësimi i hartës së rrezikut dhe krijimi i një harte risku, por edhe të bëhen kërkime shkencore në lidhje me metodat më moderne dhe më efikase të vlerësimit të riskut nga zjarret masive në pyje që do të përfshihen në dokumentet strategjike lokale dhe kombëtare.*<br><br>*Rezultatet përfundimtare të projektit janë metodologjia e përmirësuar e vlerësimit të riskut nga zjarret masive në pyje e zhvilluar në të gjitha nivelet (themeli për aktivitetet e ardhshme ciklike të vlerësimit të riskut dhe zhvillimi i skenarëve të personalizuar për ngjarjet individuale) dhe kornizat e harmonizuara në përputhje me rrethanat e institucioneve legjislative përgjegjëse për menaxhimin e riskut, parandalimin e zjarreve masive në pyje, gatishmërinë dhe përgjigjen si dhe planet e përgjithshme të zhvillimit strategjik të të gjitha palëve të interesit.*<br><br>*AKMC duhet të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë e projektit me:*<br>- *Projektin strategjik nr.5 "politikat dhe legjislacioni";*<br>- *Projektin strategjik nr.15: "Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të Riskut të fatkeqësive në nivel qarku";*<br>- *Projektin strategjik nr.2 të tërmeteve: "Përmirësimi, përditësimi dhe harmonizimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga tërmetet";*<br>- *Projektin strategjik nr. 1 infektive/biologjike: "Metodologjia e zhvillimit për vlerësimin e riskut biologjik";* | |
| Afati kohor: | 2023-2025 |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Një studim i gjerë mbi vlerësimet moderne të riskut i cili përfshin një pasqyrë të situatës në Shqipëri dhe një strategji zbatimi për përditësimet e hartave të riskut të Shqipërisë që do të përfshijnë zjarret masive në pyje.<br>2. Workshop për transferimin e njohurive me ekspertë ndërkombëtarë (minimum 5) dhe kombëtarë (minimum 50) mbi modelin evropian të menaxhimit të riskut nga zjarret masive në pyje në nivel kombëtar dhe/ose lokal;<br>3. Analiza dhe vlerësimi i kuadrit rregullator për zbatimin e rezultateve të vlerësimit të riskut në të gjitha nivelet me synimin e menaxhimit cilësor të riskut nga zjarret masive në pyje. |
| Korniza financiare/burimi: | 400,000 euro nga buxheti i shtetit dhe fondet e BE-së |

| Institucioni përgjegjës | Bashkitë, AKZM dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (bashkëpërgjegjëse vetëm për metodologjinë e planeve të menaxhimit të zjarreve) |
|---|---|

| | |
|---|---|
| Institucione kontribuuese | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e MZSH |
| Projekti strategjik 3: | Zhvillimi i metodologjisë për planet e menaxhimit të zjarrit në nivel vendor |
| *Përshkrimi: Në këtë projekt do të hartohen planet vjetore dhe afatmesme të menaxhimit për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve në pyje në bashkëpunim me pushtetin vendor me theks të veçantë në hartimin metodologjik të këtyre planeve.*<br><br>*AKMC duhet të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë e projektit me:*<br>- *Projektin strategjik nr.1 të zjarreve në pyje: "Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shërbimeve homologe të rajonit të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi)";*<br>- *Projektin strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";*<br>- *Projektin strategjik nr.5: "Politikat dhe legjislacioni"* | |
| Afati kohor: | 2023-2024 |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Ngritja e një grupi pune ndërinstitucional për përgatitjen e metodologjisë.<br>2. Studimi i bazës ligjore mbështetëse dhe eksplorimi i nevojave për ndryshim.<br>3. Përgatitja e metodologjisë dhe drafteve paraprake të ndjekura nga diskutimi me palët e interesit.<br>4. Përshtatja dhe miratimi i metodologjisë. |
| Korniza financiare/burimi: | 12,000 euro nga buxheti i shtetit |

,

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, AKZM dhe bashkitë |
| Institucione kontribuuese | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e MZSH |
| Projekti strategjik 4: | Studim mbi nevojat për ngritjen e sistemit të sinjalizimit dhe të vëzhgimit |

| | |
|---|---|
| *Përshkrimi: Në këtë projekt do të përcaktohen nevojat në nivel kombëtar, ku përfshihen edhe kapacitetet e personelit dhe do të llogariten kostot përkatëse për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të sinjalizimit të vëzhgimit. Projekti do të rezultojë në një akt ligjor në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e sistemit të sinjalizimit të vëzhgimit dhe ngritjen e strukturave përkatëse në nivel rajonal dhe kombëtar.*<br><br>*AKMC duhet të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë e projektit me:*<br>- *Projektin strategjik nr.10: " JICA - Ngritja dhe forcimi i sistemit të paralajmërimit dhe njoftimit të hershëm për zjarret në pyje";*<br>- *Projektin strategjik nr. 11. ALBAdapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse";*<br>- *Projektin strategjik nr. 12: "Paralajmërimi i Hershëm"* | |
| Afati kohor: | 2023 - 2025 |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Studimi i zonave pyjore me risk të lartë nga zjarri në Shqipëri.<br>2. Studimi i nevojave të kapaciteteve njerëzore në lidhje me sistemin e vrojtim - sinjalizimit në nivel kombëtar.<br>3. Studimi i kostove dhe burimeve financiare të nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të vrojtim-sinjalizimit. |
| Korniza financiare/burimi: | 18 000 euro nga buxheti i shtetit |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së |
| Institucione kontribuuese | Ministria e Mbrojtjes |
| Projekti strategjik 5: | Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj zjarreve në pyje përmes modulit "Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje" të BE-së |
| *Përshkrimi: Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së forcave operacionale ndaj zjarreve do të kryhet përmes modulit "Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje" të BE-së (Ground Forest Fire Fighting/GFFF) një pjesë e të cilit do të krijohet përmes Programit IPA për Përmbytjet dhe Zjarret (IPA Floods and Forest Fires), me qëllim kompletimin e tij në një modul të plotë dhe për tu bashkuar me EERC. Për përfundimin e këtij moduli të pjesshëm do të kryhen studimi, aktivitetet trajnuese dhe stërvitja përfundimtare me praninë e Komisionit Evropian dhe DG ECHO*<br><br>*AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me:*<br>- *Projektin strategjik nr.2: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së AKMC-së dhe forcave operacionale përmes krijimit të një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot";*<br>- *Projektin strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";* | |

| | |
|---|---|
| - *Projektin strategjik nr. 8 të tërmeteve: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të Forcave Operacionale ndaj tërmeteve nëpërmjet krijimit të një moduli të Kërkim Shpëtimit të Rëndë Urban (HUSAR)";*<br>- *Projektin strategjik nr.8 të përmbytjeve: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj përmbytjeve duke plotësuar modulet ekzistuese FRB dhe FC të BE-së për përmbytjet";* | |
| Afati kohor: | 2024-2027 |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Kryerja e një studimi mbi situatën aktuale të *të modulit të pjesshëm kombëtar dhe ndërkombëtare të luftimit nga toka të zjarrit në pyje* (GFFF) e krijuar përmes programit IPA FF për përmbytjet dhe zjarret në pyje.<br>2. Zbatimi i procedurave të nevojshme kombëtare të kërkuara për miratimin dhe fillimin e komunikimit me *Komisionin Evropian* dhe DG ECHO.<br>3. Zbatimi i aktiviteteve të nevojshme të komunikimit dhe koordinimit me *Komisionin Evropian* dhe DG ECHO.<br>4. Kryerja, në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe DG ECHO, e aktiviteteve të trajnimit dhe stërvitjes përfundimtare, në prani të autoriteteve të *Komisionit Evropian*.<br>5. Kryerja e procesit të certifikimit të modulit të plotë GFFF si dhe regjistrimi i tij në EERC.<br>6. Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për krijimin e modulit sikurse pagesave të tjera vjetore të funksionalitetit dhe operimit të tij. |
| Korniza financiare/burimi: | GFFF:<br>Zhvillimi 1,530,420 euro<br>Mirëmbajtja: 117,880 euro<br>Dislokimi: 123,000 euro<br>Kosto totale: 1,771,300 EURO BE/OKB/buxheti i shtetit |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| Institucione kontribuuese | Ministria e Mbrojtjes |
| Projekti strategjik 6: | Forcimi i kapaciteteve operacionale për shuarjen e zjarreve nga ajri |
| *Përshkrimi: Forcimi i kapaciteteve operacionale ajrore ka të bëjë me krijimin e flotës ajrore shqiptare të shuarjes së zjarreve në pyje me blerjen/marrjen me qira të avionëve/helikopterëve, për të cilat AKMC duhet të ketë burimet e duhura financiare.* | |

| | |
|---|---|
| *Krahas mjetit ajror shtesë, brenda kostos së projektit nuk është paraparë kostoja e dy avionëve për shuarjen e zjarrit nga ajri të llojit Air Tractor me kapacitet 3000 litra, të përshtatshëm për furnizim me ujë edhe në depozita të vogla që do sigurohen nëpërmjet asistencës së AICS.*<br>*AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me Projektin strategjik nr. 4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri"* | |
| Afati kohor: | 2023-2026 |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Kryerja e një studimi mbi nevojat për zgjerimin dhe forcimin e kapaciteteve të zjarrfikësve ajrorë shqiptarë që konsistojnë në dy avionë nëpërmjet kredisë nga Republika e Italisë (Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim) duke shqyrtuar nëse nevojitet një avion/helikopter tjetër.<br>2. Blerja e një avioni shtesë me kapacitet 3000 litra, të përshtatshëm për furnizim me ujë edhe në depozita të vogla dhe/ose helikopteri bazuar në përfundimet e studimit.<br>3. Planifikimi i buxhetit vjetor të AKMC-së duke pasur parasysh edhe fondet e nevojshme për marrjen me qira të mjeteve zjarrfikëse kombëtare/ndërkombëtare tokësore apo ajrore.<br>4. Planifikimi buxhetor i burimeve financiare për funksionimin dhe funksionalitetin e flotës ajrore zjarrfikëse. |
| Korniza financiare/burimi: | 3,000,000 EUR (kostoja e një avioni Air Tractor sipas AICS) |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së |
| Institucione kontribuuese | |
| Projekti strategjik 7: | Forcimi i kapaciteteve teknike të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit |
| *Përshkrimi: Ndër nevojat e shumta që ka pasur në vite Shërbimi i MZSH-së janë edhe ndërtesat e stacioneve zjarrfikëse një pjesë e të cilave për shkak të amortizimit kanë nevojë për rikonstruksion sikurse ka edhe nevoja për ndërtim të stacioneve të reja zjarrfikës. Projekti synon së pari kryerjen e një vlerësimi të vendndodhjeve të stacioneve ekzistuese të MZSH-së në bashki sikurse gjendjes së tyre nga pikëpamja funksionale, dhe e sigurisë. Bazuar në konkluzionet e vlerësimit do të kryhen disa prej projekteve të zbatimit për të vijuar me ndërtimin/rikonstruksionin e disa stacioneve më prioritare. Projekti do të përfshijë edhe krijimin e Qendrës së re Kombëtare Operacionale të MZSH-së.*<br>*AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me:*<br>- *Projektin strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";*<br>- *Projektin strategjik nr.17 "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave";*<br>- *Projektin strategjik nr.18: "Përmirësimi i aftësive ripërtëritëse të infrastrukturës kritike dhe ndërtesave publike";* | |

| | |
|---|---|
| Afati kohor: | 2023-2026 |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Vlerësimi i vendndodhjeve, funksionalitetit dhe sigurisë së stacioneve ekzistuese të MZSH-së në bashki.<br>2. Bazuar në konkluzionet e vlerësimit hartimi i projekteve të zbatimit për ndërtimin/rikonstruksionin e disa stacioneve më prioritare;<br>3. Ndërtimi dhe rindërtimi i stacioneve të projektuara;<br>4. Krijimi i Qendrës së re Kombëtare Operacionale të MZSH-së. |
| Korniza financiare/burimi: | EUR Buxheti i BE/OKB/shteti<br><br>2,200,000 euro |

# 6. Aksidentet Teknologjike

Tabela 10. Projektet e lidhura me aksidentet teknologjike

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Instituti i Gjeoshkencave, Universiteti Politeknik i Tiranës, Instituti i Shëndetit Publike, Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar |
| Institucione kontribuuese | |
| Projekti strategjik 1: | *Ngritja e një laboratori për matjen e Radonit* |
| *Përshkrimi: Radoni në ambiente të mbyllura, kryesisht në bodrume dhe katet e para rrit rrezikun e kancerit të mushkërive. Përqendrimi i radonit ndikohet nga disa faktorë: gjeologjik, fizik dhe meteorologjik duke diktuar monitorim në periudha të ndryshme sezonale. Në Shqipëri janë bërë matje sporadike me ndihmën e disa projekteve, si dhe është hartuar Harta e Rrezatimit Natyror që disponohet nga Shërbimi Gjeologjik, por kjo nuk e eliminon nevojën për monitorime të mëtejshme, më të detajuara, veçanërisht në ato zona që janë në rrezik dhe kanë një numër të lartë banorësh si Tirana, Durrësi etj. Laboratori për matjen e radonit fillimisht do të fokusohet në objektet publike si çerdhe, kopshte, shkolla, fakultete etj. Laboratori do të ndihmojë në informimin dhe ndërgjegjësimin e popullatës, veçanërisht në ato zona që paraqesin rrezik për të qenë në gjendje të marrin masa mbrojtëse. Me këtë laborator do të hidhen themelet për një punë që mund të vazhdojë me vendosjen e pajisjeve reale të monitorimit të minave në objekte apo zona që përbëjnë risk. Gjithashtu do të ishte e mundur të krijohej një bazë të dhënash me të dhëna të vazhdueshme të kryera në intervale të rregullta. Laboratori do të kontribuonte në objektivin strategjik për zvogëlimin e riskut nga radoni në drejtim të marrjes së të dhënave përfaqësuese duke u konsultuar dhe bashkëpunuar me institucione si ISHP* | |

| | |
|---|---|
| *dhe IFBZ dhe gjithashtu duke kontribuar në fushën e kërkimit shkencor për njohjen e situatës dhe marrjen e masave mbrojtëse më efikase dhe më pak të kushtueshme.* | |
| Afati kohor: | *2023 - 2025* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Është kryer një konsultim me ekspertë të fushës në lidhje me pajisjet e nevojshme për matjet në afatshkurtër e afatgjatë në tokë, ujë dhe ajër me qëllim ngritjen e një laboratori me padisje profesionale që mundësojnë matjen e përqendrimit të radonit, kryesisht në zona që paraqesin rrezikshmëri nga pikëpamja gjeologjike dhe strukturore me një vëmendje të veçantë ndaj objekteve publike apo ndaj zonave të populluara.<br>2. Për këtë qellim duhet kryer vendosja e sensorëve në çerdhe, kopshte e shkolla, apo struktura të tjera publike, kryesisht në katet përdhese, bodrume, garazhe<br><br>Në harmonizim me kornizat ligjore të BE të hartohen propozime për ndryshime legjislacioni në lidhje me kontrollin e banesave publike e private, veçanërisht katet përdhese, garazhe në ato zona që paraqesin rrezik. |
| Korniza financiare/burimi: | 160,000 EURO Buxheti Kombëtar dhe fondet e BE-së |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Gjeoshkencave, Agjencia Kombëtare Bërthamore, Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Ministria e Mbrojtjes |
| Institucione kontribuuese | |
| Projekti strategjik 2: | *Zgjerimi i rrjetit për monitorimin e radioaktivitetit* |
| *Përshkrimi: Projekti do të kontribuojë në objektivin strategjik për zvogëlimin e riskut nga radioaktiviteti në përgjithësi dhe nga rrezatimet e ndryshme jonizuese nëpërmjet forcimit, përmirësimit dhe zgjerimit të rrjetit të monitorimit apo rrjetit të emergjencës radiologjike.*<br><br>*Metodologjitë për vlerësimin e riskut radioaktiv në nivel global janë përcaktuar dhe zbatuar edhe në Shqipëri. Aktualisht, të dhënat për vendin janë të parregulluara, ndaj është e nevojshme që të dhënat e regjistruara të transferohen në kohë reale dhe të harmonizohen me Sistemin Informativ Ndërkombëtar të Monitorimit të Rrezatimit (IRMIS) të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA). Në kuadër të këtij Projekti, i cili është pjesë e projektit të financuar nga BE, përveç 7 stacioneve të administruara nga IFBZ - UT (ALB-9-009 - Rritja e Kapacitetit Kombëtar për Monitorimin e Rrezatimit dhe* | |

| | |
|---|---|
| *Paralajmërimin e Emergjencave), është planifikuar të shtohen edhe 4 stacione të tjera në mjedisin ekzistues të rrjetit të monitorimit të radioaktivitetit, për të zgjeruar rrjetin e monitorimit. Ministria e Mbrojtjes do të jetë përfituese dhe administratore e 4 stacioneve shtesë.* | |
| Afati kohor: | *2023 - 2024* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Është krijuar një rrjet për mbledhjen e të dhënave në 7 stacione, që përcaktojnë fuqinë e dozës së ambientit në ajër, në mënyrë të vazhdueshme.*<br>2. *Rrjeti i monitorimit të radioaktivitetit i lidhur me sistemin e Emergjencave Radiologjike do të përmirësohet dhe forcohet me 4 stacione të reja.*<br>3. *Të katër stacionet e rrjetit monitorues do të depozitojnë të dhëna në një sistem të vetëm IT (server) të vendosur në IFBZ – UT.*<br>4. *Analiza e bazave të të dhënave dhe modelimi i të dhënave bazë të saj (aplikacione, server, cloud, etj.) do të realizohet nga IFBZ -UT.* |
| Kuadri financiar/burimi: | Buxheti Kombëtar dhe fondet e BE-së |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit |
| Institucione kontribuuese | Ministri të tjera të linjës |
| Projekti strategjik 3: | *Krijimi i një baze të dhënash për llogaritjen, menaxhimin dhe parandalimin e risqeve teknike dhe teknologjike, sipas sektorëve* |
| *Përshkrimi: Rezultati i pritshëm i projektit është krijimi i një baze të dhënash cilësore të orientuar sipas sektorëve potencialisht të ekspozuar ndaj risqeve teknike dhe teknologjike. Të dhënat e regjistruara në këtë bazë të dhënash do të shërbejnë si bazë për orientimin e politikave dhe strategjive kombëtare për shmangien apo parandalimin e risqeve në tërësi, si dhe për minimizimin e kostove në planin afatgjatë. Baza e të dhënave do të jetë lehtësisht e aksesueshme nga të gjitha palët e interesit, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Në një plan afatmesëm, projekti do të ndihmojë në përmirësimin e kapaciteteve të planifikimit financiar dhe njerëzor si dhe një adresim sistematik të riskut, me synimin për të kaluar nga politika pasive në ato proaktive dhe parandaluese.*<br>*AKMC të sigurojë sëbashku me MIE, MTM dhe ministritë e tjera të linjës komplementaritetin dhe sinergjinë me Projektin strategjik nr.18: "Përmirësimi i aftësive ripërtëritëse të infrastrukturës kritike dhe ndërtesave publike";* | |
| Afati kohor: | *2023 - 2030* |

| | |
|---|---|
| Aktivitetet kryesore: | 1. *Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për praninë e risqeve teknike dhe teknologjike në impiantet e përpunimit të produkteve hidrokarbure, rafineritë e përpunimit të naftës bruto, gazsjellësit dhe naftësjellësit;*<br>2. *Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për praninë e risqeve teknike dhe teknologjike në objektet e sektorit minerar, impiantet e përpunimit të produkteve hidrokarbure, modelimin e bazës së të dhënave (aplikacione, serverë, cloud, etj.);*<br>3. *Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për praninë e risqeve teknike dhe teknologjike në sistemin e digave dhe rezervuarëve;*<br>4. *Modelimi i bazës së të dhënave (aplikacione, serverë, cloud, etj.).* |
| Korniza financiare/burimi: | 300,000 EURO Buxheti Kombëtar, fondet e BE-së, donatorë të tjerë |

## 7. Sëmundjet infektive

Tabela 11. Projektet e lidhura me sëmundjet infektive

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit |
| Institucione kontribuuese | |
| Projekti strategjik 1: | *Metodologjia e zhvillimit për vlerësimin e riskut biologjik* |
| *Përshkrim: Projekti do të kontribuojë në qëllimin strategjik të zvogëlimit të riskut biologjik në drejtim të marrjes së të dhënave nga nëntë institucione për të bërë të mundur hartimin e metodologjisë e vlerësimit të riskut biologjik. Adresimi i masave të duhura për të menaxhuar riskun nga sëmundjet infektive në shërbim të mbrojtjes së jetës së konsumatorëve. Realizimi i tij do të arrihet nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së laboratorëve dhe pajisjes së tyre me mjetet dhe aparaturat përkatëse në qytetet Fier, Shkodër, Gjirokastër, Korçë dhe Vlorë.*<br><br>AKMC të sigurojë sëbashku me AKU komplementaritetin dhe sinergjinë me:<br>- *Projektin strategjik nr.5 “Politikat dhe legjislacioni”;*<br>- *Projektin strategjik nr. 15: “Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të Riskut të fatkeqësive në nivel qarku”;*<br>- *Projektin strategjik nr. 2 të tërmeteve: “Përmirësimi, përditësimi dhe harmonizimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga tërmetet”;* | |

| | |
|---|---|
| - *Projektin strategjik nr.2 të zjarreve në pyje: "Përmirësimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga zjarri në territor";* | |
| Afati kohor: | *2023 – 2025* |
| Aktivitetet kryesore: | 1. Përmirësimin e infrastrukturës së laboratorëve në vlerën 100 milionë lekë.<br>2. Pajisje dhe makineri për laboratorët në vlerën 179.784.861 lekë. |
| Kuadri financiar/burimi: | 2.372.500 EUR BE / OKB / Buxheti kombëtar |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Instituti i Shëndetit Publik |
| Institucione kontribuuese | Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH), Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit etj. |
| Projekti strategjik 2: | *Zbatimi i regjimit të biosigurisë dhe biosigurimit nëpërmjet një rrjeti efektiv kombëtar laboratorik* |
| *Përshkrim: Rregullorja Ndërkombëtare e Shëndetit IHR (2005) kërkon garantimin e sigurisë dhe sigurimit në të gjithë laboratorët që testojnë agjentët infektivë ose rreziqe të tjera që mund të shkaktojnë emergjenca të shëndetit publik me shqetësim kombëtar dhe ndërkombëtar. Laboratorët janë pjesë kritike e mbikëqyrjes, gatishmërisë dhe përgjigjes dhe marrin pjesë në zbulimin dhe hetimitn me ekzaminimin e mostrave të kryera në nivel vendi ose në qendrat ndërkombëtare bashkëpunuese të referencës ose laboratorët e referencës. Krijimi i një rrjeti efektiv kombëtar laboratorik Shëndetësor me një regjim të standardizuar Kombëtar të biosigurisë dhe biosigurimit është një domosdoshmëri për të përmirësuar sigurinë shëndetësore të vendit* | |
| Afati kohor: | *01/01/2023 – 15/11/2023* |
| Aktivitetet kryesore: | Objektivi 1: Vleresimi i shkallës së përgatitjes dhe zbatimit të udhëzimeve dhe/ose rregulloreve për biosigurinë dhe biosigurimin laboratorik shëndetësor kombëtare në laboratorët shëndetësore, veterinare, sigurinë ushqimore dhe mjedisore në nivel kombëtar, të ndërmjetëm dhe lokal.<br>Objektivi 2: Adresimi i mangësive në udhëzimet dhe/ose rregulloret e biosigurisë dhe biosigurimit dhe rishikimi i tyre në nivel kombëtar, të ndërmjetëm dhe lokal. |

| | |
|---|---|
| | Objektivi 3: Krijimi i një sistemi për mbikëqyrjen e zbatimit të një regjimi të biosigurisë dhe të biosigurimit shëndetësor dhe testimi i vazhdueshëm i tij |
| Kuadri financiar/burimi: | 100,000,000 USD BE / OKB / Buxheti kombëtar |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Instituti i Shëndetit Publik dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| Institucione kontribuuese | Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit etj. |
| Projekti strategjik 3: | *Krijimi i një Qendre Operacionale Emergjente të Shëndetit Publik në Institutin e Shëndetit Publik* |

*Përshkrim: Një Qendër Operacionale e Emergjencave të Shëndetit Publik (PHEOC) shërben si një qendër për përgatitjen dhe përgjigjen ndaj emergjencave të shëndetit publik dhe integron shërbimet tradicionale të shëndetit publik në një model të menaxhimit të emergjencës për koordinimin e informacionit dhe burimeve për të mbështetur aktivitetet e menaxhimit të incidenteve. QOESHP (Public Helath Emergency Operation Center/PHEOC), është pjesë e një programi gjithëpërfshirës të përgatitjes së emergjencës së shëndetit publik, planifikimit dhe ndërtimit të kapaciteteve. Një program i tillë përfshin, por nuk kufizohet vetëm tek:*

1. *Parandalimi dhe zbutja e rreziqeve*
2. *Rritja e gatishmërisë duke planifikuar dhe grumbulluar burimet e përgjigjes;*
3. *Krijimi i kapaciteteve dhe aftësive të ndërlidhura institucionale dhe teknike (p.sh. laboratorët, klinikat e komunitetit dhe ekipet e epidemiologëve dhe të përgjigjes së shpejtë)*
4. *Zbatimi i programeve të mbikëqyrjes së shëndetit publik*
5. *Zbatimi i programeve të shëndetit mjedisor*
6. *Angazhimi i komuniteteve*
7. *Trajnimi i stafit dhe vlerësimi i planeve.*

AKMC në koordinim me ISHP dhe MSHMC duhet të sigurojnë komplementaritetin dhe sinergjinë e projektit me:

- *Projektin strategjik nr.5: "Politikat dhe legjislacioni";*
- *Projektin strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";*
- *Projektin strategjik nr.17 "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave"*

| | |
|---|---|
| Afati kohor: | *19/01/2022 – 15/12/2024* |
| Aktivitetet kryesore: | Një PHEOC funksionale është kritike për zbatimin e Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit (IHR 2005).<br>Hapi 1: Krijimi rregulloreve, standardeve kombëtare dhe procedurave operacionale për PHEOC;<br>Hapi 2. Sigurimi i infrastrukturës dhe pajisjet e duhura për PHEOC; sigurimi pajisjeve dhe sistemeve;<br>Hapi 3: Krijimi i sistemit të survejancës së emergjencave në shëndet publik dhe alertit të tyre;<br>Përditësim i sistemit të survejancës së sëmundjeve infektive (përfshirë dhe modelin e biosigurisë së risqeve biologjike)<br>Hapi 4: Krijimi i kapaciteteve njerëzore kombëtare për një PHEOC funksionale duke u trajnuar dhe duke ushtruar.<br>Hapi 5: Krijimi i kapaciteteve kombëtare për vlerësimin analitik të riskut, parashikimin dhe zvogëlimin e riskut. |
| Kuadri financiar/burimi: | 700,000 USD EURO BE / OKB / Buxheti kombëtar |

| | |
|---|---|
| Institucioni përgjegjës: | Instituti i Shëndetit Publik dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| Institucione kontribuuese | Qendra Kombëtare e Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit te Institucioneve Shëndetësore (QKCSAISH), Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Mjedisit (AKM). |
| Projekti strategjik 4: | Krijimi i kurrikulës dhe certifikatës për trajnimin kombëtar për biosigurinë dhe biosigurimin |
| 3 | Krijimi i një baze të dhënash për llogaritjen, menaxhimin dhe parandalimin e risqeve teknike dhe teknologjike, sipas sektorëve | 1. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për praninë e risqeve teknike dhe teknologjike në impiantet e përpunimit të produkteve hidrokarbure, rafineritë e përpunimit të naftës bruto, gazsjellësit dhe naftësjellësit;;<br>2. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për praninë e risqeve teknike dhe teknologjike në objektet e sektorit minerar, impiantet e përpunimit të produkteve hidrokarbure, modelimin e bazës së të dhënave (aplikacione, serverë, cloud, etj.).<br>3. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për praninë e risqeve teknike dhe teknologjike në sistemin e digave dhe rezervuarëve;<br>4. Modelimi i bazës së të dhënave (aplikacione, serverë, cloud, etj.). | MIE,MTM | Ministri të tjera të linjës | 2023 | 2030 | 35.175.000 | 35.175.000 |
| | Totali: Aksidentet teknologjike | | | | | | 53.935.000 | 53.935.000 |

## 7. Sëmundjet Infektive

| Nr. | Objektivi specifik | Masat/aktivitetet | Institucionet përgjegjëse | | Afati | | Kosto | Boshllëku financiar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Institucioni përgjegjës (Udhëheqës) | Institucion kontribues (nëse ka) | Koha e fillimit | Koha e mbarimit | Lekë | Lekë |
| 1 | Metodologjia e zhvillimit për vlerësimin e riskut biologjik | 1. Përmirësimi i infrastrukturës së laboratorëve.<br>2. Pajisje dhe makineri për laboratorët. | AKU | | 2023 | 2025 | 278.175.625 | 278.175.625 |
| 2 | Zbatimi i regjimit të biosigurisë dhe biosigurimit nëpërmjet një rrjeti efektiv kombëtar laboratorik | Objektivi 1: Vlerësimi i shkallës së përgatitjes dhe zbatimit të udhëzimeve dhe/ose rregulloreve për biosigurinë dhe biosigurimin laboratorik shëndetësor kombëtar në laboratorët shëndetësore, veterinare, sigurinë ushqimore dhe mjedisore në nivel kombëtar, të ndërmjetëm dhe lokal.<br>Objektivi 2: Adresimi i mangësive në udhëzimet dhe/ose rregulloret e biosigurisë dhe biosigurimit dhe rishikimi i tyre në nivel kombëtar, të ndërmjetëm dhe lokal.<br>Objektivi 3: Krijimi i një sistemi për mbikëqyrjen e zbatimit të një regjimi të biosigurisë dhe të biosigurimit shëndetësor dhe testimi i vazhdueshëm i tij | ISHP | OSH KSH, NJVKSH, ISUV, AKU etj. | 1/1/2023 | 15/11/2023 | 11.926.000 | 11.926.000 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Krijimi i një Qendre Operacionale Emergjente të Shëndetit Publik në Institutin e Shëndetit Publik | Një PHEOC funksionale është kritike për zbatimin e Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit (IHR 2005).<br>Hapi 1: Krijimi rregulloreve, standardeve kombëtare dhe procedurave operacionale për PHEOC;<br>Hapi 2. Sigurimi i infrastrukturës dhe pajisjeve të duhura për PHEOC; sigurimi pajisjeve dhe sistemeve;<br>Hapi 3: Krijimi i sistemit të survejancës së emergjencave në shëndet publik dhe alertit të tyre;<br>Përditësim i sistemit të survejancës së sëmundjeve infektive (përfshirë dhe modelin e biosigurisë së risqeve biologjike)<br>Hapi 4: Krijimi i kapaciteteve njerëzore kombëtare për një PHEOC funksionale duke u trajnuar dhe duke ushtruar.<br>Hapi 5: Krijimi i kapaciteteve kombëtare për vlerësimin analitik të riskut, parashikimin dhe zvogëlimin e riskut. | ISHP dhe MSHMS | OSH KSH, NJVK SH, ISUV, AKU etj. | 19/1/ 2022 | 15/1 2/20 24 | 83.482.0 00 | 83.482.00 0 |
| 4 | Krijimi i kurrikulës dhe certifikatës për trajnimin kombëtar për biosigurinë dhe biosigurimin | Hapi 1: Përgatitja e një kurrikule shëndetësore mbi biosigurinë dhe biosigurimin<br>Hapi 2: Krijimi i një programi bazë dhe një kaskadë të vazhdueshme trajnimi të një kurrikule të shëndetit të njësuar mbi biosigurinë dhe biosigurimin.<br>Hapi 3: Fuqizimi i kapaciteteve humane të tanishme të laboratorëve shëndetësorë duke i ofruar trajnim të vazhdueshëm kaskadë. | ISHP, MSHMS | QKC SAIS H, OSH KSH, NJVK SH, ISUV, AKU dhe AKM. | 10/1 1/20 22 | 10/1 1/20 24 | 23.852.0 00 | 23.852.00 0 |
| | Totali: Sëmundjet Infektive | | | | | | 397.43 5.625 | 397.435. 625 |
| | TOTALI i 7 grupeve | | | | | | 93.036. 641.49 3 | 77.586.6 36.450 |

# Shtojca 4. Partneriteti me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare dhe marrëveshjet përkatëse

**Shqipëria është anëtare e:**

- OKB-së;
- Këshillit të Evropës (KE);
- Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE);
- Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO);
- Agjencisë Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (IAEA).
- Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH);
- Organizatës Botërore të Meteorologjisë (OBM);
- Sistemit Evropian të Ndërgjegjësimit ndaj Përmbytjeve (European Flood Awareness System/EFAS)
- Sistemit Evropian të Informacionit për Zjarrin Pyjor (European Forest Fire Information System /EFFIS)
- Qendrës së Menaxhimit të Thatësirave të Evropës Jug - Lindore (DMCSEE).
- EUR-OPA, Marrëveshja e Rreziqeve të Mëdha;
- Komisionit Ndërqeveritar Oqeanografik (Intergovernmental Oceanographic Commission/IOC);
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është anëtar me të drejta të plota i Shërbimit Gjeologjik Evropian që nga 1.01.2015 sikurse është anëtar i Konsorciumit Ndërkombëtar të Rrëshqitjeve që nga viti 2011.

**Marrëveshje dhe memorandume shumëpalëshe në fuqi janë:**

- Memorandumi i Mirëkuptimit, për Kuadrin Institucional të Iniciativës për Gatishmërinë, dhe Parandalimin e Katastrofave për Evropën Juglindore (DPPI SEE) miratuar me VKM nr. 1013, datë 22.11.2013. Memorandumi është nënshkruar nga pala shqiptare në 28.11.2013 dhe ka hyrë në fuqi në 12.11.2014;
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Bosnjë dhe Hercegovinës dhe qeverive të vendeve të tjera anëtare të Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të fatkeqësive për Evropën Juglindore mbi marrëveshjet e vendit pritës për Sekretariatin e Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Juglindore nënshkruar nga Shqipëria në 20.09.2018;
- Marrëveshja ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ) mbi bashkëpunimin në ndihmën dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente në fushën e fatkeqësive natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut", miratuar me Ligjin nr.10 372, datë 10.2.2011;
- Memorandumi i Mirëkuptimit për menaxhimin e basenit të zgjeruar ndërkufitar të Drinit i nënshkruar nga Ministrat e ministrive kompetente të Menaxhimit të Ujit dhe Mjedisit të vendeve që përshkohen nga Drini, d.m.th. Shqipëria, Maqedonia e Veriut (ish -Republika Jugosllave e Maqedonisë), Greqia, Kosova dhe Mali i zi.
- Protokolli mbi bashkëpunimin shumëpalësh në shkëmbimin e të dhënave sizmike ndërmjet institucioneve: Departamenti i Gjeofizikës, Fakulteti i Shkencave, Universiteti i Zagrebit, Kroaci; Shërbimi Federal Hidrometeorologjik, Qendra e Sizmologjisë Sarajevë, Shërbimi Hidrometeorologjik i Republikës SRPSKA - Sektori për Sizmologji, Banja Luka dhe Ministria e Çështjeve Civile të Qeverisë Federale të Bosnjës dhe Hercegovinës; Instituti i Gjeoshkencave, Universiteti Politeknik i Tiranës, Shqipëri; Observatori Sizmologjik i Malit të Zi; Observatori Sizmologjik, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti "SS. Cyril dhe Metodius" Shkup, Maqedonia e Veriut dhe Shërbimi Sizmologjik i Serbisë;

**Marrëveshje dhe memorandumet dypalëshe në fuqi janë:**

- Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Greqisë, e datës 27.05.2006, "Për bashkëpunimin ndërmjet shërbimeve zjarrfikëse të tyre dhe kompetencave që kanë ata në këtë fushë".
- Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë e datës 27.01.2010, "Mbi ndihmën e ndërsjellët në rast të katastrofave ose të fatkeqësive të mëdha", nënshkruar më 27.1.2010, hyrë në fuqi në 1.7.2011;
- Marrëveshja e datës 7.10.2011, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë "Për ndihmë reciproke në rast të fatkeqësive dhe aksidenteve të mëdha". nënshkruar më 7.10.2011, hyrë në fuqi në 28.9.2012;
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, "për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë, në raste të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera", nënshkruar në 2.10.2020;
- Marrëveshja operacionale e bashkëveprimit në fushën e Mbrojtjes Civile e nënshkruar në 28.10.2021 në kuadër të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi "për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë në emergjenca" nënshkruar në 3.7.2018, hyrë në fuqi në 22.11.2018;
- Memorandumi i mirëkuptimit për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe ato teknologjike ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile në Ministrinë e Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Drejtorisë Kombëtare të Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Republikës së Kroacisë, nënshkruar më 23.2.2010, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit;
- Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë, Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës Çeke, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit për Mbrojtjen nga Zjarri, mbi bashkëpunimin në fushat e parapërgatitjes dhe zbutjes ndaj fatkeqësive, nënshkruar më 13.10.2015, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit;
- Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës se Shqipërisë dhe Qeverisë se Republikës se Italisë për bashkëpunimin në veprimet e kërkim shpëtimit në detin Adriatik miratuar me VKM nr. 671 datë 7.12.2001;
- Memorandumi i Mirëkuptimit, "Për Lehtësimin e Transportit Civil Jetësor Ndërkufitar" i ratifikuar me Ligjin nr. 9805 datë 17.9.2007;
- Protokolli "Mbi shkëmbimin në kohë reale të të dhënave sizmologjike" ndërmjet Republikës së Turqisë, Presidenca e Menaxhimit të Fatkeqësive dhe Emergjencave dhe Universitetit Politeknik të Tiranës", të nënshkruar në 1.03.2018.
- Memorandumi i Bashkëpunimit mes Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe Shërbimit Gjeologjik të Republikës së Maqedonisë së Veriut të nënshkruar në 14.06.2017;
- Memorandum i Bashkëpunimit mes Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe Shërbimit Gjeologjik të Kosovës nënshkruar në 12.12.2016;

**Marrëveshje në proces janë;**

- Marrëveshja ndërmjet Bashkimit Evropian, njëra palë dhe Republikës së Shqipërisë, pala tjetër, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit;
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë "Mbi bashkëpunimin në rast fatkeqësish" miratuar në parim me VKM nr. Nr. 659 , datë 29.7.2015;
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit mbi bashkëpunimin dhe ndihmën e

ndërsjellë në fushën e parandalimit dhe eliminimit të pasojave të fatkeqësive natyrore dhe aksidenteve të shkaktuara nga dora e njeriut;
- Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Autoritetit të Menaxhimit të Fatkeqësive, Ministria e Brendshme, Republika e Turqisë, dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë mbi Menaxhimin e Fatkeqësive dhe Emergjencës.

**Organizata dhe institucione, partnere të sistemit të MC në Shqipëri janë:**

- UNDP;
- Komisioni Evropian (European Commission/EC);
- Banka Botërore (World Bank/WB);
- NATO;
- Agjencia e SHBA për Zhvillim Ndërkombëtar (U.S. Agency for International Development/USAID);
- Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (Food and Agriculture Organization/FAO);
- Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë (United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization/UNESCO);
- Organizata Botërore e Shëndetësisë (World Health Organization/WHO);
- Organizata Botërore e Meteorologjisë/OBM (World Meteorological Organization/WMO);
- Agjencia Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (International Atomic Energy Agency/IAEA);
- Programi Botëror i Ushqimit (World Food Programme/WFP)
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (United Nations Children's Fund (UNICEF);
- Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (United Nations High Commissioner for Refugees/UNHCR);
- OSBE;
- World Vision (WV);
- Save the children;
- Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (International Organization for Migrants/IOM);
- Federata ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe (International Federation for Red Cross and Red Cressent/IFRC);
- Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim/AICS;
- GIZ;
- JICA;
- Agjencia e Bashkëpunimit dhe Koordinimit Turk – TiKA;
- Ambasadat e SHBA, Zvicrës, Portugalisë, Suedisë, Turqisë, Holandës

# Shtojca 5. Grupi teknik ndërinstitucional i punës. Rolet, përgjegjësitë dhe baza ligjore të ministrive kryesore dhe agjencive të përfshira në çështjet e menaxhimit të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile në vend

| **GRUPI NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS (NIVELI POLITIK)** | | | | **GRUPI TEKNIK NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS** |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Institucioni** | **Personi përfaqësues** | **Funksioni** | **Personi përfaqësues** |
| 1 | Ministria e Mbrojtjes | Dallëndyshe Bici | Zëvendësministër i Mbrojtjes | |
| 2 | Ministria e Brendshme | Romina Kuko | Zëvendësministër i Brendshëm | Anastas Meçi |
| 3 | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme | Megi Fino | Zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme | Klea Doko |
| 4 | Ministria e Financave dhe Ekonomisë | Adela Xhemali | Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë | Ismet Lala<br>Iris Gjishti<br>Valion Cenalia |
| 5 | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Ilir Bejtja<br>Enkelejda Muça | Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë | Artur Pilkati |
| 6 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | Dhimitër Kote | Zëvendësministër i Bujqësisë dhe i Zhvillimit Rural. | Arben Mukaj<br>Sivi Gode |
| 7 | Ministria e Arsimit dhe Sportit | Nina Guga | Zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit. | Jetlir Gjergji<br>Shkelqim Akllaj<br>Griselda Sulaj<br>Besfort Goxhi<br>Eglantina Killo<br>Edlira Nastimi |
| 8 | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale | Vjollca Braho | Zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale | Silva Bino |
| 9 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit | Ornela Çuçi | Zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit | Admir Seci<br>Josif Tashulla<br>Ylli Hoxha |

| GRUPI NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS (NIVELI POLITIK) | | | | GRUPI TEKNIK NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS |
|---|---|---|---|---|
| 10 | Ministria e Drejtësisë | Klajd Karameta | Zëvendësministër i Drejtësisë | Arber Sanxhaku |
| | | | | Erjon Ndreca |
| 11 | Ministria e Kulturës | Meri Kumbe | Zëvendësministër i Kulturës | Kozeta Angjeliu |
| | | | | Klodiana Gjata |
| | | | | Teodor Droboniku |
| | | | | Marsela Demaj |
| | | | | Regi Cibaku |
| 12 | Ministri i Shtetit për Rindërtimin | Alda Klosi | Këshilltare, Përfaqësues i Kabinetit të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin | Darien Mero |
| 13 | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile | Haki Çako | Drejtor i Përgjithshëm i AKMC-së | |
| 14 | Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore | Gerta Lubonja | Drejtor i Përgjithshëm | Margarita Lutaj |
| 15 | Instituti i Gjeoshkencave | Ylber Muceku | Drejtor i Përgjithshëm | Gjon Rrota |
| 16 | Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | Viktor Doda | Drejtor i Përgjithshëm | Mehmet Kënga |
| 17 | Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit | Adelina Greca | Drejtor i Përgjithshëm | Nensi Lalaj |
| 18 | Instituti i Shëndetit Publik | Eugena Tomini | Drejtori i Përgjithshëm | Silva Bino |
| 19 | Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) | Ilir Beqja | Drejtori i Përgjithshëm | Robert Ceco |
| 20 | Universiteti i Mjekësisë Tiranë | Prof. Dr. Arben Gjata | Rektor | Prof. Asoc. Edmond Zaimi |
| 21 | Universiteti Bujqësor i Tiranës | Prof. Dr. Fatbardh Sallaku | Rektor | Romina Koto |
| | | | | Alban Ibraliu |
| 22 | Universiteti i Tiranës | Prof. Dr. Artan Hoxha | Rektor | Dr. Elona Pojani |
| | | | | Dr. Fjorda Shqarri |
| | | | | Prof. Dr. Fatos Ylli |
| **Institucionet e tjera** | | | | |

| GRUPI NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS (NIVELI POLITIK) | | | | GRUPI TEKNIK NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS |
|---|---|---|---|---|
| 23 | Agjencia Kombëtare e Mjedisit | Arta Dollani | Drejtor i Përgjithshëm | Arta Kodra |
| 24 | Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura | Daniel Pirushi | Drejtor i Përgjithshëm | Holta Copani<br>Kasem Uzuni |
| 25 | Kryqi i Kuq Shqiptar | Ylli Alushi | Presidenti i KKSH | Fatos Xhengo |
| 26 | Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha | Arjan Jovani | Kryetar i KKDM | Ermal Kacurri |
| 27 | Agjencia Kombëtare e Pyjeve | Artur Kala | Drejtor i Përgjithshëm | Behar Hate |
| 28 | Autoriteti Kombëtar i Sigurisë dhe Emergjencave në Miniera | Mimoza Hajdarmataj | Drejtor i Përgjithshëm | Muharrem Hida |
| 29 | Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar | Brunilda Daci | Drejtor i Përgjithshëm | Dritan Prifti |
| 30 | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit | Jeta Deda | Drejtor i Përgjithshëm | Edlira Dibra |
| **Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile** | | | | |
| 31 | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile | Adisa Bala | Drejtor i Drejtorisë së Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe të Parandalimit | |
| 32 | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile | Robert Hysenllari | Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente | |
| 33 | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile | Klajdi Nikolla | Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve | |

| GRUPI NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS (NIVELI POLITIK) | | | | GRUPI TEKNIK NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS |
|---|---|---|---|---|
| 34 | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile | Jonian Harka | Drejtor i Drejtorisë së Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit | |
| **Sekretariati Teknik** | | | | |
| 35 | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile | Malvina Shira | Specialist | |
| | | Andi Pogaci | | |
| | | Ambra Fusha | | |
| **Autorë dhe Kontribues** | | | | |
| 36 | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Shqipëri | Elvita Kabashi | Drejtuese e Departamentit te Mjedisit, Ndryshimit të Klimës dhe të Energjisë | |
| | | Doreid Petoshati | Koordinator Kombëtar i Projektit RESEAL | |
| | | Gentjan Dema | Asistent Financiar dhe Administrativ i Projektit RESEAL | |
| 37 | Konsulenca ABKONS shpk, pjesë e projektit RESEAL të UNDP në Shqipëri | Krunoslav Katic | Drejtues i Ekipit të konsulentëve | |
| 38 | | Josif Gjani | Konsulent Strategjie | |
| 39 | | Blerina Kurti | Menaxhere Projekti | |
| 40 | | Maksimiljan Dhima | Konsulent kombëtar | |
| 41 | | Natasa Holcinger | Konsulente ndërkombëtare | |
| 42 | | Vlatko Jovanovski | Konsulent ndërkombëtar | |

1. **Ministria e Mbrojtjes**
   Është aktori kryesor dhe vendimmarrësi në zhvillimin e sistemit të MRF. Aktualisht, AKMC është pjesë e strukturës së MM-së. Si e tillë, MM-ja luan një rol të rëndësishëm në vendosjen e drejtimeve strategjike dhe objektivave të AKMC-së sikurse harton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave të ZRF dhe të MC. Fusha e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe kompetencat për realizimin e saj parashikohen në ligjin nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Neni 34, pika 1, shkronja “a” e Ligjit 45/2019 parashikon që FA duhet të angazhohen në operacionet e ciklit të menaxhimit të fatkeqësive nëse kapacitetet e tjera në dispozicion janë të pamjaftueshme për këtë qëllim, duke mbështetur institucionet, autoritetet qendrore dhe vendore dhe komunitetin. Një nga

strukturat në varësi të MM është Qendra Kombëtare e Kërkimit Shpëtimit. Në varësi të MM janë Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.
Veprimtaria e MM lidhet me të gjitha risqet dhe sipas rastit në të gjitha fazat e menaxhimit emergjent.
Disa nga ligjet dhe strategjitë e MM të lidhura me MRF janë:

- Ligji nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë";
- Ligji nr.10 435, datë 23.6.2011 "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr.9224, datë 29.4.2004 "Për Shërbimin Meteorologjik Ushtarak";
- "Strategjia Kombëtare për mospërhapjen e armëve të dëmtimit në masë dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj" miratuar me VKM nr. 33, datë 22.1.2020;
- Strategjia ushtarake të Republikës së Shqipërisë e miratuar me ligjin nr. 72/2015;
- "Dokumenti i rishikimit të strategjisë së mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë" miratuar me VKM nr. 628, datë 25.9.2019.

2. **Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile**
Është aktori kryesor në konfigurimet aktuale të sistemit të MC në vend. Është agjencia udhëheqëse e cila ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për të siguruar zhvillimin e kapaciteteve të MRF-së në vend dhe angazhimin e aktorëve të tjerë kyç në fusha specifike funksionale. Ajo ka për detyrë të koordinojë punën për hartimin e SKZRF, PKEC dhe VRF në nivel qendror. AKMC organizon punën për ngritjen e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile në nivel qendror dhe vendor, si dhe trajnimin e subjekteve private dhe vullnetare. Në nivel vendor, sipas nenit 23, pika 4 të ligjit 45/2019, Agjencia organizohet dhe funksionon nëpërmjet qendrave të mbrojtjes civile në qark.

3. **Ministria e Brendshme**
Është një aktor i rëndësishëm në sistemin e MC në vend. Përveç rendit dhe sigurisë publike, MB ka për detyrë a) bashkërendimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendorë; b) hartimin e politikave, koordinimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të MZSH; c) ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe ndërtimeve. Ministria e Brendshme kontribuon në menaxhimin e emergjencave nëpërmjet strukturave në varësi të saj si Policia e Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së; Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave për Çështjet Vendore dhe Prefekturat dhe Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.
Veprimtaria e MB lidhet me të gjitha risqet. Ligjet kryesore dhe strategjitë e MB të lidhura me MRF janë:
- Ligji nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut";
- "Strategjia Ndërsektoriale e luftës kundër krimit të Organizuar, trafiqeve të Paligjshme dhe terrorizmit, 2013-2020 dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016" miratuar me VKM nr. 663, datë 17.7.2013, të ndryshuar;
- Strategjia kombëtare për migracionin dhe plani i veprimit 2019-2022 miratuar me VKM nr. 400, datë 19.6.2019;
- "Strategjia ndërsektoriale e menaxhimit të integruar të kufirit 2021–2027 dhe të planit të veprimit 2021–2023", e miratuar me VKM nr. 1117, datë 16.12.2020".

4. **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.**
   Misioni i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është hartimi dhe zbatimi i politikave të jashtme, drejtimi teknik dhe bashkërendimi i procesit të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, zhvillimi dhe fuqizimi i diplomacisë ekonomike, si dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve shqiptarë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit.
   Në gjendje të qetë dhe gjatë gjendjes emergjente, MEPJ kujdeset për të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi dhe ato në proces sikurse krijon lidhjet e nevojshme me shtete, organizma dhe struktura të huaja, të cilat ofrojnë ndihmë të çdo lloji për përballimin e emergjencave civile. MEPJ mbështet komunikimin me shtetet apo organizatat ndërkombëtare për çështje të MRF dhe në veçanti për rastet e marrjes apo dhënies së asistencës ndërkombëtare. Veprimtaria e MEPJ lidhet me të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit emergjent dhe roli i saj pritet të rritet në kuadër bashkëpunimit të shtuar me MMC BE pas anëtarësimit të Shqipërisë në të, por dhe më gjerë, në kuadër të proceseve të përafrimit për anëtarësim në BE.

5. **Ministria e Financave dhe Ekonomisë.**
   Angazhimi i palëve të interesuara në MRF është i lidhur kryesisht me menaxhimin e burimeve financiare, aplikimin e procedurave ligjore doganore, adresimin e nevojave për përgjigje dhe rimëkëmbje në subjektet private, infrastrukturën publike dhe kritike.
   Për vetë karakteristikat institucionale të MFE, veprimtaria dhe përgjegjësitë e saj lidhen me risqe të shumëfishta në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit emergjent.
   Ligji kryesor i MFE dhe që lidhen me MRF është Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

6. **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.**
   MIE ka si mision hartimin e zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e planifikimit dhe të zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës e të transportit, në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, në sektorin e energjisë, të shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare, si dhe në sektorin e industrisë.
   Për shkak të fushës së gjerë të përgjegjësisë shtetërore të MIE, angazhimi i saj është në të gjitha fazat e MRF dhe për shumë prej risqeve.
   Legjislacioni i MIE përbëhet nga shumë ligje dhe bazë nënligjore e fushave të energjisë, transporteve, industrisë, zhvillimit urban, telekomunikacionit dhe postës, disa prej të cilëve janë më poshtë:
   - Ligji nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë";
   - Ligji nr. 118/2012 "Për transportin e mallrave të rrezikshme";
   - Ligji nr.9126, datë 29.7.2003 "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
   - Ligji nr.10 304, datë 15.7.2010 'Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
   - VKM nr. 811, datë 16.11.2016 "Për miratimin e strategjisë sektoriale të transportit dhe planit të veprimit 2016–2020";
   - VKM nr.643, datë 14.9.2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve";
   - VKM nr. 480, datë 31.7.2018 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030".

7. **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**
   MBZHR ka një rol veçanërisht të rëndësishëm që buron nga fakti se garantimi i mbrojtjes së gjësë së gjallë mishërohet në qëllimin dhe objektin e ligjit "Për mbrojtjen civile" duke përbërë njërën nga 5 shtyllat e tij.
   MBZHR ka si mision hartimin e zbatimin e politikave në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, veterinarisë, ushqimit dhe sigurisë ushqimore, peshkimit, akuakulturës, pyjeve drufrutorë.
   Disa nga funksionet më kryesore të MBZHR janë më poshtë:
   Mbrojtja e tokës nga erozioni; mbrojtja e burimeve dhe e rezervave ujore; mbrojtja e kafshëve nga sëmundjet dhe parandalimi i përhapjes së tyre; garantimi i qëndrueshmërisë, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi sipas rregullave i rezervuarëve; inspektimi i kushteve optimale të prodhimit, magazinimit, tregtimit dhe përdorimit të produkteve ushqimore, blegtorale dhe bujqësore; inspektimi i kushteve të magazinimit, tregtimit dhe përdorimit të preparateve të mbrojtjes së bimëve; ushtrimi i kontrollit në vendkalimet kufitare, për parandalimin e transmetimit të sëmundjeve në bimë dhe në kafshë; mirëmbajtja, monitorimi dhe vënia në gatishmëri e sistemit të kanalizimeve, pritave, argjinaturave dhe sistemeve të pompimit; Riaftësimin e zonave të përmbytura.
   Disa nga ligjet dhe dokumentet strategjike të MBZHR që lidhen me MRF janë renditur më poshtë:
   - Ligji nr. 24/2017 "Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit";
   - Ligji nr.9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar;
   - Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar;
   - Ligji nr. 10 465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
   - Ligji Nr.8681, datë 2.11.2000 "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", i ndryshuar;
   - VKM Nr. 437, datë 17.5.2017 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë";
   - VKM nr.147, datë 18.3.2004 "Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe te dambave";
   - Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 370, datë 11.6.2019 "Për miratimin e statutit tip të organizatës së përdoruesve të ujit";
   - Strategjia kombëtare e ujitjes dhe kullimit 2019–2031 dhe e planit të veprimit miratuar me VKM nr. 345, datë 22.5.2019;
   - Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, 2018–2027, miratuar me VKM nr. 73, datë 7.2.2018;
   - Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020, miratuar me VKM nr. 709, datë 29.10.2014, e ndryshuar.
   - Strategjia kombëtare të peshkimit 2016–2021miratuar me VKM nr. 701, datë 12.10.2016;

8. **Ministria e Arsimit dhe Sportit**
   MAS ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, kryesisht, por jo vetëm, në fushat e përgjegjësisë shtetërore, si dhe çdo fushë tjetër përgjegjësie që i ngarkohet, si më poshtë vijon:
   - arsimi parauniversitar;
   - arsimi i lartë;
   - zhvillimi i sportit;
   - kërkimi shkencor.

   MAS është një aktor shumë i rëndësishëm në të gjithë ciklin e menaxhimit emergjent. Detyra specifike të MAS përcaktohen në ligjin 45/2019 dhe PKEC.

Legjislacioni MAS që lidhet me MRF është si më poshtë:

- Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- Ligjin Nr.79/2017, datë 27.04.2017 "Për sportin", i ndryshuar.
- Strategjia kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe planin e veprimit për zbatimin e saj e miratuar me VKM nr. 621, datë 22.10.2021

Disa detyra specifike të MAS që mund të veçohen në të gjithë ciklin e menaxhimit emergjent janë garantimi i sigurisë së ambienteve mësimore ndaj fatkeqësive, përgatitja e PEC dhe trajnimi i nxënësve, studentëve dhe personelit mësimdhënës për rastet e fatkeqësive, organizimi dhe përkujdesja e duhur për nxënësit dhe studentët gjatë emergjencave etj.
Për vetë karakteristikat e MAS, ajo ka një kontribut në të gjithë ciklin e menaxhimit emergjent sikurse për të gjitha llojet e fatkeqësive.

**9. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

MSHMC ka një rol veçanërisht të rëndësishëm që buron nga fakti se garantimi i mbrojtjes së jetës së njeriut mishërohet në qëllimin dhe objektin e ligjit "Për mbrojtjen civile" duke përbërë njërën nga 5 shtyllat e tij.
MSHMS ka për mision hartimin e zbatimin e politikave dhe të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor e për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55, të Kushtetutës. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.
Përfshirja e MSHMS është në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit emergjent dhe për të gjitha llojet e risqeve.
Disa nga ligjet dhe dokumentet strategjike më të lidhura me MRF janë renditur më poshtë:

- Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik", i ndryshuar;
- Nr.10107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 147/2014 "Për shërbimin e urgjencës mjekësore";
- Ligji nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", i ndryshuar;
- Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
- Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara";
- Ligji nr.9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri";
- Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar;
- Strategjia e zhvillimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri 2020-2025 e miratuar me VKM nr. 405, datë 20.5.2020;
- Strategjia kombëtare e shëndetësisë 2021-2030 e miratuar me VKM nr. 210, datë 6.4.2022.
- Dokumentit politik "Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019–2024 për zbatimin e tij", i miratuar me VKM nr. 380, datë 5.6.2019;
- Strategjia kombëtare e mbrojtjes sociale, 2020–2023, dhe plani i veprimit në zbatim të saj, të miratuar me VKM nr. 866, datë 24.12.2019;

- Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, 2021–2030, dhe plani i saj i veprimit, të miratuar me VKM nr. 400, datë 30.6.2021;
- Plani kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025 i miratuar me VKM nr. 276, datë 12.5.2021.

## 10. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

MTM ka një rol veçanërisht të rëndësishëm që buron nga fakti se garantimi i mbrojtjes së mjedisit mishërohet në qëllimin dhe objektin e ligjit "Për mbrojtjen civile" duke përbërë njërën nga 5 shtyllat e tij.
MTM ka si mision hartimin e zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen nga ndryshimet klimatike, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave, si dhe hartimin e zbatimin e politikave për turizmin.
MTM, për shkak të fushës së saj të përgjegjësisë shtetërore ka një rol të shumëfishtë në sistemin e MRF. Veprimtaria e saj bazohet në:

- Ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet";
- Ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura"
- Ligjin nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor";
- VKM nr. 814, datë 31.12.2018 "Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019–2030";
- Ligjin nr.162, datë 04.12.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis", i ndryshuar;
- VKM Nr.290, datë 30.4.2004 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota";
- Dokumentin e politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020–2035, të miratuar me VKM nr. Nr. 418, datë 27.5.2020;
- "Planin kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit" të miratuar me VKM nr. 412, datë 19.6.2019;
- "Dokumentin strategjik dhe planet kombëtare për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike" miratuar me VKM nr. 466, datë 3.7.2019;
- "Strategjinë ndër sektoriale të mjedisit", të miratuar me VKM nr. 847, datë 29.11.2007;

## 11. Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë është organi përgjegjës për zbatimin e politikës së drejtësisë, në kërkim të respektimit të Kushtetutës, të ligjeve, realizimit dhe mbrojtjes së dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe kontribuon në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik e të integrimit evropian të Republikës së Shqipërisë.
Ministria e Drejtësisë vepron në bazë të ligjit 45/2019 dhe legjislacionit tjetër që lidhet me fushën e veprimit të saj në MRF.
Veprimtaria e MD ka të bëjë me nxjerrjen e akteve ligjore të lidhura me MRF sikurse me veprimtari të tjera gjate fazave të ciklit te menaxhimit emergjent të lidhura me institucione të varësisë siç janë Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve.

## 12. Ministria e Kulturës

MK ka një rol veçanërisht të rëndësishëm që buron nga fakti se garantimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore është njëri nga 5 shtyllat e mishëruara në qëllimin dhe objektin e ligjit "Për mbrojtjen civile".
MK angazhohet në parandalimin, lehtësimin dhe rindërtimin e objekteve kulturore si dhe në ruajtjen e vlerave të monumenteve të kulturës, prekur nga emergjenca. Gjatë emergjencave merr masa për mbrojtjen e jetës së spektatorëve, të popullsisë, të vlerave kulturore dhe objekteve monumentale e muzeale.
Veprimtaria e MK lidhet me legjislacionin si më poshtë:

- Ligjin nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë";
- VKM nr. 420, datë 15.6.2022 "Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura";
- Strategjinë kombëtare për kulturën, 2019–2025 të miratuar me VKM nr. 903, datë 24.12.2019.

## 13. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është person juridik publik në varësi të Kryeministrit dhe është krijuar me VKM Nr. 221 datë 26.4.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", të ndryshuar.
Misioni i Agjencisë është mirëqeverisja e burimeve ujore me qëllim përmbushjen e të gjitha nevojave jetësore, duke mbajtur në vëmendje qëndrueshmërinë e ekosistemeve, duke nxitur konkurrueshmërinë e përdorimeve dhe prioritizimin drejt përfitueshmërisë ekonomike. Agjencia organizohet dhe funksionon në përputhje dhe në zbatim të ligjit 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar. Veprimtaria e AMBU lidhet më së shumti me risqet hidrologjike. Agjencia organizohet në nivel qendror dhe në nivel baseni ujor nëpërmjet zyrave të administrimit të baseneve ujore, degë të saj, në përputhje me basenet ujore të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
Legjislacioni dhe strategjitë e AMBU të lidhura veçanërisht me MRF janë:

- VKM Nr. 1015, datë 16.12.2020 "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet";
- VKM Nr. 221 datë 26.4.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", i ndryshuar;
- Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, 2018–2027, miratuar me VKM nr. 73, datë 7.2.2018.

## 14. Instituti i Gjeoshkencave

Është institucion kërkimor dhe shkencor i krijuar me Urdhrin Nr. 371, datë 28.7.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "për krijimin e Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), pranë Universitetit Politeknik të Tiranës. IGJEO është një aktor i rëndësishëm në fushën e zhvillimit të njohurive dhe të kuptuarit të risqeve ekzistuese dhe të mundshme nga fatkeqësitë. IGJEO është identifikuar si struktura kombëtare monitoruese dhe paralajmëruese për aktivitetin meteorologjik, hidrologjik dhe sizmologjik në Shqipëri. IGJEO është pjesë e Universitetit Politeknik të Tiranës. IGJEO i jep informacion AKMC-së dhe institucioneve, agjencive dhe strukturave të tjera nëpërmjet "Qendrës Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore" dhe "Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Aktivitetit Sizmik". Gjithashtu, IGJEO siguron informacion të vazhdueshëm dhe bashkëpunon me strukturat e tjera të emergjencave civile në nivel vendor në analizimin dhe monitorimin e situatës, si dhe informimin e rregullt.
Veprimtaria e IGJEO lidhet me risqet gjeologjike, hidrologjike, atmosferike dhe biofizike

15. **Shërbimi Gjeologjik Shqiptar**
Është institucioni këshillimor teknik dhe shkencor nën Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ushtron aktivitete në fushën e shkencave të tokës në territorin e Republikës së Shqipërisë. Veprimtaria e SHGJSH bazohet në ligjin 111/2015, "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar", i cili përcakton marrëdhëniet ndërmjet këtij institucioni dhe palëve të tjera publike dhe private.
Veprimtaria SHGJSH dhe përgjegjësitë e saj lidhen më së shumti me risqet gjeologjike.

16. **Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit**
Është autoritet me përgjegjësi planifikimi, në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Misioni i saj është të kontribuojë për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit të udhëhequr nga strategjitë e mirëplanifikuara dhe programet afatmesme e afgjata të zhvillimit; të sigurojë zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi që garantojnë mirëplanifikimin e territorit; si edhe të mbështesë dialogun profesional në fushën e planifikimit të territorit, duke përhapur njohuritë e fituara gjatë eksperiencës së saj në këtë fushë. Në këtë kuadër, AKPT harton në bashkëpunim dhe bashkërendon proceset e hartimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, si dhe siguron bashkërendimin ndërmjet autoriteteve të planifikimit të territorit, si atë horizontal (mes institucioneve të pushtetit qendror), ashtu edhe atë vertikal (mes institucioneve vendore e qendrore). Gjithashtu, AKPT udhëheq, koordinon dhe ndërlidh veprimtaritë për modernizimin e modelit të planifikimit dhe promovimin e praktikave novatore në projektim urban dhe planifikim.
Baza Ligjore për krijimin e AKPT është ligji 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe VKM Nr. 427, datë 08.06.2016 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit".
Për vetë karakteristikat institucionale të AKPT, veprimtaria dhe përgjegjësitë e saj lidhen me risqe të shumëfishta dhe më së shumti në fazat e lehtësimit/zbutjes dhe atë atë të rimëkëmbjes.

17. **Instituti i Shëndetit Publik**
Veprimtaria e ISHP bazohet në ligjin nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik", i ndryshuar.
ISHP në varësi të MSHMS, është Qendra Kombëtare në fushën e shëndetit publik dhe ka mision të tij zhvillimin dhe aplikimin e parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve, dëmtimeve, paaftësive, e faktorëve dëmtues shëndetësorë të mjedisit, dhe zhvillimin dhe aplikimin e promocionit të shëndetit, në bashkëpunim të ngushtë me agjensi/organizma/organizata kombëtare dhe ndërkombëtare.
ISHP është përgjegjës për:
- Informimin, këshillimin dhe mbështetjen e MSHMS në hartimin e politikave dhe të strategjive në fushën e shëndetit publik;
- Sigurimin e ekspertizave;
- Realizimin e studimeve të pavarura dhe prodhimin e informacioneve, bazuar në fakte; Pjesëmarrjen në formimin e burimeve njerëzore në shëndet publik.

Disa nga ligjet dhe dokumente strategjike me të cilët lidhet veprimtaria e ISHP janë:
- Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik", i ndryshuar;
- Nr.10107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", i ndryshuar;
- Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";

- Ligji nr.8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar.
- Strategjia kombëtare e shëndetësisë 2021-2030 e miratuar me VKM Nr. 210, datë 6.4.2022.

18. **Drejtoria e Njësisë së Koordinimit të Programeve të Zhvillimit dhe Planifikimit Strategjik në Departamentin e Programit të Zhvillimit, Financimit dhe Asistencës në Kryeministri.**
SASPAC është krijuar me VKM nr. 642, datë 29.10.2021 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës" SASPAC është person juridik publik buxhetor, në varësi të Kryeministrit. SASPAC-ja ka si mision koordinimin e ndihmës së huaj për programet dhe projektet zhvillimore, asistimin e strukturave vendimmarrëse për hartimin e SKZHI dhe monitorimin e zbatimin e saj, ofrimin e mbështetjes metodologjike në hartimin e strategjive ndërsektoriale dhe sektoriale, me qëllim harmonizimin e tyre me SKZHI-në, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre, koordinimin e procesit të administrimit të projekteve me interes kombëtar, ofrimin e mbështetjes për institucionet e administratës shtetërore për rritjen e kapaciteteve në fushën programeve dhe projekteve zhvillimore.